

## **KOMUNIKIMI DHE MEDIA**

Njerëzit në shoqërinë bashkëkohore komunikojnë në mënyra të ndryshme: nëpër shtëpi dhe në vende publike, me telefon, me internet, nëpër shkolla, koncerte, takime publike, duke i dëgjuar apo lexuar mediat etj. Në vendet e mëdha dhe teknologjikisht të avancuara, shumica e popullatës komunikon me bashkëqytetarët përmes medias, që sigurojnë njëfarë afërsie. Në nivel personal, media mundëson një afrim me qeniet e tjera dhe një solidaritet, por, mund të nxisë edhe zemërim, frikë, stres dhe izolim nga bota e jashtme, varësisht nga informatat apo dezinformatat që i ofron.

Në nivel politik, mediat kanë vend qendror për zbatimin e demokracisë. Është esenciale që popullata të ketë informacione në mënyrë që të bëjë zgjedhjet e caktuara politike dhe të marrë pjesë në jetën qytetare. Pjesëmarrja publike e qytetarëve e krijon hapësirën publike, e cila funksionon më efektshëm në shoqëritë ku është e pavarur nga shteti dhe nga forcat ekonomike të shoqërisë.

Mediat nuk janë instrumente të vetme të sferës publike. Bibliotekat, shkollat, institucionet fetare dhe shoqatat e ndryshme janë shembuj të hapësirës publike ku qytetarët takohen dhe diskutojnë. Nëse media nuk ofron hapësirë demokratike publike, njerëzit do të jenë të padijshëm, të politizuar, demagogjia do të lulëzojë dhe një elitë e vogël do ta kontrollojë vendim-marrjen.

## **KOMUNIKIMI DHE MEDIAT**

Bota modern është në varësi të komunikimit ose të ndërveprimit të vazhdueshëm midis njerëzve tepër të veçuar nga njëri tjetri. Në qoftë se nuk do të ishim kaq të varur nga komunikimi në distancë, shkollimi masiv ose do të ishte i panevojshëm ose i pamundur. Sot jetojmë në një botë, ku mësojmë për ngjarje të cilat kanë ndodhur me mijëra kilometra larg- komunikimi elektronik e bën një informim të tillë po thuajse të menjëhershëm. Ndryshimet në përhapjen dhe në teknologjitë e informacionit janë po aq pjesë e zhvillimit të shoqërive modern sa edhe aspekti i

prodhimit industrial (Kern, 1983). Në shekullin e 20 transporti i shpejtë dhe komunikimi elektronik kanë intensifikuar shumë shpërndarjen botërore të informacionit. Ideali klasik i medias është që të jetë një kanal që përcjell informacione dhe mendime. Mediat përcjellin informacione për ngjarje dhe faqe nga jeta shoqërisë, njëkohësisht janë një hialk lidhëse midis grupeve të ndryshme si, për shembull midis zgjedhësve dhe politikanëve. Zgjedhësit shkruajnë artikuj, intervistohen, anketohen etj ndërsa politikanët bëjnë propozime dhe karakterizojnë mendime kundërshtare. Në shikojmë se mediat nuk janë vetëm përcjellëse, por edhe një arenë shkëmbimi mendimesh, një forum ku debatet dhe konfliktet dalin në duplej.

## **KOMUNIKIMET MASIVE**

Mass media- Janë mjete të komunikimit në përmasa të mëdha nganjëherë cituar edhe me termin anglisht, *mass media* ose thjeshtë *media*. Janë mjetet nëpërmjet të cilëve bëhet e mundur shpërndarja e diturisë drejt një pluraliteti marrësish ose shfrytëzuesish (populli = massa) informacioni pa dallim.

Shprehja rrjedh nga bashkimi i termit Anglez mass me fjalën latine medium, shumë *media*. Qoftë "medium" si dhe "media" asimilohen më se miri edhe ne gjuhën shqipe. *Medium* u zgjodh për shkak se gjuha angleze nuk zotëron një term me kuptim të dyfishtë të fjalës "mjet" (si vegël) diçka (në këtë rast) ndërmjet autorit të mesazhit dhe marrësit. Mass media- gazetata, revistat, kinemaja, internet dhe televizioni shpesh herë janë lidhur me argëtimin dhe prandaj janë konsideruar si të skajshme për shumicën e jetës së njerëzve. Komunikimet massive futen në shumë aspekte të veprimtarive tona sociale. Për shembull, transaksionet monetare tani kryesisht mbështeten në shkëmbimin e informacionit të ruajtur në kompjuter. Një llogari bankare nuk është një grumbull bankënotash të ruajtura në një kasatrofë, por një seri numrash të shtypura në një fletë llogarie dhe të rezervuara në kompjuter. Cili do që përdorë kartel kredie është i lidhur me një sistem shumë kompleks të informacionit të ruajtura dhe të transmetuara në mënyrë

elektronike. Madje mediat çlodhëse si gazetat dhe televizioni ndikojnë shumë në jetën tonë. Dhe kjo jo se ata ndikojnë në qëndrimet tona në mënyrë specifike, por sepse ata janë mjetë për sigurimin e dijeve nga të cilat varen shumë veprime sociale. Të votuarit në zgjedhjet nacionale për shembull mund të jetë I pamundur në qoftë se në përgjithësi nuk jepen informacione rreth ngjarjeve politike të ditës, kandidatëve dhe partive. Madje edhe ata që janë krejtësisht të pa interesuar për politikën dhe kanë njohuri të pakta për personalitetet e përfshira në to, kanë disa njohuri për ngjarjet kombëtare dhe ndërkombëtare. Vetëm një heremit i fortë mund të jetë i veçuar nga lajmet rreth ngjarjeve që na prekin të gjithë ne- dhe ne do të vinim në dyshim nëse një heremit i shekullit 20 nuk ka radio apo nëse një i ri i shekullit 21 në shtëpinë e tij nuk ka qasje në internet. Mjetet për komunikim masiv kryejnë funksione të ndryshme: informim të popullatës për ngjarjet në vend dhe jashtë vendit, shkollimin dhe socializimin e popullatës, reklamim dhe propagandë dhe funksione tjera. Mjetet për komunikim masiv kanë ndikim në të gjitha fushat dhe institucionet në shoqëri, përfshirë këtu edhe procesin politik. Në lidhje me politikën ata janë instrumenti më kryesor për realizimin e procesit politik. Që nga fillimi i viteve të 60'-ta të shekullit 20 është konstatuar se mjetet për komunikim do të marrin rol të rëndësishëm. Në pjesën e dytë të shekullit 20 televizioni është shndërruar në një mjet tepër të fortë në procesin politik dhe mjet udhëheqës në procesin e komunikimit. Kjo u vërtetua për herë të parë në zgjedhjet e mbajtura në Amerikë në vitin 1960 ku në garë për president të shtetit ishin Xhon Kenedi dhe Robert Nikson, debatet e tyre të zhvilluara përpara ekraneve televizive i sollën fitoren Xhon Kenedis në zgjedhjet-

### **PRIORITETET DHE KËNDVËSHTRIMI I MEDIAS**

Ngushtësia për vend dhe para bën që media gjithë kohën zgjedhin se çfarë duhet të paraqesin. Ata gjithë kohën redaktojnë. Çfarë marrin dhe çfarë lënë, varet se ç'mendim ka redaktori dhe ku duhet të arrijnë. Mediat nuk japin një pamje “neutrale” dhe “objektive” të realitetit. Për shembull, nuk botohen të gjithë letrat e lexuesve, nuk intervistohen të gjithë aktorët dhe nuk përcillet e gjithë loja politike që zhvillohet. Janë mediat që zgjedhim për ne. Kjo sa është e nevojshme, aq edhe e domosdoshme, sepse sasia kolosale e informacionit nuk do të ishte e mundur të trajtohej. Kur një çështje vlerësohet për tu trajtuar në media del problem se si do të paraqitet në tekst dhe në pamje, pra nga ç'këndë do të vështrohet. Nuk është edhe e rastit zgjedhja e perspektivës, domethënë cilët do të intervistohen, apo cilat pamje do të jenë në planë të parë dhe cilat në sfond. Këndvështrimi sot, nuk zgjidhet duke e mbajtur anën e njërit apo tjetrit. Problemet shpesh, paraqiten në mënyrë që të ngjallin kureshtjen në formën e sensacionit, ballafaqimit dhe skandalit. Mediat bëhen portierë të informacionit. Ata e marrin informacionin, e sitin, e thjeshtojnë dhe e paraqesin në atë mënyrë që të kuptohet. Në këtë mënyrë ne marrim

“pako” informacioni të përshtatur për tu lexuar në stacione të autobusëve, për rreth parqeve e vendeve tjera. Mirëpo ai përmban vetëm një përqindje të vogël të realitetit.

## **KONTROLLI IMEDIAVE DHE NDIKIMI I TYRE**

Mediat gjatë punës së tyre zbulojnë raporte të kritikueshme, që fshihen pas fasadave, për llogari të lexuesve, si qytetarë dhe si zgjedhës. Shumica e redaktorëve, sot e quajnë si përgjegjësi ndaj shoqërisë kontrollin e institucioneve dhe njerëzve me pushtet, për llogari të zgjedhësve. Mediat në një farë mënyrë, janë ruajtëse të popullit. Nga ana tjetër demaskimi i personave të fuqishëm me moral të dyfishtë, shpërdorimet, korrupsioni dhe paaftësia janë gjithnjë material i mirë për lexuesit dhe shikuesit. Kur mediat mendojnë se kanë përpara një çështje të rëndësishme, atëherë kjo çështje zë një vend të gjërë në shtypin e përditshëm. Po të jetë se çështja është e tillë që tërheq vëmendjen dhe është njëkohësisht interesante, atëherë shtrohet menjëherë mbi tavolinën e politikanëve. Në këtë rast mediat kanë vendosur rendin e ditës së tyre. Mediat nuk përcjellin vetëm informacion por mbajnë qëndrim, kritikojnë dhe vendosin rendin e ditës. Njëkohësisht, është vënë re se media ndikon edhe në mendimet e lexuesit e të shikuesit, të paktën për një kohë të shkurtër. Nga kjo mund të themi se mediat nuk vendosin se çfarë do të mendojnë, por për çfarë duhet menduar ne. Kjo ju jep mundësi për një ndikim të madh aktiv mbi politikën, gjë që e ka bërë të quhet pushteti i katërt.

## **GAZETAT DHE BOTIMI I TYRE**

Gazetat, në formën e tyre moderne, zënë fill nga broshurat dhe fletët informative. Gazetat u bënë të përditshme të lexueshme nga mijëra e miliona njerëz vetëm nga fundi i shekullit 19 e këndej. Gazeta ishte një zhvillim i rëndësishëm thelbësor në historinë e medias modern, sepse ajo përmban shumë tipe të ndryshme informacionesh Brenda një formati të kufizuar dhe të riprodhueshëm lehtë. Gazetat përmbajnë në një vend të vetëm informacione mbi çështje të ditës, argëtimi dhe reklamë. Shtypi i përditshëm i lirë dhe financiarisht, nisi në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Gazeta e përditshme një centësh u botua fillimisht në New York pastaj u përhap në qytetet tjera lindore kryesore. Nga fillimi i viteve 1900-të kishte gazeta qyteti ose rajonale që mbulonin shumicën e shteteve amerikane. Gjatë periudhës së emigracionit masiv në SHBA u botuan shumë gazeta në gjuhë të huaja. Për shembull në vitin 1892, 97 gazeta të përditshme në gjuhën gjermane botoheshin në qytetet në Perëndimin e mesëm dhe në Veri- Lindje të vendit.

Shpikja e letrës së pakushtueshme të gazetave ishte themelore për shpërndarjen e tyre massive nga fundi i shekullit XIX e këndeje. Dy shembujt më të rëndësishëm të gazetave prestigjioze në fillim të shekullit ishin “New York Times” dhe “The Times” e Londrës. Shumica me influencë të vendeve tjera i konsideronin ata si modele. Gazetat kryesore të tregut u bënë një forcë e rëndësishme politike dhe kanë mbetur të tilla edhe në ditët tona. Për një gjysmë shekulli e më shumë, gazetat ishin mjete kryesor për përçimin e informacionit me shpejtësi dhe në mënyrë të gjithë anshme për një publik masiv. Ndikimi i tyre u zbeh me shpikjen e radios, të kinemasë dhe më të rëndësishme të televizionit.

Gazetat prej kohësh kanë qenë shoqëruar me imazhin e pasanikut të fuqishëm, me kreun e një perandorie botuese. Por tabloja nuk është shumë e saktë. Në shumë vende pronësia e gazetave është koncentruar në duart e korporatave të mëdha, shpesh të zotëruara dhe të dominuar prej individëve ose familjeve të veçanta. Shumë nga këto firma sot kanë aksione të shumta në televizione dhe në industrinë zbavitëse. Me përjashtim të SHBA-së, të gjithë vendet perëndimore kanë një numër gazetash kombëtare. Mund të zgjedhësh ndërmjet gazetave kombëtare që vihen në dispozicion shpesh të përshkruar nga pikëpamje politike të ndryshme. Megjithëse gazetat në Shtetet e Bashkuara janë lokale, ata nuk janë kurrësi të gjitha në pronësi lokale, më shumë se 70 për qind e tyre kontrollohen prej rrjeteve botuese. Në disa prej tyre, si në shumë gazeta me tirazh të madh në Evropë, pronarët përcaktojnë politikën botuese që duhet të ndjekin botuesit dhe gazetarët. Në rrjetin e gazetave të Hearstit, çdo ditë botuesve të tetë gazetave kryesore, u dërgohen kryeartikuj të ndryshëm, disa prej të cilëve duhet patjetër të botohen, ndërsa të tjerët mundet jo.

Krijimi dhe zhvillimi i gazetave me tirazh të madh është shumë i kushtueshëm. Ka patur disa gazeta të reja dhe të suksesshme si për shembull “The Sun” në Britani, e sipërmarrësit Australian Rupert Mardok, përgjithësisht për pjesën me interesa dhe shije më të ulëta të tregut por më shumë ka patur falimentime. Zhvillimi i teknologjive të bazuara tek kompjuteri do të çojë në rritjen e numrit të gazetave dhe në kohën e fundit ato janë bërë shumë më të lira për tu shtypur dhe për tu prodhuar. Nga ana tjetër, komunikimi elektronik mundet të dëmtojë edhe më tej dhe më shumë qarkullimin e gazetave. Jemi dëshmitar të kohës kur masovikisht është duke u përdorur interneti për çdo gjë dhe se tirazhi dhe shitja e gazetave po bie dita ditës. Nëpërmjet portaleve të ndryshme informacion po bartet me shpejtësi marramendëse nga çdo skaj i botës që po e bën të pamundur mbijetesën e gazetave, sepse lajmet e tyre më vetëm se janë të njohura për një pjesë të madhe të lexuesit të cilët kalojnë kohën e tyre duke qenë të kyçur në rrjetin e internetit.

## **NDIKIMI I TELEVISIONIT**

Rritja e ndikimit të televizionit është ndoshta i vetmi zhvillim më i rëndësishëm në median 30 vitet e fundit. Në qoftë se do të vazhdojnë pritjet e tanishme për të ndjekur televizionin, fëmija I lindur sot deri në moshën 18 vjeçare do të harxhojë mesatarisht më shumë kohë duke parë televizor se sa për çdo lloj veprimtarie tjetër, me përjashtim të gjumit. Praktikisht tani çdo kryefamiljarë ka në aparat televizori. Gjatë viteve të fundit ka marrë përhapje të gjerë përdorimi I video aparateve për të regjistruar programet me qëllim që të shikohen më vonë ose për të shfaqur filma video në shtëpi.

Sikurse gazetatat massive, televizionin në ditët tona është një biznes i madh dhe në shumicën e vendeve shteti përfshihet drejtpërdrejt në administrimin e tij. Fuqia e rrjeteve të mëdha është zvogëluar qysh prej shfaqjes së satelitit dhe të televizionit me kablo. Shikuesit në më shumë vende evropiane, duke përfshirë Mbretërinë e Bashkuar dhe qytetet kryesore amerikane, mund të zgjedhin nga një mori programesh dhe kanalesh. Në rrethana të tilla, veçanërisht në qoftë se ndokush përfshin edhe ndikimin e videove njerëzit gjithnjë e më shumë po bëjnë programin e tyre vetjak. Ata më tepër hartojnë planet e tyre për të parë personazhet e preferuar se sa janë nën ndikimin e programeve që planifikojnë rrjetet televizive. Sateliti dhe kablo ndryshuan natyrën e televizionit po thuajse në të gjithë vendet. Menjëherë pasi filluan të depërtonin Brenda zotërimeve të kanaleve të televizionit të deriatëhershëm, ishte e vështirë për qeveritë të kontrollonin përmbajtjen e televizionit, siç kishin bërë në të kaluarën. Televizioni dhe media elektronike duket se luajtën një rol kryesor në rrethanat që çuan në revolucionet e 1989-ës në Evropën Lindore. Ata po ashtu kanë luajtur një rol të rëndësishëm edhe në informimin e opinionit në shumë ngjarje të tjera historike të periudhës së fundit, duke përfshirë këtu edhe ndikimin që kishte kanali televiziv amerikan CNN në raportimin e saj për luftën në Kosovë. Duke i përcjell pamjet trishtuese të masakrave serbe mbi popullatën shqiptare mediumet ndikuan që forcat ushtarake të NATO-ës të kryejnë sulme mbi regjimin Millosheviçian dhe kështu populli shqiptarë të fiton lirinë. Kjo është vetë një nga shembujt se si pamjet televizive dhe mediumet kanë ndikuar në ndryshimin e rrjedhojave dhe fatit të njerëzve në mbarë botë, falë shpejtësisë së transmetimit dhe përçimit të informacionit.

## **NDIKIMI I TELEVISIONIT MBI SJELLJEN**

Janë bërë shumë studime për të vlerësuar ndikimet e programeve televizive. Shumica e studimeve mbi ndikimin e televizionit kanë të bëjnë me fëmijët- e kuptueshme kjo, duke patur parasysh vëllimin e madh të orëve që harxhojnë për të parë televizion dhe implikimet e mundshme për socializimin. Tri temat kërkimore më të përgjithshme janë ndikimi i televizionit mbi pritjet për krime dhe dhunë, efektet e emisioneve të lajmeve dhe roli i televizionit në jetën

politike. Shpeshësia e dhunës në programet televizive është evidentuar mjaft. Shumica e studimeve të gjëra janë realizuar prej Grebnerit dhe bashkëpunëtorëve të tij duke analizuar modelet në televizionet gjatë kohës kryesore dhe fundjavës për të gjithë rrjetet kryesore amerikane çdo vit që nga 1967. Numri dhe frekuenca e akteve dhe episodeve të dhunës u diagramuan për në sërë llojesh të ndryshme të programeve. Në studime dhuna u përcaktua si kërcënim ose përdorim i forcës fizike drejtuar kundër vetes ose të tjerëve të dhunshëm e cila shkakton dëmtim fizik ose vdekje. Drama televizive shfaqet me karakter tepër të dhunshëm: mesatarisht 80 për qind e programeve të tilla përmbajnë dhunë, me një frekuencë 7.5 episode dhune në orë. Madje programet e fëmijëve kanë një shkallë më të lartë të dhunës, megjithëse vrasjet janë zakonisht më të pakta. Filmat vizatimor përmbajnë numrin më të madh të akteve dhe episodeve të dhunës në krahasim me çdo lloj tjetër të programeve televizive.

Në çfarë mënyre ndikon shfaqja e dhunës mbi spektatorët ?

F.S Anderson përgjithësoi përfundimet e 67 studimeve të realizuara mbi 20 vjetëve nga 1956 deri më 1976, duke ndjekur ndikimin e dhunës televizive mbi pritet për agresion teke fëmijët. Rreth tre të katërtat e studimeve pohonin ekzistencën e disa lidhjeve të tilla. Në 20 për qind të rasteve nuk kishte përfundime të prera, ndërsa në 3 për qind të studimeve kërkuesit arritën ën përfundimin që shikimi i dhunës televizive në të vërtetë i dobëson priritet agresive.

Megjithatë studimet që i analizoi Andersoni ndryshojnë shumë në metodat e përdorura në nxjerrjen në pah të intensitetit të lidhjeve dhe në përcaktimin e sjelljes agresive. Në dramat e kriminit që përshkruhen nga dhuna janë të nënkuptuara temat e drejtësisë dhe shpagimit. Në drama një pjesë shumë më e madhe e krimeve zbulohen dhe çohen përpara drejtësisë në krahasim me zbulimet policore në realitet, dhe në filmat vizatimor personazhet e dëmshme ose kërcënuese zakonisht marrin atë që meritojnë. Nuk është e lehtë që shkalla e lartë e përshkriminit të dhunës të krijojë drejtpërdrejtë modele të imitueshme. Ata që i ndjekin këto drama mund të ndodh që të ndikohen më shumë nga temat morale që qëndrojnë në themelet e tyre. Në përgjithësi studimit për efektet e televizionit mbi auditorin pritet t'i trajtoj shikuesit- fëmijun dhe të rriturit- si pasivë dhe nuk i paragjykon reagimet e tyre ndaj asaj që e shohin.

Robert Hodge dhe David Tripp theksojnë që reagimet e fëmijëve ndaj televizionit përfshinë të interpretuarit ose të lexuarit e asaj që ata shikojnë dhe jo thjeshtë të regjistruarit e programeve. Ata sugjerojnë që shumë studime nuk kanë marrë parasysh karakterin e ndërlikuar të proceseve mendore të fëmijëve. Të ndjekurit e televizionit, madje edhe i programeve të parëndësishme, në thelb nuk është ndonjë aktivitet intelektual i rëndomtë; fëmijët lexojnë programet duke i lidhur ato me sistemet të tjera kuptimore në jetën e tyre të përditshme. Për shembull edhe fëmijët shumë të vegjël e dinë që dhuna e medias nuk është reale. Sipas hadge dhe trip nuk është dhuna

si e tillë në programet e televizionit që ndikon mbi sjelljen por më shumë konteksti i përgjithshëm i qëndrimeve Brenda së cilës ajo shfaqet dhe lexohet

## **TELEVIZIONI SI PËRÇUES I QËNDRIMEVE SOCIALE**

Ndikimi i televizioneve si një medium kulturor nuk mund të vlerësohet siç duhet në bazë të përmbajtjes së programeve të paraqitura. Televizioni ndihmon për të siguruar kornizat e eksperiencës, pikëpamjet kulturore të përgjithshme, Brenda të cilave individët në shoqërinë modern interpretojnë dhe organizojnë informacionin. Televizioni është po aq i rëndësishëm sa librat, revistat dhe gazetat të formave të tërthorta të komunikimit. Ai konturon mënyrat me të cilët individët interpretojnë dhe reagojnë ndaj botës sociale, duke ndihmuar për të vënë rregull në përvojën tonë për të. Supozimet e ndërtuara Brenda karakterit të përgjithshëm të prodhimit dhe shpërndarjes televizive ndoshta janë më të rëndësishme se çfarëdo programesh të veçanta që shfaqen.

Për shembull televizioni ka shërbyer në një farë mase për të ndryshuar natyrën e zgjedhjeve modern, për shkak të rolit të tij të rëndësishëm në sigurimin e një platforme për prezantimin e çështjeve dhe kandidatëve. Të marrim një shembull tjetër : simbolet që përbëjnë reklamat mund të kenë një ndikim më të thellë në sjelljen sociale se sa mesazhet e shprehura me fjalë që reklamuesit dëshirojnë të përçojnë. Kështu ndarjet gjinore shpesh simbolizohen më shumë nga ajo që ndodhë në një mjedis ose sfond tregtarë se me mallin që shitet. Në shumë reklama burrat shfaqen si mendërisht dhe fizikisht të zotët, ndërsa gratë paraqiten duke parë larg në mënyrë ëndërruese.



## NDIKIMI SHOQËROR I TELEVISIONIT

Mjetete e komunikimit masiv, siç janë : filmi, televizioni, radioja dhe shtypi, janë faktorë të rëndësishëm të cilët bëjnë ndikim të fortë ndaj njeriut bashkëkohor. Nëpërmjet tyre përcillen informacione, përmbajtje edukativo-arsimore dhe redaktive me ç'rast plotësohen nevojat gjithnjë e më të shprehura të njeriut bashkëkohor për t'u informuar për dukuritë genësore shoqërore, për proceset dhe raportet, që të zhvillojë personalitetin e vet dhe gjatë orëve të lira ta mbushë kohën e vet me përmbajtje të cilat do ta argëtojnë dhe do ta dëfrenjë.

Ndikim të posaçëm mjetet e komunikimit masiv kanë ndaj të rinjëve të cilët gjenden në procesin e zhvillimit dhe të pjekurisë së tyre. Ato u'a zgjerojnë hapsirën e diturive dhe shkathësive të tyre, e nxisin interesin e të rinjëve për të përvetësuar të arriturat shkencore dhe kulturore, i pasurojnë dimensionet sociale dhe morale dhe i zhvillojnë aftësitë e tyre krijuese në të gjitha fushat e krijimtarisë.

Televizioni si medium masiv u paraqit më vonë dhe ai i'u bashkangjit shtypit dhe radios. Në krahasim me mediumet e tjera televizioni ka përparësi të caktuara, sepse është i shpejtë në të kumtuarit e informacioneve. Teknologjia e tij i mundëson të marrë pjesë drejtpërdrejtë në vendin e ngjarjes dhe informacionet e veta t'i transmetojë në të gjallë, kështu që nuk është dokument, por pjesëmarrës i drejtpërdrejtë në ngjarje.

Televizioni u krijua me shpikjen e mikrofonit, altoparlantëve, sinjalit elektrik dhe sistemit të antenave. Receptorët televizivë pothuajse çdo ditë përsosen me shpikjet e reja në lëmin e elektronikës. Me ndihmën e kësaj dhe me ndihmën e satelitëve sot është mundësuar transmetimi në të njejtën kohe i zërit dhe fototgrafisë në të gjitha kontinentet.

Me shpikjet e reja në lëmin e elektronikës mund të konstatojmë se është gjetur një medium universal i cili bën ndikim të fortë ndaj të gjitha fushave të jetës shoqërore. Televizioni i rrëmbeu dhe i bashkoi në vete të gjitha mediumet e tjera dhe e mblodhi rreth vetes publikun e tërësishëm. Kësaj i'u bashkangjit edhe videoja e cila jep mundësinë që disa emisione të caktuara të incizohen dhe të shfaqen në çfarëdo lloj kohe, ndërsa kohëve të fundit i'u bashkangjitën edhe lojrat zbavitëse nëpërmjet nitendos, plejstejshënit e të tjera të cilat bëjnë të mundshëm njëfarë dëfrimi për të rinjtë. Televizioni satelitor nëpërmjet teletekseve në cdo kohë jep informacione nga fusha e financave, lëvizja e mallrave nëpër bursa etj. Televizioni kabllor bën të mundshme ndikimin e mjaft programeve satelitore.

Nga paraqitja e vet në vitet 30-të të shekullit të kaluar deri më sot televizioni bën ndikim shumë të madh ndaj shoqërisë në tërësi, posaçërisht në fushën e kulturës, artit, jetës politike dhe arsimit. Ai i eliminoi pengesat gjeografike dhe kulturore dhe bëri revolucion në mënyrën e jetesës dhe të menduarit të njerëzimit anembanë botës. Ky ndikim i madh është si pasojë e faktit se përmbajtjet e tij janë të kapshme për një numër të madh shikuesish, ai është i pranishëm pothuajse në çdo familje (kuptohet, mjaft familje kanë televizione në të gjitha shtëpitë e tyre), por edhe për shkak të shprehjes sugjeruese të tij.

Televizioni bëhet pjesë integrale e jetës shoqërore, sepse njerëzimit shikojnë mesatarisht 4 deri 5 orë television. Ndryshe nga mediumet e tjera, televizioni krijon ndjenjën se atë që e shohin është e vërtetë. Porositë, informacionet, komentet, programet dokumentare, si dhe programet e dramave duken sikur të jenë reale, që në masë të madhe e dallon nga mediumet tjera.

Televizioni si mjet më i fuqishëm i komunikimit masiv ka rol të madh në reklamimin e prodhimeve të konsumit të gjërë, si dhe në promovimin e programeve të ndryshme politike, të pikëpamjeve dhe qëndrimeve të udhëheqësve politikë dhe të njerëzve në pushtet ose në opozitë.

Në fund të theksojmë se televizioni bën ndikim dhe i modifikon dhe i ndryshon qëndrimet e shikuesve, ndërsa i pamohueshëm është edhe roli i tij që e ka në fushën e arsimit.

#### TELEVIZIONI DHE DHUNA

Deri tani janë bërë mjaft studime dhe hulumtime për ndikimin e programeve televizive ndaj sjelljes së njerëzve. Kuptohet, pjesa më e madhe e këtyre hulumtimeve kanë të bëjnë me fëmijët, sepse ata më shpesh shohin programe televizive dhe për shkak se ata janë në procesin e socializimit. Ndër pyetjet që më shumë u intereson sociologëve janë ndikimi i televizionit ndaj krijimit të ndjenjës për të anuar nga krimi dhe dhuna, ndaj natyrës së lajmeve televizive dhe ndikimit të televizionit ndaj jetës shoqërore dhe kulturore etj.

Përveç të arriturave positive që i ofron televizioni, kanë konstatuar hulumtuesit, duhet të theksohet se të gjitha përmbajtjet e tij nuk gjenden në nivelin e duhur estetik dhe edukativ dhe emisionet e tilla bëjnë ndikim negativ ndaj të rinjëve dhe fëmijëve, sepse ata gjenden në procesin e të mesuarit intenziv, përkatësisht gjenden në procesin e socializimit të tyre. Veçanërisht duhet të theksohet ndikimi negativ që e bëjnë filmat televiziv me përmbajtje kriminalistike (filma ku dominojnë vrasjet, rrëmbimet, sulmet e armatosura të bankave, kërcënimet, vjedhjet, linçet, skena të dhunës dhe të torturimeve etj.), filmat me përmbajtje avanturistike dhe filmat që shfaqin pornografi. Në filma të këtillë ka skena me krime dhe dhunë që mund t'i mësojnë të rinjtë me teknikat e kryerjes së kundërvajtjeve dhe të kenë ndikim

sugjestiv, duke u inkurajuar që të bëjnë vepra të tilla. Prandaj disa autorë janë të mendimit se televizioni mund të jetë shkollë përgatitëse për kundërvajtje.

Të ekspozuarit e përditshëm dhe të gjatë të veprimit me materiale të këtilla të rinjtë paraqet rrezik të madh për zhvillimin e tyre. Sipas një numri të madh analizash më të reja, brengosës është ndikimi i programeve të këtilla që e bëjnë ndaj të rinjëve, veçanërisht, kur ata janë filma kriminalistikë të cilët nxisin imitimin e veprimeve të dhunës, shkaktojnë panik nëse shfaqen në orët e hershme të mbrëmjes. Kjo ka ndikim negativ veçanërisht te fëmijët, të cilët nuk janë në gjendje të bëjnë dallimin ndërmjet realitetit dhe fantazisë.

Edhe pse nocionet e dhunës nuk janë të njejta, megjithatë mund të ketë një pajtim unik rreth asaj çka paraqet agresioni dhe çka dhuna. Sjellja agresive është sjellja e tillë e cila ka qëllim të qartë dhe të paramenduar për të fyer ose dëmtuar dikë, përkatësisht që përcillet me kënaqesinë që ndjen gjatë kryerjes së agresivitetit. Ekziston agresivitet fizik dhe me gojë me qëllim që tjetrin ta fyejmë. Dhuna paraqet formën e fundit të agresivitetit me përdorimin e paarsyeshëm të forcës psikike dhe fizike.

Të ekspozuarit e përhershëm ndaj dhunës nëpërmjet filmave ose të ndonjë mënyre tjetër bën që televizioni të jetë shkaktuar për shtimin e sjelljes agresive të shikuesve. Rezultati i shikimit të filmave ose emisioneve tjera televizive me sjellje të dhunshme shakton sjellje të ngjashme edhe te shikuesit. Pjesa më e madhe e hulumtimeve të këtij relacioni tregon se të shfaqurit e dhunës nëpërmjet televizionit mund të jetë faktor që kontribuon në shkallën e lartë të dhunës.

Konsiderohet se katër procese janë përfshirë gjatë të ekspozuarit të dhunës, e cila nxit agresivitetin.

Këto janë:

1. Gjatë të ekspozuarit të dhunës nëpërmjet televizionit zvogëlohet qëndrueshmëria e shikuesit për t'u përfshirë në sjellje të ngjashme sic i sheh aty;
2. Mësohen teknika të reja për të sulmuar të tjerët, të cilat kanë qenë të panjohura më parë;
3. Të shikuarit e akteve tjera agresive ndikon shumë ndaj shikuesit që edhe ai të fitojë mendime dhe ide tjera agresive.
4. Të ekspozuarit e përhershëm ndaj dhunës nëpërmjet ekranit mund të pakësojë shqisën emocionale të dhunës dhe të pasojave tragjike të agresivitetit dhe kjo e lehtëson përfshirjen e vëzhguesit në aktet agresive ndaj të tjerëve.

## MEDIUMET E REJA ELEKTRONIKE

Fusha e dytë që me të drejtë vehet në nocionin komunikime masive janë telekomunikimet bashkohore. Sipas definicionit formal telekomunikimet përfshijnë çdo transmision (emitimin ose pranimin e shenjave, sinjalit, tekstit të shkruar, tingujve ose njoftimeve ) të çfardo lloji nëpërmjet fijes së telit, sistemit radiovizuel ose çfardo lloj sistemi tjetër elektromagnetik. Parë në mënyrë strikte, këtu përfshihen radioja dhe televizioni, por, pasi kjo në vetvete është një fushë shumë e gjërë radiodifuzive, nën telekomunikime nënkuptohet se normalisht këtu është përfshirë edhe momenti kur radioja dhe televizioni janë të shkyqura.

Tradicionalisht, shprehja “telekomunikime” përfshin industrinë e telefonit dhe të telegrafit. Me paraqitjen e satelitëve komunikues dhe të kompjuterëve, është zgjeruar nocioni, kështu që ai përfshin edhe transmetimet satelitore dhe të dhënat me link. Viteve të fundit, falë inventivitetit të inxhinierëve të komunikimit paraqitet një arsenal i paparë shërbimesh të cilat i integrojnë kapacitetet e kompjuterit, satelitit, fijeve të qelqta dhe transmetimi në baza elektromagnetike ose në bazë të dritës.

Tani, llogaritur vetëm tregun e konsumit të gjërë të biznesit, kemi postën elektronike, tabelat shpallëse elektronike, videofonet, bazat e të dhënave, videotekstet, faksin, radion celulare (telefonin), telekomunikimet e xhepit, pakon e radiove dhe zgjerimin e pamasë të kapaciteteve satelitore, ndërsa të mos i përmendim edhe shërbimet tradicionale, siç janë teleksi dhe televizioni kabllorik.

Nga fundi i viteve të 80-ta dhe fillimi i viteve të 90-ta të shekullit XX, të arriturat e reja të teknologjisë informative-kompjuterët, telefakset, satelitët, përsosja e makinave për fotokopjim dhe mijëra variante të tjera të telekomunikimit në bazë të teknologjisë së lartë – u përshendetën si “teknologji e lirisë”. Në fakt ndikimi potencial shoqëror i teknologjive të reja gjithnjë është i dyanshëm : ata mund ta centralizojnë dhe / ose ta decentralizojnë fuqinë, ta shtresojnë dhe / ose ta homogjenizojnë kulturën.

Fillimi i këtij revolucioni të përgjithshëm kulturor i cili i përparoi teknologjitë e reja të komunikimit, shkaktoi zvogëlimin e shpejtë të dallimeve dikur shumë të mëdha ndërmjet

sistemeve ekonomike – politike në vendet e zhvilluara. Karakteristika e përgjithshme e të gjitha këtyre sistemeve është pluralizmi politik si shkallë më e rëndësishme e jetës shoqërore; qytetarët kanë pikëpamje të ndryshme e prandaj dëshirojnë të realizojnë qëllime të ndryshme.

Pluralizmi e mbron individin dhe i jep forcë duke i mundësuar të bashkohet vullnetarisht me njerëzit e tjerë që kanë pikëpamje të ngjashme. Ai e nxit të shprehurit e dallimeve normale në mendime dhe paraqet mjetin e veçantë për zhvillimin dhe ndryshimin e shoqërisë, si dhe për t'u mbrojtur nga forca e pushtetit qendror shtetëror. Pluralizmi, gjithashtu, paraqet mekanizmin i cili u mundëson grupeve që edhe përkundër mospajtimeve ndërmjet vete të pranojnë sistemin e përbashkët si të ndershëm dhe të drejtë.

Ekziston mundësi që televizioni, kompakt-disqet, kompjuterët dhe fijet optike të bashkohen në një sistem të vetëm interaktiv, që e përbëjnë atë që quhet „tele-kompjuter”. Paramendoni telekompjuterin i cili përdoret si mjet mësimor. Nëse nxënësi i cili në shtëpi lexon për arkitektur nga ndonjë autor, të mund të përfshihet në sistemin e bibliotekave të largëta të kompjuterizuara dhe sa hap e mbyll sytë të „mbushë” kompakt-diskun digjital me fotografi të qarta me ngjyra dhe me video-incizime të veprave të arkitektëve të mbarë botës. Përveç kësaj, do të mund t'i qasësh edhe tekstit, vizatimeve dhe sqarimeve, të cilat për disa sekonda mund të azhurohen falë fijeve optike. Implikimet në këtë sistem futurist janë të mëdha, ndërsa një të ardhme të këfillë e kemi shumë pranë duarve, sepse teknologjia complete e nevojshme për telekompjuterë momentalisht tanimë është provuar ose zhvillohet shumë shpejt. Ndikimi i insitucioneve siç janë: universitetet, shkollat, bibliotekat dhe muzeumet, do të jetë i madh. Përsosja që fitohet gjatë tërë periudhës së tërësishme të punës do të bëhet realitet.

## REALITETI VIRTUAL

Fëmijët tanimë kanë provuar një numër të madh të lojërave të rëndomta argëtuese— automobila, katrorëzat, trenat, ngarjen e biçikletës, e tjera. Ata me entuziazëm të madh i pranojnë lojërat për të cilat u nevojitet vetëm pak njohuri teknike.

Sot fëmijët shfrytëzojnë çdo rast për të hyrë në dhomën e punës së prindërve të vet me qëllim që të hyjë në kompjuter dhe t'i vehet punës . Ata shkruajnë, luajnë lojera kompjuterike por krijojnë edhe të vetat . Ata kërcejnë nga kënaqësia kur në shtëpi do të paraqitet ndonjë program i ri, por kanë mundësi të bëjnë dhe programe të tyre për qëllime të përpunimit të teksteve të shkruara. Me njohuritë e veta krenohen para moshatarëve dhe të rriturve dhe ia përcjellin vëllait apo motrës më të vogël të cilët shprehin entuziazmin e njejte . Në fakt kur fëmijët do të ulen para kompjuterit përjetojnë një eufori e cila mund të përshkruhet si një lloj ekstaze.

Ku qëndron çështja? Arsimtarët thonë se fëmijët të cilët nuk janë në gjendje të rrinë qetë as dhjetë minuta gjatë orës së mësimt, mund të „ngjiten” për kompjuteri dhe me orë të tëra të luajnë lojëra kompjuterike. Në botën e të moshuarëve, njerëzit që kanë nisur të përdorin kompjuterët për t'i kuptuar gjërat rutinore, dalldisin aq shumë ndaj aparatit të kompjuterit duke e kaluar pranë tij pjesën më të madhe të ditës, shpenzojnë një pjesë të madhe të parave të veta për programe të reja. Programuesit e posakrijuar ulen pranë kompjuterit pasdarke dhe thellohen aq shumë në përpunimin e programit, duke mos lëvizur nga vendi deri në orët e mesnatës.

Debatet më të mëdha për kompjuterët janë orjentuar nga fakti se sa janë ata të dobishëm. A e rrisin produktivitetin? A kryhen punët më mirë dhe më shpejt me apo pa kompjuter? Shpesh bëhet vërejtje se shumë njerëz kompjuterët nuk i shohin vetëm si një „vegël” praktike, por edhe si burim të kënaqësisë.

Kompjuterët gjithsesi se mund të lirojnë nga disa obligime. Fëmijët mund të lirohen nga detyrat që ua japin të rriturit duke u zhytur thellë në lojrat kompjuterike të cilat prindërit e tyre i befasojnë. Shkrimtarët lirohen nga shtypja e lodhshme dhe e mundimshme e konceptit, dhe në vend të kësaj ata mund të ndryshojnë fjalitë dhe fjalët për të ndrequr tekstin. Inxhinierët mund të ndërtojnë dhe të shkatërrojnë konstruktionet gjersa të arrijnë në diçka që duket mirë dhe funksionon mirë – pa pritur që punëtorja makinerike t'ua përpunojë prototipin.

Nëse shfrytëzimi i kompjuterit paraqet kënaqësi, njerëzit do të kalojnë shumë kohë në kompjuterët e tyre, pa marrë parasysh se a është mirë ose keq një gjë e tillë.

Megjithatë, njëloj sikurse fëmijët që u sjellin kënaqësi prindërve të vet, ashtu edhe shfrytëzuesit e kompjuterëve perjetojnë shumë gjëra me makinat e tyre që as për së afërmi nuk i kënaqin. Në fakt, edhe vetë ideja për t'u kënaqur me kompjuterët i habit njerëzit të cilët një gjë e tillë asnjëherë nuk e kanë ndjer. Për ta puna me kompjuterë nuk u shkakton më tepër emocione se sa të punojnë me sqepar. Ata nuk përfshihen në grupet e shfrytëzuesve, nuk vënë lidhje nëpërmjet ankandëve dhe nuk dalldisin pas prodhimeve më të reja. Ky painteresim pjesërisht lidhet me mendimin relative se kompjuterët në tërësi ende kanë forcën e tmerrshme që të shkatërojnë ose të humbin të dhënat.

Është e pakontestueshme se mundësia për përmirësime të pafundshme dhe korrigjime që mundëson kompjuteri nuk është e mirë për vetveten. Drejtorët e firmave ankohen ndaj gjeneratës së re të ekonomistëve të diplomuar të cilët shpesh punojnë në mënyrë të jashtëzakonshme me kompjuter, por nuk e kuptojnë dallimin ndërmjet tabelës së perpunuar bukur dhe analizës logjike të punës. Në fakt , kompjuterët sikur i nxisin njerëzit të merren tej mase me gjëra të parëndësishme dhe të dorës së dytë.

Edhe përkundër kësaj, kombinimi i forcës, lojës dhe vënies së lidhjes ndërmjet shfrytëzuesve dhe aparateve, mund të vërehet posaçërisht te fëmijët. Në shkollë shpesh takohemi me fëmijë të cilët në shkollë nuk arrijnë rezultate të mira. Ata fëmijë ndryshojnë kur do t'u lejohet të punojnë me kompjuter. Ata shfaqin interesim dhe fillojnë të arrijnë rezultate të cilat i habitin edhe arsimtarët edhe prindërit. Fëmijëve u shkaktohet kënaqësi kur punojnë në diçka që duket mjaft e komplikuar. Në disa raste më ekstreme , disa nxënës për të cilët konsiderohej se nuk janë të aftë të ndjekin mësimin, i tejkalojnë shokët e tyre „normalë” të shkollës në shkathësinë për të bërë programe. Ndodh shpesh që fëmijët të cilëve puna e suksesshme me kompjuter u jep vetëbesim, të përmirësojnë suksesin në shkollë.

Një nga supozimet themelore të arsimit është rëndësia e motivimit. Fëmijët (ose të moshuarit) mësojnë atëherë kur mësimi i emocionon. Shumë fëmijë mendojnë se kompjuterët janë dëfryes, prandaj shumë shpejt dhe me efikasitet mësojnë të përdorin kompjuterin si mjet mësimor. Duke përdorur vetëm një program të „PS Globe” fëmijët mund të mësojnë më shumë për gjeografinë botërore dhe si të përdorin mirë shprehjet grafike, se sa mund të mësojnë gjatë një viti nga mësimi konvencional. Fshehtësia qëndron në faktin se fëmijët janë të gatshëm gjithmonë të përpiqen të depërtojnë në informacionet që i përfshin ai program. Ata mund të përdorin enciklopedi ose material tradicionale, por këto as për së afërmi nuk japin kënaqësi. Të gjithë fëmijët mendojnë se puna me kompjuter është mjaft dëfryese.

Nga e gjithë ajo që thamë deri tani mund të vimë në konkluzion dhe të themi se roli i medias dita ditës është duke u rritur. Kjo sidomos në shoqëritë demokratike ku mediat luajnë një rol të rëndësishëm në informimin e qytetarëve për zhvillimet jo vetëm në vendin e tyre por edhe në mbarë botën. Koncepti i komunikimit nuk është i ri për shkak se nga natyra njeriu është qenie komunikimi, dhe tipar i tij kryesor është gjuha, e cila në thelb shërben për të komunikuar. Ndërkaq, historikisht, mjetet e komunikimit janë zhvilluar aq shumë, sidomos me lindjen e shtypshkronjës dhe me mundësinë e riprodhimit të pafund të fjalës falë mediave, sa që komunikimi ka marrë përmasa globale.

Në shoqëritë bashkëkohore njerëzit komunikojnë në mënyra të ndryshme: përmes komunikimit të drejtpërdrejtë në shtëpi dhe në vendet publike; përmes telefonit, faksit dhe postës elektronike; nëpër shkolla, xhami dhe kisha, koncerte, teatro, nëpër takime publike; si dhe përmes të lexuarit, të dëgjuarit, dhe të shikuarit e mediave. Mediat janë sidomos të rëndësishme në shtetet e mëdha dhe teknologjikisht të avancuara, ku shumica e qytetarëve nuk arrijnë asnjëherë të takohen me 99 për qind të bashkëqytetarëve të vet, dhe mediat i kanë si një formë të krijimit të afërsisë me bashkëkombësit.

Në raste kur mediat masive kanë mangësi profesionale ose teknike, ose atëherë kur janë dukshëm propagandistike, zbrazësinë e krijuar e mbushin forma të tjera komunikimi, sado të papërshtatshme qofshin ato. Në nivel politik media ka një rol qendror për përfundimin e demokracisë, sepse përmes informacionit të efektshëm mundësohet pjesëmarrja e qytetarëve në jetën e komunitetit. Pra shoqëria demokratike, me që varet nga një popullatë e informuar mire, e cila di të bëjë zgjidhje politike, është ngushtë e ndërlidhur me komunikimin masiv.

## **VARFERIA**

Varfëria është gjendja në të cilën mungon një sasi e caktuar jetike e pasurisë materiale ose të të hollave. Varfëria absolute apo skamja i referohet mungesës së nevojave themelore të njeriut, të cilat zakonisht përfshijnë ushqimin, ujin, higjienën, veshjen, strehimin, kujdesin shëndetësor dhe arsimimin. Varfëria relative përkufizohet si pabarazi ekonomike në vende apo në shoqëri në të cilën jetojnë njerëzit.



Në pjesën më të madhe të historisë, varfëria është konsideruar gjerësisht si e pashmangshme, pasi mënyrat tradicionale të prodhimit ishin të pamjaftueshme për të dhënë të gjithë popullsisë një standard komod të jetesës. Pas revolucionit industrial, prodhimi masiv në fabrika e bëri pasurimin gjithnjë e më të arritshëm. I një rëndësie shumë të madhe është modernizimi i bujqësisë, në mënyrë që të sigurohet më tepër ushqim për të popullatën. Ofrimi i nevojave themelore në një vend nga ana e shtetit mund të kufizohet nga fenomene të tilla si korrupsionit, ivazioni fiskal, borxhi dhe kushtëzimi i kreditimit si dhe nga largimi i profesionistëve jashtë vendit. Strategjitë themelore për rritjen e të ardhurave zakonisht përfshijnë lirinë ekonomike, sociale, dhe ofrimin e shërbimeve financiare.

Charles Booth ishte nder te paret qe u perpoq te vendoste nje standart te vazhdueshem te varferise se egzistences qe ka te beje me mungesen e kerkesave baze per ruajtjen e nje ekzistence fizike e te shendetshme, ushqim e strehim I mjaftueshem per te bere te mundur funksionimin e efekshem fizik te trupit. Booth mendonte se keto kerkesa do te ishin pak a shume te njejta per njerezit me moshe dhe fizik te njejte qe jetojne ne nje vend. Ky eshte nje thelb koncepti qe perdoret ende me shpesh ne analizen e varferise ne bote.

### **Varferia si problematike shqetesuese**

Varfëria është fati (i hidhur) që shoqërinë njerëzore e ka shoqëruar në të gjitha etapat e saj, dhe si rrjedhojë, edhe pikëpamjet dhe mënyrat për luftimin e saj, si dukuri, kanë qenë të ndryshme. Për shkak të koncepteve të gabuara, vizioneve të paqarta, korrupsionit dhe shkaqeve tjera, shtresat e varfra janë revoltuar shpesh çka për pasojë kanë patur dëme të mëdha për shoqërinë. Shume popuj varfërinë e patën fat të pandarë gjeneratë pas gjenerate, problematikë kjo që do të shtjellohet në këtë ese. Më konkretisht, do të sqarojmë varfërinë si botëkuptim së pari, e më pas

do të bëjmë fjalë për nivelin e varfërisë në botë, varfërinë absolute, shkaqet dhe pasojat e varfërisë, dhe të gjitha këto në kuadër të tre kapitujve përkatës, ndërsa përmbylljen e esesë do ta bëjmë me disa rekomandime për luftimin e kësaj problematike shoqërore.

1. Përkufizimi i varfërisë absolute
2. Varfëria absolute ka të bëjë me mungesën e kërkesave bazë për ruajtjen e ekzistencës fizike e të shëndetshme, ushqim e strehim (mungesa e ujit të pijshëm, e kulmit mbi kokë).

Varfëria absolute përfshin nevojat themelore njerëzore dhe matet në kuadër të mjeteve për mbajtjen e shëndetit dhe aftësive trupore. Shumica e matësve të varfërisë absolute orvaten të vërtetojnë kualitetin dhe kuantitetin e ushqimit, veshjes dhe banimit, e që konsiderohen si të domosdoshëm për jete të shëndetshme. Varfëria absolute zakonisht matet ashtu që përcaktohet çmimi i të mirave themelore për jetë dhe se ky kufi i varfërisë tërhiqet me ndihmën e këtij çmimi duke e definuar si të varfër atë të ardhurat e të cilit nuk arrijnë këtë kufi. Drenowski dhe Scoti kanë bërë një përshkrim të këtyre gjërave elementare, mungesa e të cilave nënkupton prezencën e varfërisë absolute:

- Mungesa e ushqimeve me kalori,
- Mungesa e banimit në përputhje me numrin e anëtarëve të familjes,
- Nevoje themelore është konsideruar edhe shëndeti me kualitetin e shërbimeve shëndetësore dhe me vdekshmërinë e fëmijëve,
- Edhe nevojat kulturore, si arsimi, siguria, koha e lirë dhe dëfrimi, konsiderohen nevoja themelore, mungesa e të cilave aludon në varfërinë absolute.

### **Kush janë te varfërit ?**

Njerëzit në kategoritë e mëposhtme kanë vërtetërisht të ngjare të jetojnë në varfëri: te papunet ata në punë me orar të reduktuar ose të pasiguruar, te moshuarit, te semuret dhe te paafet, si dhe anëtarët e familjeve të mëdha ose të familjeve me një prind.

Rreth gjysma e pensionistëve të moshuar jetojnë në varfëri. Shumë njerëz mund të jenë të paguar në mënyrë të arsyeshme gjatë punës por jetojnë një rënie drastike me daljen në pension.

Familjet me një prind pothuajse të gjitha me kryefamiljare nëna, përbejnë një numër në rritje të varferve. Papunësia e lartë e viteve 1990 nuk duket se mund të bëjë në të ardhmen e afert, ndërsa papunësia e tejzgatur për kryefamiljaret dhe fëmijet e tyre po i shtyn gjithnjë e më shumë familjet drejt varfërisë.



## **Familja dhe varferia**

Ekonomia dhe ndikimi i saj ne familje. Varferia eshte nje faktor qe ndikon ne modelet e familjes dhe ne funksionimin e saj. Ajo eshte aq shume e perhapur saqe sociologet mendojne se ekziston nje kulture e varferise. Nga te dhenat nje numer i madh familjesh jetojne ne varferi, e cila nga ana e saj sjell me vete marxhinalizimin e tyre, izolimin e tyre. Fenomene si emigracioni, papunesia ndikojne duke lene gjurme te thella pikerisht ne keto familje te marxhinalizuara. Te varfra jane gjithashtu familjet me te moshuar. Dallohen dy lloj varferish:- atje ku varferia prek vetem nje pakice-dhe vende ku varferia prek kedo pervec nje pakice. Pergjithesisht vendet ndahen ne baze te nivelit te te ardhurave per fryme ne:-***vende me te ardhura te larta- vende me te ardhura te mesme- vende me te ardhura te uleta.***

Familjet e varfera marxhinalizohen jo per shkak te tyre (sepse nuk jane devijante apo jashte kerkesave sociale), por per shkak te pamundesise se tyre per te marre pjese ne jeten ekonomike, sociale, kulturore. Pergjithesisht quhen te varfer ata qe marrin me pak te ardhura se mesatarja. Ne kete kuptim e varferia eshte relative (eshte ndryshe varferia ne SHBA dhe eshte ndryshe varferia ne Bangladesh). Mungesa e te ardhurave ne familje sjell:

***Tension***

***Ankth***

***Raporte te devijuara nga normalja***

***Nxit braktisje te shkolles, duke ndikuar keshtu ne riciklimin e analfabetizmit.***

Rreth 50% e te ardhurave shkon per ushqim (shpenezimi i nje pjese te madhe te ardhurash

per ushqim eshte karakteristike e varferise, sepse tregon se te ardhurat jane te vogla). Ne keto kushte mund te kete nenushqyerje, e cila shkakton shendet te keq. Varferia eshte nje pasoje direkte e mungeses se punesimit ose keqpagimit te saj. Varferia ndikon ne martesat ne moshe te hershme ose dhe ne te kundert ne vonese te marteses. Varferia ndikon ne bashkejetese te personave qe nuk kane lidhje afektive qofte edhe per te ndare shpenzimet. Ndikon ne zhvillimin dhe agravimin e prostitucionit. Ndikon ne kriminalitet dhe rritjene sjelljeve devijante. Ndikimi i varferise ndikon ne shkalle relativisht te ndryshme ne familjen urbane dhe ne ate rurale. Ne zonat rurale varferia perballohet me lehte dhe me mire se ne zonat urbane. Njerzit ne zonat rurale solidarizohen me njeri-tjetrin duke e patur e te lehte sigurimin e ushqimit. Ne zonat urbane pjesetaret e familjes nuk kane te njejtin bashkepunim per shkak te vete karakteristikave te jetes se qytetit. Varferia eshte e ndryshme nga njeri shtet ne tjetrin, nga nje kulture ne tjetren, nga nje familje tek tjetra. Varferia rrit riskun e femijeve te rrugeve dhe ne shume vende vihet re nje rritje e punes se ketyre femijeve dhe grave. Me te rezikuara ndaj varferise jane familjet me nje prind dhe kryesisht ato familje ku nena eshte kryefamiljare. Ajo qe sot bie ndesh me pasojat e modernizimit eshte lekundja e shtetit dhe deri diku paaftesi e tij per nderhyrje ne familje nepermjet politikave sociale. Per shkak te krizave sot shtetet po priren te zvogelojne nderhyrjet me ane te politikave sociale. Sot vihet re ulje e pages reale per shkak te rritjes se çmimeve dhe kjo sjell ulje te kerkesave per produkte apo aktivitete, te cilat konsiderohen si jo teper te domosdoshme ose jo me rendesi jetike. Ne keto kushte fillon dhe shfrytezimi i punes se te miturve, puna e te cileve ndikon ne riciklim te varferise dhe te rrethit vicioz te saj (jo arsimim, jo te ardhura). Kjo pjese e popullsise merr shume pak nga te ardhurat dhe nga te mirat materiale qe ajo krijon. 80% e popullsise marrin vetem rreth 20% te te ardhurave te krijuara, sepse pasuria eshte e perqendruar ne duart e nje pakice. Varferia ndikon dhe ne rritjen e rasteve te dhunes dhe prirjeve per t'u shfaqur ose bere i dhunshem. Femijet pergjithesisht nuk kane adoleshence dhe rini, ata hyjne shpejt ne pune dhe ne jeten seksuale. kultura e varferise i ben ata te krijojne ndjesi nenshtrimi, dobesie, marxhinalizimi, priren per sjellje devijante, etj. Kultura e varferise eshte pothuajse universale, gjendet ne Paris, Londer, Meksiko, Malte, Shqiperi (kudo). Grupmoshat me te prekura te saj jane te mshuarit, femijet, dhe gjinia femerore.

## **Pabarazia**

Pabarazia mes njerzve i ka rrenjet ne njeriun, kur eshte krijuar njeriu eshte krijuar edhe pabarazia. Cdo qenie e gjalle eshte e bere qe te mos kenaqet me asgje por vetem te kerkoje me shume dhe kjo ka bere qe qeniet e gjalla te mundohen te perfitojne ne shpine te tjetrit.

Qe ne momentin qe disa njerz u bene me te pasur dhe disa ngelen me te varfer nis pabarazia dhe klasat shoqerore, prandaj edhe komunizmi ka si parim kryesor luften e klasave shoqerore dhe pabarazise midis njerzeve.

Ka disa forma te pabarazise midis njerzve dhe shkaqe te ndryshme prej te cilave ndodhin:

Per shkak te diskriminimit social - forma e pabarazise racore, seksuale, fetare, etnike.

Per shkak te klases shoqerore – ndodh nje forme e pabarazise ne familje , si pozicioni shoqeror i prinderve, avantazhe te trashegimit te pasurise., etj.

Per shkak te kapacitetit natyral – sic eshte talenti, shendeti, temperamenti.

Per shkak te fatkeqesive – aksidente, semundje, ngjarje natyrore, falimente te ndryshme.

Ne gjithe shoqerine vihet re nje shperndarje e pabarabarte e burimeve shoqerore, materiale dhe simbolike ndermjet individeve si trashegemia, pasuria, pushteti, prestigji, instruktumi (arsimimi), ku perceptohet pabarazia si nje aks horizontal dhe behet dallimi midis grupeve ne qender dhe atyre ne periferi. Pabarazia shoqerore krijon shume probleme te dhimbshme dhe ekzistojne shume teori per te. Nje nga pyetjet qe shtrohet gjithmone dhe ndonjehere ne menyre spontane eshte qe a mund te kemi nje shoqeri te

barabartesh? Nje shoqeri ku te ekzistojte barazia sociale, e cila eshte ideale dhe i jep cdo njeriu, pavaresisht nga pozicioni i tij shoqeror, mundesine qe te jete i konsideruar ne menyre te barabarte me gjithe te tjeret ne cdo kontekst.

## **Pabarazit shoqërore kundrejt pabarazisë natyrore**

Shumë sisteme stratifikative janë të bazuara në bindjen se pabarazia shoqërore ka mbështetje në sistemin e stratifikimit racor , ku psh : të bardhët pohojn se biologjikisht janë në epërsi kundrejt zezakëve ;dhe këtë e kuptojn si bazë për domini Është dëshmuar si mjaft e rënd të gjendet përgjigja ndërmjet pabarazisë biologjike dhe pabarazisë së krijuar shoqërore .

Zhan Zhak Ruso është njëri ndër autorët e parë që seriozisht u mur me këtë qështje . Ai flet për barazinë e mbështetur biologjike si mbi barazi natyrore – apo fizike , sepse është krijuar nga

natyra , ndërsa ka të bëj me dallime në vite , shëndet gjini , fuqi trupore dhe cilësi të tjera që janë të botës shpirtërore – mentale . Në dallim nga ta pabarazia e krijuar shoqërore përbëhet nga privilegje të ndryshme të cilat disa i gëzojnë në dëm të tjerëve , psh : të jenë më të pasur , të jenë më autoritativ , ose edhe në situatë që dëgjojnë nga të tjerët .

Ruso ka besu se mosbarazia e mbështetur në biologji , që evidente në mes njerëzve është e vogël dhe e parëndësishme derisa pabarazia e krijuar shoqërore përbën bazën kryesore të sistemit të stratifikimit shoqërorë. Shumica e sociologëve do të pajtoheshin me të , mirëpo edhe më tutje mund të dëshmojnë se pabarazit biologjike sa do të vogla e krijojnë një bazë mbi të cilat ngriten pabarazitë shoqërore . Këto pozicione nuk është lehtë të mbrohen në disa forma të stratifikimit ... në përbërjen klasike statusi i individit është i fiksuar me lindje , individi i përket familjes së caktuar dhe pa u marrë parasysh kualitetet e tij nuk ekziston asnjë mënyrë që ai të bëhet psh : Brahman <<shtresa më e lartë>>( pra të kalojë shtresën ) . Argumenti i njëjt mund të përdoret edhe lidhur me sistemin shtetror feudal , sa më tepër që sipërfaqe të tokës të zotëroj një individ aq më e madhe është qmuar pasuria e tij , autoriteti dhe ndikimi i tij . Pozita e stratumit ( shtresës dominante ) është mbështetur me dhuratat të mëdha nga mbreti në formë të pasurisë tokësore . Statusi i kësaj fisnikërie ka qenë trashëguese , me që toka dhe titujt fisnik janë bartur prej gjeneratave në gjenerat . Është vështirë të mbrohet argumenti se pronarëve në instance të fundit pozita e privilegjuar ju siguron epërsia biologjike. Pasi që djali pavarësisht nga “kualitetet biologjike trashëgojnë statusin e babës së vet . Shikuar historikisht mbrojtja më kokëforte e argumentit biologjik shfrytëzohet për sistemet e stratifikimit racor .

### **Pabarazi apo padrejtësi sociale për fëmijet**

Shifra të mëdha dhe të frikshme, që lidhen me pabarazinë sociale, e bëjnë shoqërinë shqiptare që të shfaqet fare e padrejtë para brezave të saj të rinj. Më të rrezikuarit mbeten fëmijët e vegjël. Shifrat janë të frikshme në të gjithë treguesit, por më shqetësuese është pamundësia e optimizimit të së ardhmes së tyre. Pabarazitë sociale janë një nga shkaqet e vuajtjes së kategorive të tëra sociale. Edhe pse është premtuar shumë dhe u premtua sërish shumë në fushatë ka pak gjasa të ndryshojë diçka. Si e shikoni ndikimin e tyre në jetën e fëmijëve (*shumë familje s’ marrin fare ndihmë, mungojnë shumë shërbime, në fshatra të tërë mungojnë ambulancat, korrupsioni, mosnjohja e të drejtave etj., etj.*)...

“Padyshim nuk duhet të kemi shqetësim për ekzistencën e pabarazisë në shoqërinë e sotme shqiptare. Ai është fenomen social universalisht i njohur, i pranuar dhe padyshim ekonomikisht dhe shoqërisht i dobishëm. Në fund të fundit nuk ka shoqëri të lirë, të bazuar në ekonominë e

tregut dhe iniciativën e lirë të individit që të përfytyrohet ekzistenca e barazisë jo në kuptimin egalitarist, por vërshtirë edhe në optikën humane. Gjërat duhen parë ashtu si janë dhe fenomeneve duhet t'u japim emrat dhe kuptimin e tyre social. Por nga ana tjetër pabarazia që nuk është e mundur të shmanget nuk duhet ngatërruar me padrejtësinë sociale, e lidhur me instrumente sociale që deformojnë rrugën e suksesit personal të merituar, të krijimit të avantazheve apo disavantazheve sociale me anë të mjeteve dhe mënyrave jo demokratikë, që burojnë nga nepotizmi, militantizmi partiak, favorizimet në tregun e punës, si dhe nga shumë arsye të tjera. Por pabarazia ka limitet e veta, tejkalimi i të cilave sjell padrejtësi sociale nga e cila vuajnë jo pak njerëz në shoqërinë e sotme shqiptare.

Atë e përjetojnë qindra mijëra njerëz që janë të papunë, afërsisht 100 mijë familjet që jetojnë me ndihmën ekonomike fare modeste, rreth 134 mijë persona me aftësi të kufizuara si të verbër, paraplegjikë e tetraplegjikë. Megjithëse mbështetja financiare dhe sociale për këto kategori njerëzish nuk ka munguar ajo akoma nuk është në nivele konsistente që të mund të zbutë nevojat dhe statusin e tyre të marginalizuar (në ndonjë rast edhe të diskriminuar). Padyshim në këtë tablo shtresa e fëmijëve është ajo që i përjeton më shumë pasojat e situatës ekonomike e sociale të shoqërisë tonë dhe familjes së tyre. Në këtë kontekst duhen rishikuar politikat e mbështetjes së familjeve në nevojë duke adresuar politika të mbështetjes specifike për fëmijët.

## **Perfundimi**

Asgjë nuk i sjell njeriut aq vuajtje dhe mjerim sa varfëria! Vetëm të varfërit e kuptojnë nocionin e plotë të varfërisë. Kur njeriu është teper i varfer mendja e tij pyet pse une? Jeten nuk e shijon aq shumë, lumturia e tij është vetëm të mund ta largojë varferinë për disa kohe, të sjell para fëmijëve dicka për të ngrene, të shohë fëmijet e tij si çdo fëmijë tjetër të pasur. Varferia shkatërron jeten e njeriut dhe lumturinë e tij.

## **GRUPET ETNIKE PAKICAT DHE RACAT**

Grupet etnike, pakicat dhe racat konsiderohen si nocione moderne, por që dita ditës po zhduken ngadal. Këto u krijuan gjatë periudhës së dy luftimeve botërore, kur ndryshuan kufijtë pas shumë

luftrave kombetare. Në kuadër të këtyre ndryshimeve shpesh kishte edhe konflikte të cilat rezultojnë me diskriminim etnik të ndonjërit grup që ishte në pakicë ose ndonjë race. Diskriminimi mund të shprehet në mënyra të ndryshme, por edhe kuptimi i kësaj çështjeje nga njerëzit mund të jetë i ndryshëm. Nëse diçka do të kuptohet si diskriminim apo jo – është një çështje e ndjenjës personale dhe subjektive dhe varet nga botëkuptimet personale të çdo njeriu. Fakt është sesot çdo njeri në këtë apo atë menyrë goditet nga diskriminimi, pasi, në përgjithësi, kultura përbëhet nga sisteme të ndryshme të interpretimit dhe përcaktimeve, të cilat po bëjnë gërshetim të ndërsjellë, kështu që një person mund t'u takoj më shumë kulturave. Parashtrahet pyetja, pse sot gjithnjë e më tepër po flitet për diskriminimin? Kësaj pyetje dhe shumë të tjera do t'i përgjigjemi në punimin në vazhdim ku do të flasim për diskriminimin në kuadër të grupeve etnike pakicave dhe racave.

## **INSTITUCIONETSHOQERORE**

Njeriu si qenie shoqërore nuk mund të egzistojë si individ i izoluar, por jeta e tij domosdoshmë zhvillohet në grupet shoqërore me të ngushta ose me të gjera ose në bashkësinë shoqërore. Në ato e siguron egzistencën e tij dhe zhvillon të gjitha potencialet njerëzore. Që t'i plotësojnë nevojat dhe qëllimet të cilat u janë domosdoshmë njerezve të dobishëm dhe të vlefshëm për shoqërinë. Ato paraqesin njësi bazë të organizuara të cilave njeriu mund t'i plotësojë nevojat e tij. Nëpërmjet institucioneve të tilla dhe me ndihmën e tyre njeriu e kalon tërë jetën e tij prej lindjes në ndonjë spital për lindje deri në shtëpinë e pleqëve. Institucionet të cilat plotësojnë nevojat për ushqim, banim, veshmbathje e të ngjajshme, në të vërtetë nevojat primare materiale që mund të egzistojnë njeriu, bëjnë pjesë në sferën e ekonomisë dhe janë institucione ekonomike.



## **FAMILJA**

Familja ne pergjithsi mund te definohet si grup shoqeror specific dhe kompleks qe eshte e ndryshuar gjat histories, por si bashkesi gjat gjith histories se njerzimit .Ajo eshte grup primar shoqeror per at se eshte krijuar me heret dhe paraqet formen me te qendrueshme te jetes se perbashket te njerzve .Familja eshet grup shoqeror specific me nje kombinim te vacant lidhjesh dhe funksionesh dhe llogaritet si grup themelor. Ne suazen e saj zhvillohen proceset themelore te jetes se njeriut, sic jane reprodukimi i gjinis njerzore, rritja dhe socializimi i femijeve, plotesimi i nevojave ekonomike seksuale psikologjike te njerezve. Te gjith gezimet dhe problemet e jetes thehen ne familje. Ne gjuhen ton kur themi familje mendojm per nje grup njerez te cilet jan te lidhur ne baz te gjakut dhe jetojne se bashku me femijet,se bashku me gjyshin dhe gjyshen xhaxhallaret dhe tezen,nipat kurse eshte e mundshme edhe me familjaret te tjer. Por nje model i tille i familjes pothuajse eshte zhdukur.

Sot me se shpeshti nocioni familje edhe te ne edhe ne numrin me ete madh te vendeve paraqet grup njerezish te cilet jetojn se bashku ne nje vend, te perbere prej nje babait, nezes dhe familjeve te tyre.

### **Farefisi**

Me farefisi nenkuptojm lidhje Bio-Sociale te ndryshme ne mes nje numri te caktuar njerezish,te cilet ne suazen e tipit te familjes jan antaret te saj.Si zakonisht me farefisnin nenkuptohet lidhje gjaku .Por sot ne jeten reale farefisi perputhet vetem pjeserisht ne lidhje biologjike ose te gjakut. Me se pari per shkak se ne te gjitha shoqerit egziston mundesia per adaptim te familjeve, te arritura e mjeksis bashkohore mundesojn qe femna mund te ngelet shtatzen edhe ne menyrt artificiale bile edhe me njeri qe nuk esht buri i saj, ose me implemintimin e qelizave te caktuara jasht organizmit . Kjo do me then se farefisnia mund te realizohet ne rruge natyrore, me lindjen

ne mardhenie martesore ose jasht saj, ateher bejm fjal per farefisni te gjakut. Mund te kriohet edhe ne menyrt artificiale, ne adaptimin e familjes se huaj, ateher bejm fjal per farefisni me adaptim qe u pergjigjen edhe shembujt e shtatzanis artificiale te cilat me par i cekem.

### **Martesa dhe familja**

Martesa paraqet njer nder format me te vjetra ku eshte zhvilluar ,por edhe sot zhvillohet jeta e perbashket e njerezve. Me paraqitjen e familjeve ai vazhdon ne familje ku jan te inkuadruara me shum gjenerata. Martesa eshte lidhje intime dhe e qendrueshme gjinore ne mes dy qenieve njerzore me gjini te ndryshme ne te cilen ngushte jane te lidhura truporja - fizikja dhe shpirtorja- psikologjia

Do te thot martesa, paraqet lidhje heteroseksuale te pranuar nga shoqeria dhe regulluar me doke realigjioze ose me norma ligjore – juridike qe sot eshte shebull me i shpeshte.

Ne shoqerite bashkohore eshte e mundshme mardhenie martesore te vehet ne mese partnereve te nje gjinije.

### **Funksionet e familjes**

Funksionet e familjes gjithashtu jan kategori e ndryshme historike dhe jan ndryshuar ne pajtim me disa ndryshime te tjera shoqerore. Ne mes funksioneve te saj ete shumta si me te rendesishme dhe pergjithshme ceken: Funkzioni biologjik, ekonomik dhe socializues. Funksionet biologjike: Perbehen ne plotesimin e istiktit gjinor dhe vazhdimisht e gjinis njerzore, nete vertet krijimin e pasardhsve.

Ne te kaluar keto funksione kan qene ne pajtuesmeri, kurse me von ka ardhur deri te ndarja. Funksionet ekonomike:Perbehen ne sigurimin e mjeteve matriale per ekzistenc te antareve te familjes.Me par familja ka qen bashkesi prodhuese-konsumuese, kurse sot eshte vetem konsumuese per shkak se prodhohet ose fitohet jasht familjes, kurse konsumohet ne familje. Arsimi dhe edukimi:Ne te vertet funksionet socializuese jan detyra shum te rendesishme te faliljes .Antati i ri i familjes nepermes familjes lidhet me bashkesin me te gjerme te vertet inkuadrohet ne jeten shoqerore.

### **Autoriteti ne familje**

Familja sic ekziston sot, nuk ka ekzistuar gjithmon .Nje numer i madh i hulumtimeve kan treguar se ajo eshte ndryshuar edhe per nga forma edhe per nga permbajtja Prej gjysmes se shekullit te kaluar paraqitet ndryshime te medha ne aspekt te autoritetit ne familje. Nje koh te gjat autoriteti i burrit ka qene i padiskuteueshem, gruaja dhe femijet eshte

dashur vetem qe ti plotesojne urdhurat dhe deshirat e tij, pa as nje te drejt. Mardheniet e tilla jo demokratike kane ekzistuar edhe kan qene karakteristike e familjes patriarkale, kurse ato i ka permbajtur edhe kisha

### **Familja ne kohen bashkohore:**

Evolucioni i familjes sot ka sjell nje situate qe ne nje numer te madh te vendeve, vecmas ato me te zhvilluarat, te dominoj familja bashkohore demokratike. Ate e perbejn vetem prinderit dhe femijet e tyre te mitur. Martesa lidhet ne baz te afiniteteve individuale, e bazuar ne mirkuptimin dhe dashurin. Mutacionet e familjes bashkohore jane shume te rendesishme. Si asnjehere me pare familja duhet te percaktohet ne shumes, ne te vertet te kuptohet se ekzistojn modele te ndryshme me vlera te cilat duhet respektohet si elemente evolutive te jetes shoqerore.

## **RELIGJIONI**

Perkufizimi i religjionit: Religjioni eshte nje nder fenomenet me komplekse shoqerore. Shikuar

ne aspektin shkencor, rend mund te definohet. Kjo vjen prej asaj se religjioni deperton ne sfetar me intime te jetes se njeriut.

Shpesh thuhet se ajo eshte pun private e cdo individi, dicka qe ruhet thell ne zemer e individit. Religjioni eshte aktivitet i njeriut dhe i takon njeriut, para se gjithash si individ. I pa mohueshem eshte fakti se religjioni ndikon ne shoqeri, kurse njekohsisht edhe shoqeria ndikon ne religjion. Ajo eshte pjes e kultures te cdo bashkiesie shoqerore dhe si e till vihet ende prej fillimit te histories se njeriut dhe qendron deri ne ditet e sotme. Ne qoft se deshirojm ne menyra te rendomt ta religjionin, ate do mund ta benim ne pakuqizim se paraqet besim ne mbinatyror. Besimi mbi qenien mbi natyrore eshte e gjitha ajo qe eshte e shkruar per ate ne liberat e shejt eshte baz e xhdo religjioni. Ketu ekzistojn dy dimensione. I pari eshte besimi ne fuqin absolute dhe persosshmerija e qenies mbinatyrore (qenie te hinduizmi si religjion politeist). I dyti eshte besimi pa kushte ne gjith at qka shkruan ne librat e shejt si p.sh: Bibla, Kurani, Teverati, librat e shejt budistike. Komponenta e dyt e religjionit jan ndenjet religjioze. Eshte normale per at se behet fjal per persosshmeri absolute te gjithdijeshme dhe qenie te gjithfuqishme, qe ne jriu te ndjej ndaj ti ndjenja te posacme. Komponenta ose elementi i trete i religjionit jan ritualet ose ceremonit. Nepermes ritualeve njeriu mundohet qe te vere kontakt me qenien mbinatyrore. Elementi i katerte i religjionit jan simbolet. Cdo religjion ka permbledhje te veta simbolesh me te cilat shperbehet edhe te cilat i mundesojn besimtarit te realizoj te ashtequajturin te mendimit simbolik. Ne fund elementi I fundit i religjionit jan organizatat religjioze. Ato u ndihmojn njerzve ne besim te njejt religjioz qe te bashkohet ne grup te vecanete besimtaresh.

### **Funksionet e religjionit**

Funksioni i par qendron ne ate se religjioni u ndihmon individeve qe te formojn shikim te vetin per boten. Kuptohet se ai shikim per boten te besimtarete religjioz. Ne bazen e tij egzistojn dy karakteristika. Ai ne te njejten kohe eshte dualist spiritualist. Shum eshte i rendesishem edhe roli emocional dhe psikologjik ose kompensues i religjionit. Ky funksion ndihmon ne tejkalimin e problemeve akzistenciale dhe veshtirsive te njeriur. Religjioni ne shum menyra i ndihmon besimtarit psikologjikisht ta tejkaloj ndjenjen e frikes nga vdekja si e para futet ideja se vdekja e njeriut eshte pasoj e gabimit te par (thyerjen e urdherit te Zotit te Ademit dhe Haves qe most a hane prej drurit per ta njohur te miren dhe te keqen).

**Funksioni etnik** i religjionit qendron ne formimin e rregullave themelore morale te cilat duhet respektuar praktikuar nga ana e besimtareve. Ne te vertet ne baze te tyre percaktohen menytrat dhe ruga e veprimit njerzor. Regullat moral ne nje menyra te qarte jane dhene ne librat e shejte. Regullat me te vjetra morale religjioze jane dhjete urdhurat e Zotit te cialt Musa i ka pranuar

prej Zotit ne kodren e Sinanit. Ne krishterizem Islami, judeizmi dhe disa religjione te tjera, ato jan baz prej ku eshte piknisja per zhvillimin e regullave morale. Me von ata persona te krishterizmit prej mesimeve e besteve te Jezu Krishtit te cilat jan te dhena ne Dhjaten e Re, te feja Islamit nepermes regullave dhe normave te cilat i ka Muhamedi ku ne menyre koncizme jan te perbashkta ne Kuranin: regullat e sjelljes te cilat jan te dhena ne Tevard si liber i shejt I ebrejsve etj.

### **Llojet e religjioneve**

Krishterizmi eshte religjion te i cili qenia mbinatyrore i zbulon qellimet dhe porosite tij nepermens Jezu Krishtit, i cili eshte I derguari i Zotit dhe njekohsisht dhe themelues i krishterizmit. Qenia mbi natyrore per t'i zbuluar te vertetat e tij amshueshe shendrohet fytyren e njeriut, ne fytyren e djalit te Zotit. Krishterizmi eshte religjion monoteist, besim ne nje Zot, i cili eshte krijues i vetem dhe permbajtes i gjith asaj qe egziston. Islami eshte religjion me i ri universal boteror. Njelloj sikurse edhe krishterizmi, ai eshte besimi monoteist. Ate e zbuloi i derguari i Zotit Muhamedi i cili e shpall fjalen e Zotit. Zoti i paraqitet nepermes engjullit (Xhibrilit). Ai ne njer shpell ne Meke ia percjelli te gjitha porositet, idete rregullat dhe normat te cilat Muhamedi vetem duhet t'ua percjell njerzve. Besohet se Muhamedi i ka kaluar transreligjioz, kurse pas saj ka filluar t'i tregoj fjalet e Zotit. Kjo ka ndodhur ne vitet 40 te jetes se tij. Pra kesaj ai ka jetuar nje jete praktike te perditshme. Rinine e ka jetuar si vobeket, por pasi eshte martuar me te vjen e pasur Hatixhja, jeta e tij ne menyre drastike ka ndryshuar.

Behet tregtar i pasur dhe ka udhetuar shume neper bot. Ne ate menyre takohet me idet e krishterizmit dhe judeizmit te hershem. Ateher kan filluar ta preokupojn ceshtjet fetare dhe morale. Dikuh ka viti 610 te eres sone i paraqitet Zoti nepermes Xhebrailit prej ku fillon kthesa e madhe e jetes se Muhamedit. Prej ateher si behet udheheqes fetar, reformator dhe burra shteti i madh arab dhe, nenkuptohet themelues i Islamit. Judizmi eshte religjion me i vjeter monoteist. Eshte paraqitur diku 1000 vjet para krishtit. Ai eshte religjioni i ebrejve ku ne fillim te ekzistimit te vet kan jetuar ne Egjipt dhe ne disa vise tjera. Kan qen te rethuar me popuj te cilet kan pasur religjion politeist dhe te paret e kan promovuar iden e ekzistimit ten nje zoti (Jahve). Ne shkrimet e dhjates qendron se njerzitet e par qe kan jetuar ne tok jan prejardhje e erbrit. Hiduizmi eshte religjion politeist. Ai eshte i shumllojshem dhe me shum do te thonim se eshte konglomerat i mesimeve te ndryshme fetare se sa sistem i njete realigjioz. Ne ate ekzistojn nje numer i madh kultesh dhe mesimeh per to. Ideja themelore e hiduizmit eshte process i vazhdueshem i lindjes, vdekjes, lindjes e cila perseritet. Me e perhapur eshte ne indi. Budizmi, konfucionizmi dhe taoizmi jane religjione tipike etike ne Lindjen e larget. Te ato

nuk ekziston ideja per Zotin, por idealet etike me ndihmen e te cilave besimtares fitojn qetesin shpirtore dhe jan ne harmoni me unverzumin e perbashket. Tipet e organizatave religjioze dhe levizjeve religjioze sotKur behet fjal per organizatat religjioze, mund te themi se ne te rendesishme sot jan kishtat, denominacionet dhe sektet. Kisha paraqet organizat formale te madhe religjioze.

Madhesia do te thot se ne ate jan antarsuar nje numer i madh besimtaresh, kryesisht pa dallim te situates te tyre sociale. Ne kisha si zakonisht ka perfaqshues prej te gjitha shtresave te bashkesis shoqerore globale.Kisha ortodokse po thuhet pa perjashtim indetifikohet me shtetin ne te cilen vepron (kishaortodokse Ruse, kisha ortodokse Serbe, kisha ortodokse Maqedone, kisha ortodokse Bullgare etj.). Te gjitha keto kisha kan status te barabart dhe bashkpunojn ne mes vete ne te gjitha fushta. Ne baz te kesaj, shteti Islamik bazen e vet e ka ne Allahun dhe Kuranin si liber i shejte. Demoinacionet jane organizat religjioze te cilat kane me pak antare prej kishes dominante ne nje shtet p.sh denminacionet i metodistve ne Britanin e Madhe ka reth 700 mije antare. Denominacionet me te rendesishme jan metodistet dhe evangelistet, ndersa sektet me te njohura jane adventistet e dites se shtate, deshmitaret e Jehovi, baptistet edhe me shum te tjera.

## **POLITIKA, PUSHTETI DHE SHTETI**

Karakteristikat e shtetit: Sic na eshte e njohur, shoqeria eshte krijuar si shprehje e deshires dhe nevojave te njerzve per jet te perbashket qe mund te ekzistojn. Qe do te thot shoqeria eshte kategori historike komplekse dhe eshte korniz e jetes se perbashket te njerzve. Nje kategori tjeter historike eshte shteti. Shteti eshte prodhim I shoqeris. Ai paraqitet ne njer shkall te caktuar te zhvillimit shoqeror dhe direct eshte I lidhur me meshum kushte qe eshte dashtur te plotesohen qe tem und te konstitohet nje bashkesi politike sic eshte shteti. Shikuar nga aspekti historik, shteti eshte krijuar ne menyra te ndryshme. Duke mos hyre ne shpejgime te gjera vetem do te cekim faktin se shtete antike dhe te vjetra jan te krijuara ne baz te lidhjeve faresisnore dhe patrikale te cilat me von jan zgjeruar me ndihmen e normave te perbashkta dhe aparate te ndryshme te forces.Si plotesim i ksaj duhet ta perkufizojm edhe pushtetin. Ai paraqet edhe shfrytezimin legjitim te fuqis qe u takon atyre te cilet e drejtojn shtetin. Me nocionin legjitimet percaktohen fakti se ata qe jan nen dikimin e pushteit te shtetit, me ket teresisht pajtohen. Ne anen tjeter fuqia eshte aftesi e individeve ose grupeve qe t'i realizojn interesat dhe nevojat e tyre sikur edhe t'i kundershohet dikush.

**Shteti modern dhe te drejtat qytetare .**

Prej kur e vertetuar aparatit kategorial, tash do ta kemi me lehtë që ta kuptojmë thelbin e shteteve moderne dhe karakteristikat e tyre me të rëndësishme. Dirkemi ka menduar se shteti konstituohet në një territor të caktuar, në të cilin banorët e tij kanë pothuajse kulturë, traditë, religjion dhe doke të njëjta. Për këtë edhe paraqiten norma dhe rregulla të përbashkëta të cilat mundohen t'i respektojnë antarët e asaj bashkësie.

Do të thotë shteti bazohet në një traditë të vullnetit dhe vetdijes së qytetarëve të vet. Shtetet e sotshme kanë sovranitet mbi territorin e vet. Edin se me parë kufit në mes shteteve nuk kanë qenë kategori e vazhdueshme dhe nuk kanë qenë qartë të shënuara. Në shoqëri tradicionale numri më i madh i qytetarëve nuk kanë qenë të vetdijshëm për të drejtat dhe liritë e tyre. Shtetet moderne, bëjnë përpjekje të mëdha në edukimin e qytetarëve të vet për të drejtat dhe liritë qytetare. Me në fund parashtohet pyetja cilat janë karakteristikat emine të shteteve bashkohore të cilat ekzistojnë në kohën e sotme. Në bazë të Gidensit, shtetet e civilizimit bashkohor i karakterizojnë tri karakteristikat themelore. Ato janë sovraniteti, shtetësia dhe nacionalizmi .

### **Partit politike**

Një ndër kategorit universale të tjerave të cilat nuk janë shumë në numër është politika dhe proceset politike. Politika paraqet veprimtari më interesant të përgjithshme për të gjithë antarët e bashkësisë shoqërore. Në bashkësi shoqërore në të njëjtën kohë dhe hapësirë ndikojnë interesat të ndryshme kundërthënies të organizatave politike. Cdonjëra prej këtyre organizatave vlerat dhe idetë e veta i paraqesin si vlera të tërësishme shoqërisë. Përveç kësaj kundërthënies është edhe raporti në mes veprimtarisë njerzore dhe politike. . Kundërthënies është edhe raporti në mes orientimit politik dhe realitetit. Por kjo në veprimtarinë politike tërësisht mund të shtrembohet, ku interesi publik mund të shëndrohet në interes personal të atij që merret me politikë. Politika më së shpeshti instualizohet në shoqëri nëpërmes partive politike. Ato kanë rëndësi të madhe në shoqërinë bashkohore .

**Programi politik.** Në atë parti politike i paraqesin orientimet programore, pikpamjet për atë se i duhet të zgjedhen aktuale shoqërore – politike të gjitha sferave të jetës shoqërore, qëllimet politike dhe mjetet me të cilat planifikohen të realizohen ato qëllime.

**-Struktura e organizatave.** Cdo parti doemos të ketë formë nëpërmes të cilave do të bëjë projekte që t'i realizojë qëllimet e saja . Ekzistojnë tipe të ndryshme të partive politike. Diverzhe partit politike i ndan në kadrovike dhe masovike. Partit kadrovike janë krijuar në shekullin XIX. Ato nuk kanë pasur interes që të tërheqin numër të madh të antarëve, por interesi kryesor ka qenë që të tërheqin antarët me autoritet të përbashkët shoqëror në të cilin veprojnë. Partit masovike

tentojn per antarsi me te madhe. Keto parti fillimin e kan te levizjet socialiste, partit komuniste dhe partit fashiste.

### **Sistemet partiake**

Kur behet fjalt per sistemet partiake sot ne bot ekzistojn tre tipe.

**Sistemet njer partiake** ekziston ne vendet me pushtet jo demokratik si psh. Koreja Veriore, Kuba etj.. Atje zgjedhsit nuk mund ta ndrojn partin ne pushtet per shkak se nuk kan oposion tjetet.

Ne disa vende ekziston sistemi bipartiak ku **dy parti** ose (kualicioni) luftojn per te mar pushtetin. Te tilla jan Britania e Madhe (Partia Konservative dhe Laburiste), Greqia (Pasoku dhe Demokracia e Re), Gjermania (Krishteore-demokrate dhe social-demokrat), dhe ne SHBA (Partia Demokratike dhe Republikane).

Ne boten bashkohore me prezent eshte **sistemi shumpartiak** ku me shum parti bejn gara per te mar pushtetin. Sisteme te ketilla ka edhe ne Republikën e Maqedonise

### **Demokracia**

Demokracia shte kategori shoqerore e cila lidhet me te drejtat dhe lirit e qytetarve, si dhe per menyren e konstituimit dhe funksionimit te pushtetit ne njer shoqeri . Demokracia sot paraqet nje levizje e cila eshte enderr e njerzve. Funkcioni praktik i saj edhe me tutje eshte plot me te pa njohura dhe pasiguri. Ajo eshte model i rregullimit kah e cila tentojn te gjitha vendet pas renimit te modeleve socialiste te pushtetit. Per shoqeri demokratike llogaritet ato te cilat mundesojn liri te gjer te shprehurit, te folurit, lirin e mediumve, lirin e besimit fetar e drejta e mbrojtjes se barabarte me ligj, proces te drejta gjygsore. Gjithashtu ajo eshte sistem shoqeror ne te cilen qytetaret i zgjedhin perfaqsesit e pushtetit, bejn kontrollin e punes se tyre dhe kane te drejt t'i ndertojn bartesit e pushtetit . Ajo te vazhdoj historia qe te hap dyert e liris dhe demokracis, varet nga mencuria kolektive e vet popujve dhe veprimet praktik gjat zgjedhjeve te liderve politik nga ana e popullit.



## **ARSIMI**

-Arsimi dhe shoqeria: Ne shoqerit bashkohore demokratike shteti ne vete merr pergjegjsin per arsimin e qytetarve te vet. Cdo qytetar ka te drejt ne arsim. Per kete qellim shteti organizon institucione formale te cilat merren me kete veprimtari. Ajo i organizon dhe e regullon arsimin fillor, te mesem dhe te larte. Arsimi fillor eshte i domosdoshem dhe pa pagese po thuaj ne te gjitha shtetet moderne. Ne te gjitha keto institucione eshte i punsuar kuader profesional I cili ka detyr shum me pergjigjesi per arsimin e qytetareve. Perverc institucioneve arsimore shtetore, sot ekzistojn edhe institucione private arsimore si shkolla te mesme dhe per arsim te larte. Redh 90% e populates ne shoqerin bashkohore dijn te lexojn dhe te shkruajn. Te gjith ne dim se ne cfar shoqerie jetojm dhe kemi informata per vendin ton dhe per shum shtete rredh nesh. Ato informata i marim prej librave dhe prej mjeteve per komunikim masiv neprmjet internetit etj. Arsimi indivit jep dituri baze, aftesi intelektuale, aftesi manuele, aftesi per te menduar gje gjykuar, ideale, qendrime, moivacion, kuptim per pergjigjesi shoqerore dhe kuptim me te gjer per boten. Prej kur ta mesoj gjith ket njeriu i ri ne teresi do te inkuadrohet ne proceset kulturore dhe shoqerore. Sipas Robert Menton ekzistojn dy tipe funksionesh te arsimit edhe te manifeste dhe latente

**Ne funksionet manifeste mejn pjes :**

- **funkzioni socializues (nxensit i mesojn rolet e te rriturve);**
- **funkzioni per integrim social (arsimi e forcon homogjenitetinne shoqeri);**
- **funkzioni inovues (krijimi I diturive te reja);**
- **funkzioni per stervitje dhe aftesi per pune);**
- **funkzioni I selektimit (rigrupimi I nxensve ne te pa suksesshem, mesatar te sukseshem dhe me te sukseshem).**

**Ne funksionet latente bejne pjese:**

- **zvoglimi i kontrollit te prinderve;**
- **funkzioni i ruajtjes se familjes – sherbimi shtepijak;**
- **kontrolli i martesave te ardhshme (formimi i qendrimeve per gjinin e kundert);**
- **reduktimi i ofertes se punes (studente e zvoglojne perqindjen e papunsise me ate qe nuk evidentohen ne Byrone per punsime);**
- **kundershtimi i njerzve te rinj normave dhe traditave shoqerore.**

## **Arsimi dhe shanset per jete**

Arsimi ne njer menyre eshte i lidhur me me zhvillimin e demokracis ne nje shoqeri. Disa teroticiente mendojn se arsimin do te ndihmoj qe te zvoglohen pabarazit shoqerore. Ne qoft se i jepet shans cdo njeri te ri qe ti tregoj te gjitha kualitetet e veta ne arsimin e institualizuar, ai fiton shans qe te marre diploma per te cilen pretendon.

Me kete kete do t'u mundesohej edhe antareve te shtresave sociale me te ulta te paraparojm ne shkallen e stratifikimit shoqeror. Gjith ashtu vet arsimi ben seleksionizmin e nxenseve me vendosjen e tij klerakike Ne pjesen e femijeve pr per shkak te pa mundesis per shkollim per shkollim te matutjeshem, e mbarojn ende ne shkollim fillor. Nje grup femijesh vazhdojn ne hkollen e mesme elite, kurse te tjeret mbarojn shkollimin e tyre ne shkollat e mesme trivjecare. Per dallim prej tyre prindet e shtreses se mesme jetesisht jane te interesuar qe femijet e tyre te kryejn arsim te lart Femijet qe rjedhin prej ketyre shtresave pa kusht duhet t'i tejkalojn prinderit ne shkallen e arsimit, karieren dhe suksesin ne jet Ne fund parashtrohet pyetja cfar ardhmerie ka arsimi te ne dhe ne bot. Pa medyshje qendron fakti se te ariturat shkencore shkojn perpara me shpejtesi astronomike.

## **Grupet etnike, pakicat dhe racat si nocione**

Për të paraqitur më së miri problematiken apo zanafillën e kësaj problematike , do të marrim një shëmbull nga Japonia: Bëhet fjalë për pakicën e njohur ne Japoni si eta e cila më von do të quhet burakominë Eta është nje grup njerëzish ne Japoni, që nuk dallonin nga japonzët as nga tiparët por as nga religjioni. Ky grup u formua pa dëshirën e tyre ne kohen e feudalizmit, kur feudalët kolonizuan vendet e tyre dhe këto si pa zgjidhje filluan të enden nëpër rruge. Mbetën endacak tani e tutje, këta do të diskriminohen (de jure dhe de facto) nga shumica. Ishin skllav në vendin e tyre, pasi qe ishin të autorizuar të bënin punët e papastërta, punët të cilat nuk bënte pjesa tjetër e popullit. Ky diskriminim de jure mbaroji ne shek XIX kur filloi modernizimi Japonisë. Dekreti I perandorit tani u jep me shumë te drejta këtyre: u lejohet te bëjnë cfar do pune, pasi tani nuk e kanë të obliguar te bëjnë vetëm punët e papastërta; mund te ndryshonin vend banimin, pasi tani nuk e kanë të detyratur të jetonin vetëm në një vend; mund të martoheshin edhe me joburakuminë . Me largimin e diskriminimit de jure, nuk largohet diskriminimi de facto. Diskriminimi ne realitet, akoma nuk u zhduk, edhe pse u zhdukën ligjet

diskriminuere. Akoma popullsia joburakumine e diskreminon burakominin, akoma burakominët jetojne në vendbanime te vecanta, akoma bëjnë ptunë të papastra dhe pa pagesa, dhe akoma konsiderohet e turpshme martesë me burakominët ,edhe pse nuk ishte e ndaluar tani. Ato akoma konsiderohen inferiorë nga ana mendore të pa aftë për të patur një sjellje të lartë morale , agresivë, impulsive dhe që u mungon cdo nocion ipastëertisë apo sjelljes. Këto tri nocione I dedikohen një grupi të njerëzve , qe kanë gjuhë histori ,fejë dhe kulturë të ndryshme në krahasim me palën tjetër. E perbashkëta e grupeve etnike, pakicave (minoriteteve) është se jetojnë në një rend politik-ekonomik të përbashkët , pavarsisht atyre dallimeve të lartëpërmendura . Pra edhe pse kane dallime më shumë se ngjajshmëritë , ato jetojnë mbrenda te njejtit kufi. Egzistimi i këtyre grupeve etnike , pakicave dhe racave mundëson që një shtet të jetë multietnik. Multietniciteti I atij shteti vazhdimisht është në rënie , pasi gjithmon këto shtete përfundojnë si shtete monoetnike , duke përdorur dy mekanizma: 1:Asimilimine grupeve etnike dhe pakicave ose 2: Ndarjen e shtetit sipas etnive (shkatërimi I shtetit multietnik, dhe krijimi I shteteve monoetnike) Këto dy zgjidhje janë të domosdoshme për një shoqëri kjo është vërtetu shumë herë , pasi si gjithmonë shumica si gjithmon shumica vatzhdimisht sulmon në mënyr të ndryshme joshumicën (grupet apo pakicat etnike). Vetë këto grupe e konsiderojnë veten ndryshe nga shumica (për shkak kulturës, gjuhës, tradites...së tyre ),por më vonë dhe shteti fillon ti konsideron të veqanta , pastaj edhe diskriminon . Ja se si përshtet një shtet me kultura të ndryshme konsiderohet si pasuri e jo dobësi e atij vendi : Në birmani, ashtu siç Java ndoshta gjëja e parë që I bënë përshtypje vizitorit është shumëllojshmëria e njerëzve –europjanë ,kinezë ,indianë dhe vendas. Në një kuptim të ngushtë:këtu kemi të bëjmë më një përzierje por njerëzit nuk bashkohen; aty egziston një shoqëri kluraliste ku pjesët e ndryshme të komuniteteve jetojnë krahas krahas por të shkëputura mbrenda të njëjtës njësi politike (Furnivall,1956). Sipas shume sociologëve , grupet pakicat etnike kanë disa karakteristika : ato për shkak të diskriminimit që I bënë shumica apo sistemi janë vazhdimisht në stagnim (ndonjëherë edhe regres ); antarëte saj janë të bashkuara , pasi ato I bashkon paragjykimi dhe diskriminimi që I bënë shumica; jetojnë në vende te caktuara të izuluara që te mbrojnë veqoritë e tyre ; ato bëjnë martesë endegamike (martesë brenda grupit).

## **Superioriteti dhe inferioriteti i një grupi etnik apo race**

Përveq dallimeve etnike, në shekujt e fundit u paraqiteën edhe dallimet është kryetari i Gjermanisë naziste , Adolf Hitleri , I cili politikën e tij për të bardhtë e kishte hartu si platformë politike. Ai të bardhtë gjermanë I konsideronte të shenjtë , ndërsa qifutët (herbrenjtë), sllavët dhe romët I konsideronte si raca të papastra njerzore duke I konsideruar si shkatëruesit e njerzimit. Për këtë arsye ai e nisi holokaustin e cila sipas tij konsiderohet sipastrim I njerzimit nga papastërtia. Raca gjermane është pasardhëse e races ariane (popull që ka jetuar më pare, dhe është zhdukur ) dhe racë e pastër , dhe si e tillë duhet ta sundojë botën...disa popuj duhet të zhduken nga faqja e dheut si herbrenjtë romët dhe sllavët. Hitleri në mënyra të ndryshme e zhvilloi holokaustin , krijon burgje dhe kampe të përqendrimit ku ishin të vendosur njerzit e pushtuar nga blloku nazi-fashistë .Në këto kampe ( më I nohuri I Aushvicit ) qifutët torturoheshin dhe mbyteshin. Me të torturuarit (bëheshin eksperimente medicinale,ndërsa shumë të pranishëm që nuk praninin tortua dhe eksperimente bënin vetvrasje. Mënyra e vrasjes së njerëzve nëpër kampe ishte e ndryshme : vrasje me bomba , me armë zjari, me pushkatim dhe nga vetëtortura e madhe . Por vazhdimisht mvënyrat e zhvillimit të holokaustit ndryshonin. Filluan të përdorin mënyrën e mbytjes së njerëzve në dhoma gazi.Duke e shfrytëzuar këtë mënyrë , mbrenda dites mbytnin 20 000 njerëz (shumica e tyre qifutë) , ndërsa për zhdukjen e gjurmëve ,trupat e pajetë gjuheshin në fura me temperature të larta. Hitleri kishte zgjidhje dhe për ato gjysëm-qifutët:dëbimin ose meigrimin nën presionin shtetëror sterelizimin asimilimi.Më shumë preferohet asimilimi edhe pse do të zgjatë më shumë kohë. Hitleri vazhdimisht mendonte se qifutët gjithnjë janë treguar budallenj. Një dëshmitar rasti shumë mirë paraqet njëren nga mënyrat e holokaustit nga ana e njërive të Adolf Hitlerit “I erdha rrotull një prigu të madh dheu dhe u gjenda përpara një grope gjigande . Njerzit mbrenda saj ishin aq të shumta e të ngjeshur me njëri tjetrin saqë vetëm kokat u dalloheshin .Disa të pushkatuar lëviznin akoma. Disa ngrinin krahun e kthenin kokën për të treguar qe ishin akoma gjallë .Gropa ishte e mbushur në tre të katërtat . Sipas asaj që pash, mendoj se duhet të këtë qenë rreth njëmijë njerëz. Pokërkoja të shihja vrasesin . Ishte nje SS , që qëndronte I ulur në buzë të gropës me këmbët që I vareshin mbrenda asaj, me mitralozin mbi gjunjë duke pirë cigare. Viktimat plotësisht të zhveshura zbresin në gropë nëpër një shkallë të sajuar duke gërmuar dheun ecin nëpër kufoma etjera dhe ndalonin aty ku thoshte SS-i . Ata shtriheshin mbi kufomat e egzekutuara, këmbenin

ndonjë fjalë më zë të ulët me të mbijëtuari . Pastaj dëgjoja breshëqritë etjerë të mitralozit! Pra nocioni race sipas hitlerit nuk është vetëm grupe me tipare të ndryshme por edhe me kulturë, religjion dhe histori të ndryshme. Sotë më shumë shprehja race përdoret për njerëzit me veti të ndryshme biologjike. Shumë sociologë duke u bazuar në këtë veti (pamjen e lëkures flokët,ndonjëherë buzët) ato nxjerrin raca të ndryshme disa nxjerrin tri disa katër , por ka nga të tillë që nxjerrin edhe pesë . Për këtë, përdorimi i termit racë konsiderohet si joshkencore , pasi nuk ka ndonjë bazë aspect ose kategori e cila do të diferencoj racat. Gjitha këto dallime qofshin etnike , religjioze , kulturore apo edhe racore, vazhdimisht shoqërohen me diskriminimin , pabarazi e cila arinë në antagonizëm ,antagonizëm i cili nuk u ndërpre vazhdon deri në antagonizmin me ekstrem në kryengritje revolucion apo dhe luftë. Gjitha këto mosmarveshje mes këtyre grupeve kanë dy arsye : \*

### **ARSYETIMI PSIKOLOGJIK , DHE \***

#### **ARSYETIMIN SOCIOLOGJIK**

*ARSYETIMI PSIKOLOGJIK* Arsyetimi psikologjik është arsyetimi bazë . Ky arsyetim si bazë ka paragjykimin. Paragjykimi konsiderohet mendim , bindje që një njeri grup.Ky paragjykim do të jetë gjallë edhe në qoftë së më informacion që janë në kundërshtim të plotë me atë paragjykim .Paragjykimi mbetet vetëm paragjykim nëqoftëse ai nuk ndikon në sjelljet e atij personi. Kur paragjykimi pot ë ndikon në sjellje e një personi grupi ai paragjykim më do të njihet si diskriminim. Pra diskriminimi është pasuese e paragjykimit, që i përjashton nga të gjithë. Diskriminimi mundet të krijohet edhe pa ndihmën e paragjykimit. Paragjykimi në shumicën e rasteve bashkëjetojnë edhe me stereotipin. Stereotipi mundet të definohet si të fajsuarit pa fajë. Stereotipi në disa raste konsiderohet si dicka normale vetëm atëherë kur nuk shoqërohet me shqetësim dhe frikë e kur shoqërohet me shqetësim dhe frikë ai stereotip është i dëmshëm dhe konsiderohet si kriminel. Nëse mendojmë se gjithë sllavët janë vrasës si gjithë politikanët sllavë atëherë jossllavët që frikë vazhdimisht do të vrasin sllavë kudo që shohin , duke menduar se edhe ato janë si sllavët politikanë . E kur vrasim sllavë (jopolitikanë), duke pasur frikën se edhe ai është një sllav (politikan) atëherë jemi të ndikuar nga stereotipi kriminel i cili është shumë i dëmshëm sidomos për mbështetjen e shteteve multi-etnike . Ja një përshkrim i një stereotipi , pa ndikimin e frikës dhe shqetësimit: Ai ishte shërbëtor zezak i ngathët , mirnjohës,i përunjër ,i papërgjegjshëm,delikat,servi,ngërdheshës,i bindur, i varur,i trashë,humorist,fëmijë-dashës,fëminor hajdut,shalqinj,këngëtar,shpirtëror,horr ipandërgjegjshëm , ku rrafsha mësu vrafsha,qefli besnik,i cili ndonjëher mund të ndilte aq shumë mjaltë karakteri të tij satë shprehte menquri popullore ose të varoset argjendin e familjes për ta shpëtuar Jankitë! Gjitha këto bindje, paragjykime, stereotipe dhe antagonizma fillojnë nga fëmërija. Arsyetja

psikologjike vjen me parë se ajo arsyeja sociale. Që në fëmijëri fëmijët zgjedhin kukullat e bardha para atyre të zeza, duke menduar se të bardhët janë të pastërt e të zinj të papastërt ashtu si ndodhte dikur në vendet e Evropës perendimore kjo tani në IRJM-ë ndodh e njëjta gjë. Në tekstet shkollore autorët sllav shqiptarët i paraqesin si teorista e sllavët sipaqësorë; shqiptarët si ardhacak; slavët si autoktonët. Sipas Joseph Arthur De Gobineau egzistojnë tri raca: e bardhe, e zezë dhe e verdhë. Të bardhët konsiderohen intelektualisht më moralshëm dhe superior ndaj të tjerëve. Zezakët janë të pa aftë shtatazarak armoralshëm dhe pa kontroll emocional. Duke u bazuar mbi politikën e mbijetesës së multi-etnicitetit në një shoqëri shumica mund të jetë . \* **PLOTËSISHT LIBERALE** (plotësisht pa paragjykime janë kundër diskriminimit edhe pse ajo është në favor të tyre) \* **REALITIVISHT LIBERALE** (paraqiten si paparagjykime por në qoftëse se i cenohet interesi, menjëher fillon të diskriminon) \* **FANATIKË PASIVË** (kanë paragjykime ndaj pakicave, por për shkak të ligjit nuk i përdorin paragjykimet). Të tillë janë sllavët të cilët vetëm nëse u jepet mundësia menjëher diskriminojnë . \* **FANATIKËT AKTIVE** (kanë paragjykim ndaj pakicave dhe ushtrojnë vazhdimisht diskriminim mbi ta). Të tillë janë politikanët sllavët karshi të tjerëve.

*ARSYETIMI SOCIOLOGJIK* Përveq mekanizmave arsye psikologjike që qojnë në antagonizim konflikt ndëretnik në një shoqëri multi-etnike, kur egzistojnë edhe mekanizma arsye sociale që çojnë në antagonizim apo konflikt mes etnive. Një nga faktorët sociologjik është edhe Entocentrizmi primitiv konsiderohen si mbyllje në grupe, të ruajtur traditën, kulturën, dhe religjoni e vet, me qëllim që mos të ketë përzjerje me të tjera. Ai kulturën e vet e lartëson ndërsa të tjetër i zbrëq posht duke i konsideruar si të huaja, barbare a moralshëm, dhe analfabete, për atë arsye vazhdimisht i sulmon që ti zhduk nga afërsia. Ky entocentrizëm shpesh bashkejeton me stereotipet, për më së shumti karakterizohet me hermetizmin. Sipas antropologut, Frederic Barth egzistojnë arsyeje që qojnë në hermetizim e një grupi: \*Kufizimi ndalimi i ndër-martësive midis grupeve etnike \*Kufizimi për kontaktet sociale \*Kufizimi për marrëdhënie ekonomike-tregëtare \*Ndarja fizike e grupeve nga njëra-tjetra (Geto etnike) Ndonjëherë ndodh që dy grupe (të barabarta për nga fuqia), arrijnë marrëveshje reciprociteti për shpëputjen e grupit nga grupi. Por ky reciprocitet, që është marrëveshje e nënshkruar, arrijnë të prishet kur fillon një grupë sundon mbi tjetrin, kur fillon një grup të përvetëson burimet natyrore mbi vete më shumë vete më shumë se tjetri pra ky reciprocitet prishet kur një grup i prish rregullat e marrëveshjes. Pra ndarja e burimit (në fakt mosbarazimi në shpërndarjen e pasurive dhe të mirave material) sjell prishjen e atij reciprociteti dhe nxitjen e konfliktit. I thirrur i parë në këtë rast drejt konfliktit është prishja e marrëveshjeve. I njëti fenomen mund të ndodhë edhe në IRJM-ë, pasi në Marrëveshjen e

Ohrit, është e paraparë që ndarja ekonomike të jetë jo diskriminuese, ndërsa në realitet kemi diskriminim në ndarjen e buxhedit në qoftëse ndodh ndonjë atakonizëm kryengritje, revolucion luftë në IJRM-Ë përveq arsyes psikologjike, janë edhe këto arsye sociale (mos zbatimit I Marveshjes se Ohrit)shkaqet për ndryshim

## **DISKRIMINIMI PRODUKT ISHTETEVE MULTIETNIKE**

bashkëshorti, ish-bashkëshorti , personi që jeton apo ka jetuar në bashkësi me viktimën e dhunës në familje, me një person që ka një fëmijë apo një person në lidhje me shkallën e katërt në lidhje gjaku dhe shkallën e dytë nga të afërmit me këta njerëz apo janë të martuar ose bashkëjetues ose në ndonjë lloj tjetër të jetesës.

## **PASOJA TË DHUNËS FAMILJARE**

Incidentit të fundit të dhunës familjare – 58% e grave viktime të dhunës familjare janë lënduar fizikisht. Dhuna mbi gratë rezulton me lloje të ndryshme të lëndimeve fizike, prej nga më të lehtë deri te shumë të rëndat. Forma më e shpeshtë, apo më saktë, pasojë e dhunës fizike janë mavijosjet në trupin e gruas. Sipas shpeshtësisë, vijnë prerjet dhe lëndimet prej goditjeve me thikë apo tjetër mjet. Marrë në përgjithësi gratë janë viktime dhe të formave më të rënda të dhunës fizike siç janë thyerjet etj.

Pavarësisht prej lëndimeve të cilat i kanë marrë gratë dhe nevojës për ndihmë mjekësore, ato nuk kanë kërkuar ndihmë, janë mjekuar vetë, nga frika prej dhunuesit apo turpit prej mjedisit rrethues për shkak të dhunës që durojnë. Vetëm 23,1% e viktimeve të dhunës kanë kërkuar ndihmë mjekësore. Prej grave që kanë kërkuar ndihmë mjekësore, çdo e treta (34%) është mbajtur në mjekim spitalor.

Lëndimet e paraqitura janë manifestuar si vijon:

- Mavijosje 46,1%
- Prerje 14,2%
- Lëndime me thikë 11,2%
- Rënie të fikët 8,3%
- Thyerje 3,5%
- Lëndim të syrit 3,5%
- Thyerje dhëmbësh 2,5%
- Djegie 1,7%

### **Ndikimi i dhunës mbi viktimat**

Viktimat me vështirësi e pranojnë jetën në kushte të dhunës. Frika, humbja e vetëbesimit, depresioni dhe pagjumësia janë pasojat më të shpeshta të sjelljes së dhunshme mbi gratë. Por, ka edhe pasoja të tjera të cilat janë relativisht më të përfaqësuar. Ato janë gjendje që ndikojnë mbi sigurinë e grave dhe krijojnë personalitet të pasigurt. Prej saj u ulët aftësia për të reaguar dhe për të kundërshtuar dhunuesin. Në disa raste dhuna ka shkaktuar dhe sëmundje të caktuar psikike.

### **Ndikimi i dhunës:**

- Frikë 22,9%
- Humbje të vetëbesimit 16,7%
- Depresion 16%
- Prishje gjumi 14,2%
- Vështirësi psikike 12%
- Sëmundje psikike 10,2%
- Refuzim kontaktesh, izolim 8%

### **Ballafaqimi me dhunën**

Për një numër të caktuar grash nuk është i mundur pa ndihmën përkatëse e shprehur nëpërmjet marrjes së medikamenteve, pirjes së tepërme të duhanit dhe marrjes së tepërme të ushqimit. Ballafaqimin me dhunën, gratë e shprehin më shpesh nëpërmjet marrjes së medikamenteve, në shumicën e rasteve pa konsultim me mjekun. Mekanizmi më i rrallë për mbrojtje prej dhunës është marrja e tepërme e ushqimit.

### **Masa për mbrojtje**

Sigurimi i mbrojtjes dhe sigurisë së viktimës prej dhunës së ardhshme, përkatësisht ndihmës për tejkalimin e pasojave të dhunës së përjetuar, si dhe krijim të kushteve për integrimin e saj në mjedisin social, janë kushtet themelore të cilat duhet të plotësohen gjatë marrjes së masave për mbrojtje.

**Masa për mbrojtje ndërmerren prej Qendrave për Punë Sociale dhe organizatave qytetare të cilat sigurojnë shërbime të drejtpërdrejta për viktimat e dhunës familjare:**

- siguron strehim të nevojshëm për personin-viktimë të dhunës, i cili mund të zgjasë minimum 6 muaj,
- me mundësi për vazhdim për akoma 6 muaj.
- siguron mbrojtje shëndetësore përkatëse;
- siguron intervenim dhe trajnim përkatës psikik-social;
- i drejton në këshillimore;
- në qoftë se në familje ka fëmijë i cili është në shkollim të rregullt, ndihmon për vazhdimin e arsimimit të rregullt;
- e lajmëron organin për ndjekje;
- jep çdolloj ndihme dhe përfaqësimi juridik;
- ngre procedurë në gjykatën kompetente;
- sipas nevojës dorëzon kërkesë në gjykatë për shqiptimin e masës së përkohshme për mbrojtje dhe
- ndërmerr masa të tjera për të cilat do të vlerësojë se janë të domosdoshme për zgjidhjen e problemit.

**Masat e përkohshme** mund të jenë të dobishme sidomos në rastet kur viktimat do ta mbajë bashkësinë me dhunuesin dhe shpreson se vendimi gjyqësor për masën e

përkohshme të shqiptuar do të kontribuojë që dhunuesi të mësojë se sjellja e tij është e palejueshme dhe ka nevojë ai të ndërmarrë metoda jo të dhunshme të sjelljes.

**Masa të përkohshme për mbrojtje të cilat mund të shqiptohen prej gjykatës janë:**

- ndaloi të kërcënojë se do të kryejë dhunë familjare;
- ndaloi të keqtrajtojë, shqetësojë, telefonojë, kontaktojë apo në ndonjë mënyrë tjetër të
- komunikojë me ndonjë anëtar të familjes, direkt apo indirekt.
- ndalim të afrohet te vendbanimi, shkolla, vendi i punës apo vend të caktuar në të cilin rregullisht
- shkon ndonjë anëtar tjetër i familjes;
- caktoi largim prej shtëpisë pa marrë parasysh pronësinë, deri në marrjen e vendimit konkret prej
- gjykatës kompetente;
- ndaloi posedimin, mbajtjen e armëve të zjarrit apo tjetër, dhe njëjta do t'i merret;
- e obligon t'i kthejë të gjitha objektet të cilat janë të nevojshme për plotësimin e nevojave të
- përditshme të familjes;
- shqiptoi alimentacionin e detyruar të familjes;
- urdhëroi i gjykuari të shkojë në këshillimore përkatëse;
- urdhëroi mjekim të detyruar, në qoftë se është përdorues i alkoolit dhe substancave të
- tjera psikotrope, apo ka ndonjë sëmundje;
- e obligon t'i kompensojë shpenzimet mjekësore apo të tjera që kanë ndodhur prej dhunës
- familjare dhe
- shqiptoi cilën do masë tjetër të cilën gjykata e konsideron si të domosdoshme që të sigurohet siguria
- dhe gjendja e mirë e anëtarëve të tjerë të familjes.

## **Dhuna ndaj fëmijëve**

Kur bëhet fjalë apo studiohet dhuna mbi gratë, sidomos kur është në pyetje familja, nuk mund të mos përmendet apo t'u kushtohet vëmendje fëmijëve. Kjo sepse ata janë të lidhur ngushtë, sepse gjatë ekzistimit të dhunës në familje, pa përjashtime, fëmijët janë viktimë – të drejtpërdrejtë apo jo të drejtpërdrejtë. Në shtetin tonë më tepër se gjysma e grave-viktima (58,3%) deklaruan se fëmijët kanë qenë prezentë në dhunë. Prej tyre 17,9% kanë qenë rregullisht të pranishëm në dhunë 27,7% kanë qenë përkohësisht të pranishëm dhe rrallë të pranishëm kanë qenë 13,3 e fëmijëve të grave-viktima. Çdo e pesta grua (20,7%) deklaroi se dhuna ka qenë e drejtuar edhe mbi fëmijët. Në këtë rast fëmijët janë viktimë të drejtpërdrejta të dhunës. Është e madhe përqindja (11,5%) e grave që kanë refuzuar t'i japin përgjigje, që mund të merret si indikator, që fëmijët të kenë qenë viktimë të dhunës familjare në një masë më të madhe.



## **Përfundim**

Fëmijët janë shpesh viktimat e harruara të dhunës në familje ndaj grave, por, në fakt, fëmijët shpesh janë dëshmitarë të dhunës ose e dinë se po ndodh dhunë në shtëpi sepse dëgjojnë britmat dhe grindjet, shohin lëndimet dhe dëmet materiale të shkaktuara. Përveç kësaj, fëmijët e të gjitha moshave, por sidomos fëmijët e vegjël, janë mjaft të rrezikuar nga dhuna në familje dhe mund të lëndohen ose drejtpërsëdrejti ose tërthorazi nga dhuna në shtëpinë e tyre. Edhe nëse nuk janë viktimat e drejtpërdrejta të dhunës në familje, fëmijët shpesh vuajnë nga të njëjtat probleme të sjelljes dhe probleme psikologjike si fëmijët e dhunuar dhe ata të lënë pas dore. Në veçanti, fëmijët që janë dëshmitarë të dhunës në shtëpinë e tyre shpesh vuajnë nga probleme fizike, shoqërore dhe zhvillimore (p.sh., probleme të të nxënimit, aftësi shoqërore të kufizuara, depresioni ose ankthi i skajshëm, ose shfaqin sjellje të dhunshme, të rrezikshme ose të paligjshme).

Gratë që kanë përjetuar dhunë në familje gjatë jetës upyetën nëse dhuna në familje ndikonte tek fëmijët. Ndër gratë që mendonin se dhuna në familje ndikonte tek fëmijët e tyre, 86,4% e grave mendonin se fëmijët ishin dëshmitarë të dhunës në familje, 42,8% thanë se dhuna në familje kishte shkaktuar probleme të të nxënimit tek fëmijët e tyre, 31,2% thanë se fëmijët e tyre jetonin me frikë, 19,2% thanë se fëmijët ishin lënduar ose dëmtuar për shkak të dhunës në familje dhe 5,5% thanë se fëmijët e tyre ishin larguar nga shtëpia për të jetuar me të afërm të tjerë, për shkak të dhunës në familje. Gratë e dhunuara shpesh ngurrojnë të kërkojnë ndihmë për dhunën në familje. Ku është bërë një statistik e cila është: 8,4% e grave që kishin përjetuar dhunë në familje gjatë jetës, dhe 7,1% e atyre që po përjetonin aktualisht dhunë në familje kishin kërkuar ndonjëherë ndihmë për dhunën në martesë apo marrëdhënien e tyre intime. Kjo shifër tregon se shumica e grave të dhunuara vazhdojnë të vuajnë në heshtje me gjithë përpjekjet e vazhdueshme për të rritur ndërgjegjësimin publik për problemet e dhunës në familje dhe shërbimet legjislative dhe sociale të krijuara reshtas për viktimat e dhunës në familje. Kështu, gratë e dhunuara nuk po marrin mbrojtjen, shërbimet e mbështetjes, dhe qasjen në drejtësi që është e drejta e tyre ligjore dhe njerëzore. Arsyet pse gratë e dhunuara nuk kërkojnë ndihmë për dhunën në familje janë të shumta, ndër të cilat:

- ato nuk besojnë se mund të përmirësohet gjë;

- ato nuk dinë ku të kërkojnë ndihmë; kanë frikë se po të raportojnë, kjo mund t'i dëmtojë emrin e mirë familjes
- ato kanë frikë se dhunuesi (t) do t'i rrahin edhe më shumë
- ato mendojnë, ose e dinë nga përvoja, se do t'ju vihet:

## **Arsimi dhe funksionet e tij**

Në objektivin e këtij punimi është e trajtuar çështja e arsimit së një ndër faktorët kyç në emancipimin e shoqërisë njerëzore si dhe një komponentë e qenësishme e synimeve demokratike civile. Pikërisht arsimi është elemnti kryesor i cili e bën forcimin e kohezionit social, sigurimin dhe aplikimin e të drejtave dhe lirive të njeriut si individ dhe si kolektivitet, gjithashtu kontribuon në krijimin dhe funksionimin e shtetit të ligjshëm ( shtetit civil), në krijim dhe funksionimin e tregut të lire dhe konkurrencës, bën krijimin e vlerave të reja të kulturës së dialogut, tolerances dhe kooperimit ndërmjet njerëzve, popujve si dhe në përvetësimin permanent të diturive.

Arsimi paraqet, siç thotë Dyrkemi, veprimtari e cila realizohet nga ana e gjeneratave më të vjetra ndaj atyre të cilët ende nuk janë përgaditur për jetë shoqërore.

Si proces është pjesë e procesit të socializmit, mirëpo nuk e mbulon tërë këtë proces. Në jetë gjëra të cilat mund të mësohen edhe nëpërmjet përvojës personale edhe nëpërmes të më shumë mjeteve tjera të cilat janë jashtë procesit arsimor formal.

Arsimi e përgadit dhe e aftëson individin për jetë, por edhe për profesionin e ardhshëm të cilin do ta kryejë gjatë pjesës më të madhe të jetës së tij. Përveç kësaj, individi aftësohet që ta praktikojë rolin e tij në më shumë grupe shoqërore në të cilat nesër do të veprojë. Duhet të mësojë si të jetë i mirë dhe i sukseshëm në familje, organizatën punuese, në institucionet tjera shoqërore dhe në shoqërinë si tërësi. Në atë mënyrë me sukses do të inkuadrohet dhe do ta zërë vendin e vet në hierarkinë e sistemit shoqëror.

Në përgjithësi mund të themi se arsimi individit i jep dituri bazë, aftësi intelektuale, aftësi manuele, aftësi për të menduar dhe gjykuar, kuptim për përgjegjësi shoqërore dhe kuptim më të gjërë për botën. Prej kur ta mësojë gjithë këtë, njeriu i ri në tërësi do të inkuadrohet në proceset kulturore dhe shoqërore.

## Arsimi si faktorë kyç në zhvillimin e civilizimit shoqëror

Arsimi paraqet një nga institucionet më të rëndësishme të shoqërisë, i cili shërben për pregaditjen dhe aftësimin profesional dhe shkencor të brezit të ri, duke i pajisur ata me njohuri nga fusha të ndryshme të shkencës, kulturës dhe artit, ekonomisë dhe historisë si vlera të qytetërimit njerëzor.

Në gjirin e vet përfshin pjesën më vitale të popullsisë, d.m.th brezin e ri, duke i përgatitur për jetën e ardhshme, si bartës të jetës sociale, ekonomike, kulturore, arsimore dhe shkencore. Duke e aftësuar brezin e ri për punë dhe integrim në jetën shoqërore, arsimi ndikon fuqishëm edhe në procesin e socializimit të individëve, në ngritjen kulturore, në ndryshimin e statusit socio-ekonomik dhe në krijimin dhe rritjen e vetëdijes intelektuale dhe shoqërore.<sup>1</sup>

Synim themelor i arsimit është pregaditja dhe aftësimi i brezit të ri për realizimin e funksioneve shoqërore, ekonomike, shkencore dhe humane të shoqërisë ekzistuese dhe të ardhshme.

Arsimi është pasqyra e shoqërisë, pasi që mjafton të analizohet arsimi i një shoqërie konkrete dhe globale, që të shihet se si është ajo shoqëri- e zhvilluar apo e pazhvilluar, përparimtare apo e prapambetur. Nuk ekziston shoqëri përparimtare dhe demokratike pa arsim të zhvilluar, përparimtar dhe demokratik si dhe anasjelltas.

---

<sup>1</sup> Shehu, Shaban. Sociologjia e Arsimit, SH.B Interdiksioni, 2001, Shkup, fq.109.

Nga të gjitha elementet e qytetërimit, shkenca dhe arsimit janë të vetmit që në kushte të caktuara reflektojnë karakteristika morale. Në realitet, shoqëritë gjithnjë e më tepër tentojnë nga ajo që individi të ketë si obligim që të zhvillojë inteligjencën e tij duke pranuar të vërtetat e verifikuara shkencore. Tash kemi njohuri të caktuara të cilat duhet patjetër ti posedojmë. Nuk është patjetër që të hidhemi në makinerinë industriale, nuk është e thënë që të jemi artistë, por sot të gjithë janë të obliguar që të mos jenë të paarsimuar. Ky obligim ndjehet aq shumë, sa që në disa shoqëri kjo është e sanksionuar me ide në opinionin publik edhe me ligj. Në të vërtetë ajo nuk është asgjë tjetër pos vetëdije njerëzore e ngritur deri në nivel të lartë të qartësisë.

Nëse duam shoqëri që të mbijetojë në kushtet bashkëkohore, duhet që fusha e vetëdijes individuale dhe shoqërore të arsimohet... Arsimimi i bën të mundur ndryshimet në shoqëri. Pasi që rrethanat ku jetojnë shoqëritë bëhen komplekse, atëherë që të mbijetojnë shoqëritë patjetër të bëjnë ndërrime të shpeshta në strukturën e tyre.

Nuk mund të priten ndryshime rrënjësore në shoqëri në bazë të kërkesave që i ushtron zhvillimi demokratik, pa ndryshime pozitive në procesin arsimor, duke filluar që nga edukimi parashkollor, arsimi fillor, arsimi i mesëm dhe ai sipëror.

Pra në fokus të të gjitha ndryshimeve, sidomos në shoqëritë që janë në rrjedhën transitive, edukimi dhe arsimit i brezit të ri paraqet njëri nga çështjet kyçe të këtij transformimi. Pikërisht për këtë, reformimi dhe modernizimi, reforma e sistemit arsimor duhet bazuar në parametrat e të arriturave shkencore dhe standardet demokratike të civilizimit bashkëkohor.<sup>2</sup>

Vetëdija e edukuar jo vetëm që i përkrah ndërrimet, por edhe më parë e din si të përballet me to dhe si të përshtatet në kushtet e reja. Nga ajo është e rëndësishme që inteligjenca e udhëhequr nga arsimit dhe shkenca, të merr vend të rëndësishëm në rrjedhat e shoqërisë njerëzore.<sup>3</sup> Këtu posçërisht duhet theksuar vetëdijen kolektive, pasi që shoqëria mund të përparojë vetëm atëherë nëse midis anëtarëve të vet ekziston homogjenitet i mjaftueshëm. Pikërisht arsimit është faktor qenësor në krijimin e gjendjes shoqërore homogjene, me të cilin qysh në shpirtin e njomë të fëmijës krijohen veti dhe cilësi pozitive që i kërkon jeta kolektive, e me këtë edhe krijohet vetëdija kolektive për jetë të përbashkët të njerëzve. Pra, edukimi dhe arsimit është ai i cili individëve dhe grupeve shoqërore e siguron këtë, duke mbjellur që më parë

---

<sup>2</sup> Shehu, Shaban. Sociologjia e Arsimit, SH.B Interdiksioni, 2001, Shkup, fq.110..

<sup>3</sup> Jashari, Hasan, Sociologjia e edukimit, fq.17.

në shpirtin e fëmijës veti të njëjta, por që janë të qenësishme, si nevoja dhe kërkesa të jetës kolektive.

## **Funksionet e arsimit**

Në definimin e qëllimeve dhe funksioneve të arsimit ekzistojnë përcaktime të ndryshme nga autorë të ndryshëm, por që të gjithë pajtohen se arsimi, si nënsistem i sistemit të shoqërisë globale, paraqet fenomen kompleks dhe shumëdimensional të shoqërisë.

Ai është faktor i qenësishëm i emancipimit të individit- njeriut dhe shoqërisë, është faktor progresi dhe zhvillimor i civilizimit njerëzor.

Qëllimi global i arsimit apo sistemit arsimor rrjedh nga qëllimet më të përgjithshme të zhvillimit shoqëror, ekonomik, kulturor, tekniko-teknologjik, shkencor dhe politik të shoqërisë konkrete.

Nga Talkont Parsons e dimë se qëllimet kryesore të ekzistencës së institucioneve janë funksionet që ata i kryejnë edhe atë duke i shpjeguar funksionet e pjesëve dhe funksionimit të tërësishëm të shoqërisë në realitet.<sup>4</sup>

Funksionet e arsimit janë të shumta, por sipas sociologut Robert Merton, ato ndahen në dy tipe kryesore

- **Funksione manifestuese**
- **Funksione latente**

**Funksionet manifestuese** të sistemit të arsimit kanë për qëllim socializmin dhe integrimin e individit në shoqëri, sepse arsimi ka për qëllim që të krijojë dituri të reja, ti përgatisë njerëzit për punë dhe ti zhvillojë aftësitë dhe shkathtësitë e individit.

Në funksionet manifestuese bëjnë pjesë

- ❖ Funksioni socializues ( nxënësit i mësojnë rolet e të rriturve)
- ❖ Funksioni për integrim social ( arsimi e forcon homogjenitetin në shoqëri)
- ❖ Funksioni rinovues ( krijimi i diturive të reja)
- ❖ Funksioni i përgatitjes dhe i aftësimin për punë

---

<sup>4</sup> Giddens, Anthony, Sociologjia, Çabej, 2002, Tiranë

- ❖ Funkzioni i seleksionimit ( rigrupimi i nxënësve në të pasuksesshëm, mesatar të suksesshëm dhe më të suksesshëm).<sup>5</sup>

**Funksioni i socializmit-** Studiuesi N.Havenika, në veprën e tij Baza psikologjike e punës grupore, thekson se shkolla është institucioni më i rëndësishëm shoqëror, i cili integron gjeneratën e re në jetën shoqërore, sepse ajo, pra shkolla, është agens i kontrolluar i socializmit me eksperiencë më të organizuar dhe më të pasur shoqërore.<sup>6</sup> Por, të gjithë teoricienët e arsimit pajtohen në një çështje tejet parimore, se rëndësia e shkollës qëndron në atë se shkolla është vendtakim i moshatarëve, njerëzve me interesa dhe preokupime të njëjta. Sipas shumë analizave moshatarët janë faktorë tepër të fortë të socializmit. Në shkollë nxënësit mësojnë se si ti luajnë rolet e të rriturve në të ardhmen, nëpërmjet përcjelljes së disa diturive, shkathtësive dhe vlerave. Këtu bëhet transmetimi i kulturës shoqërore, në të cilën ekziston kultura tradicionale dhe ajo që krijohet, si dhe më gjerësisht bëhet transmetimi i vlerave dhe thesarit të qytetërimit civilizues.

**Funksioni i integrit social** – çështje të cilën në sociologji e ka ngritur Emil Dyrkemi dhe e cila mbështetet në qëndrimin se arsimi e forcon homogjenitetin shoqëror dhe identitetin kolektiv të individëve. Kjo gjë arrihet nëpërmjet mësimin të vlerave të përbashkëta, gjuhës, termineve, synimeve dhe në këtë mënyrë krijohet vetëdija kolektive por edhe ndjenja e përkatësisë ndaj bashkësisë, rrethit shoqëror.

Është fakt i pamohueshëm se sistemi edukativo-arsimor i integron njerëzit në bashkësinë shoqërore duke mësuar në gjuhë të përbashkët dhe në mënyra të përbashkëta të shikimit të botës apo fitimit të pikëpamjeve të përbashkëta, ashtu që edhe komunikimi dhe interaksioni midis tyre bëhet më lehtë.

**Funksioni i krijimit të diturive të reja( inovacionit) në arsim** – procesi i mësimin duhet të rrjedh në mënyrë të vazhdueshme dhe ndodhitë e ndryshme që bëhen në shkollat p.sh. mësimi interaktiv, mësimi hap pas hapi, arsimi qytetarë në shkollat fillore dhe të mesme, reformat në shkollat e mesme profesionale, inovacionet e ndryshimeve integruese që arsimi i lartë të afrohet me arsimin evropian.<sup>7</sup>

Rol të rëndësishëm ka arsimi sipëror që konsiderohet si burim i diturive dhe teknologjisë së re. Hulumtimet sociologjike të arsimit sipëror dëshmojnë se këto institucione arsimore-shkencore

---

<sup>5</sup> Georgievski Petre, Sociologjia, Prosvetno Dello, Shkup, 2002

<sup>6</sup> Jashari ,Hasan, Sociologjia e edukimit.fq.20

<sup>7</sup> .www.Malesia-forum.com.

duhet tu përshtaten kushteve dhe kërkesave të reja shoqërore dhe për ti aftësuar studentët që të fitojnë ditur të reja dhe të merren me punë kërkimore shkencore.

**Funksioni i përgatitjes dhe aftësimit për punë** – Ndarja teknike, industriale e punës si sistem i ndërlëkuar i veprimtarisë punuese dhe kërkesave për punë të veçanta me shkathtësi të mprehta kërkon një qasje më të avancuar drejt aftësimit të vazhdueshëm për punë.

Shoqëritë bashkëkohore konkrete ( shtetet) në mënyrë të prerë kanë nevojë të domosdoshme për fuqi pune, për punëtorë profesionalisht të arsimuar dhe teknikisht të aftë, të cilët me sukses do të mund të inkuadrohen në ndarjen e punës. Pikërisht për këtë, institucionet e arsimit, sidomos shkollat e mesme dhe fakultetet kanë rol primar për përgatitjen dhe aftësimin bashkëkohor të të rinjëve për të kryer me sukses profesionin e tyre që kanë zgjedhur.

**Funksioni i seleksionimit** – Arsimi ka funksionin e tij seleksionues në qasjen drejt shkollave, klasave, profileve, fakulteteve dhe specializimeve. Për këtë qëllim ekzistojnë teste profesionale, nota, kritere pranimit nëpër shkolla, fakultete, etj.

Sipas këtij funksioni shkollat dhe fakultetet paraqesin çelësin për zgjedhjen

( seleksionimin) dhe klasifikimin e nxënësve dhe të studentëve sipas aftësive dhe suksesit të tyre të treguar, duke i shkallëzuar në ata që nuk tregojnë sukses, në ata që tregojnë sukses mesatar dhe në ata që tregojnë sukses të dalluar si dhe në ata që bien nga procesi i arsimit të mëtejshëm dhe në ata që nuk i kryejnë shkallët më të larta të arsimit.

Ky proces shpesh i nënshtrohet kritikës shoqërore si rrjedhim i ndjeshmërisë shoqërore dhe impakteve që vendos ky proces në fatet dhe karrierën e njerëzve.<sup>8</sup>

### **Funksionet latente në sistemin e arsimit**

Funksionet latente në sistemin e arsimit janë funksione të brendshme të secilit sistem bashkëkohor të arsimit.

Në këtë lloj funksionesh bëjnë pjesë

- ❖ Kontrollimi i zvogëluar i prindërve
- ❖ Funksioni i shërbimit shtëpiak ( ruajtjes së fëmijëve)

---

<sup>8</sup> Shehu, Shaban. Sociologjia e Arsimit, SH.B Interdiksioni, 2001, Shkup, fq. 114.

❖ Funkzioni i socializmit ndaj gjinisë tjetër  
(formimi i qëndrimeve për gjininë e kundërt)

❖ Reduktimi i ofrimit për punësim

❖ Kundërshtimi i të rinjve ndaj traditave dhe  
normave shoqërore

**Kontrollimi i zvogëluar i prindërve-** sipas të cilit funksioni latent i shkollës është që të zvogëlohet kontrollimi i prindërve ndaj fëmijëve të tyre. Ky funksion, sa ka anën e vet pozitive ka edhe atë negative, sepse nxënësit në shkollë mësojnë për vlera, dituri dhe shkathtësi, të cilat prindërit e tyre nuk mund t'ia sigurojnë si dhe atë që nxënësit e mësojnë në shtëpi ( familje ). Kjo situatë apo gjendje mund të shkaktojë konflikt midis prindërve dhe shkollës, si p.sh. vënia e edukatës në shkollë ose gjatë ligjërit të tremave shkencorë nga evolucioni etj, gjë që nuk janë të përshtatshme apo kompaktibile me besimet tradicionale dhe religjioze të prindërve.

**Funksioni i shërbimit shtëpiak ruajtjes së fëmijëve** – shkollat luajnë edhe rolin e shërbimit shtëpiak-ruajtjes së fëmijëve, çka u lehtësohet puna prindërve për disa orë në ditë që të mos kujdesen për fëmijët e tyre. Gjatë kohës kur fëmijët janë në shkollë, prindët mund të kryejnë punë të tjera në shtëpi, në vendin e punës, etj. Ky funksion ka rëndësi të madhe në jetën familjare, sidomos kur prindërit janë angazhuar me pune të tjera apo janë të inkuadruar në punë.

**Funksioni i socializmit ndaj gjinisë së kundërt** – sipas të cilit nxënësit në shkollë jo vetëm që socializohen në seksin ( gjininë) e tyre përkatës, por u jepet mundësia edhe për socializmin ndaj gjinisë tjetër, e cila është shoqërisht kompetitive.<sup>9</sup>

**Reduktimi i ofrimit për punësim** – ( studentët e zvogëlojnë përqindjen e papunësisë me atë që nuk evidentohen në Byronë për punësim).

Shkollat e mesme dhe fakultetet konsiderohen si gjeneratorë potencial të prodhimit të fuqisë punëtore, në një masë të madhe ndikojnë në reduktimin e fuqisë punëtore në tregun e punës me çka ndikojnë edhe në zvogëlimin e papunësisë. Këto absorbojnë një numër të madh të rinjve, të cilët janë të përfshirë në procesin arsimor dhe si të tillë aktualisht nuk janë konkurrentë për të zënë vende pune. Për as sa ka studentë që studiojnë dhe nuk kërkojnë punë pa mos i kryer provimet, po aq numri i vendeve të punës është i lirë, respektivisht janë për njerëz të tjerë.

---

<sup>9</sup> Shehu, Shaban. Sociologjia e Arsimit, SH.B Interdiksioni, 2001, Shkup, fq. 115.



**Kundërshtimi i të rinjve ndaj traditave dhe normave shoqërore** – ndarja e të rinjve në shkolla e rrit mundësinë e kundërshtimit të tyre ndaj traditave dhe normave shoqërore. Këto dukuri janë më karakteristike me segregacionin e studentëve zezakë apo nxënësve në shkolla dhe fakultete të veçanta. Ndarja e tyre në baza racore, religjioze, sociale , etj., mund të sjellë deri në konflikte racore, religjioze, sociale, etj.

Faktet sociologjike vërtetojnë se në SHBA, kur segregacioni i nxënësve dhe studentëve u ndërpre dhe u formuar shkolla të përbashkëta për të bardhët dhe zezakët, nuk paraqitet konflikti në shkolla dhe jashtë tyre.

Arsimi krijon vlera të reja, dituri dhe shprehi të reja sociale, që të rinjtë nga mjediset e ndryshme sociale, ndodh që të vijnë në kundërshtim me normat tradicionale dhe me normat shoqërore, sidomos kur këto të fundit bëhen pengesë për zhvillimin e lirë dhe të barabartë të brezit të ri.

Në përgjithësi mund të thuhet se funksioni cilësor i arsimit supozon një nga kushtet për përparimin e jetës individuale dhe shoqërore në tërësi. Arsimi i mirëfilltë siguron vlera individuale dhe universale që janë qëllimi dhe interesi i civilizimit bashkëkohor.

Realizmi i konceptit qytetar-demokratik i arsimit, funksionimi i shtetit të ligjshëm juridik, i ekonomisë së tregut, i marrëdhënieve qytetare – demoktarike dhe i vlerave qytetëruese, respektimi i të drejtave dhe lirive qytetare paraqesin disa nga qëllimet më kryesore dhe më të rëndësishme të fenomenit mjaft kompleks dhe shumëdimensional, siç është arsimi.

Në fund parashtrohet pyetja çfarë ardhmërie ka arsimi te ne dhe në botë?!?!

Pamëdyshje qëndron fakti se të arriturat shkencore shkojnë përpara me shpejtësi astronomike. Deri dje ajo që ishte fakt i pamohueshëm, sot është vetëm e kaluar shkencore.

Asgjë nuk do të thotë të kryhet shkollë e shkallës më të lartë, në qoftë se individi nuk vazhdon që ta përtërijë dhe ta përsosë diturinë e tij deri në fund të jetës. Gjithnjë e me tepër shihet nevoja për formimin e të ashtuquajturës bankë e diturive dhe mësim, në të cilën çdo njeri do të mund ta plotësonte dhe ta freskonte diturinë e tij.

Pa të ashtuquajturin arsim, deri në fund të jetës, individi nuk do të mund të mbahet në hierarkinë e marrëdhënieve shoqërore.

---

Gjithashtu paraqitet nevoja e themelimit të të ashtuquajturave universitete të moshës së tretë. Në ato do të mund individët e pensionuar ta vazhdojnë shkollimin e tyre në bazë të zgjedhjes. Në atë mënyrë do ta pasuronin fondin e tyre të diturive që ti shërbejnë shoqërisë deri në fund të jetës së tyre.

## RELIGJIONI

Çka keni që nuk ndihmoni njëri-tjetrin? (37:25) Nëse All-llahu dëshiron t'ju ndihmojë, s'ka kush që mund t'ju mposhtë, e nëse Ai iu lë pa ndihmë, atëherë kush është ai pas Tij, që dot'ju ndihmojë? Pra vetëm All-llahut le t'i mbështeten besimtarët. (3:160). A nuk e ke ditur se vetëm All-llahut i takon sundimi i qiejve e i tokës, dhe se pos All-llahut nuk keni as mbrojtës as ndihmëtar? (2:107) Thuaj: "Neve nuk na godet asgjë tjetër, përveç çka na është caktuar nga All-llahu; Ai është ndihmëtar yni". Prandaj, vetëm All-llahut le t'i mbështeten besimtarët. (9:51)<sup>10</sup>

<sup>7</sup> Secili le të japë aq sa ia do zemra, jo i trishtuar e përdhuni, sepse: 'Hyji e do atë që jep me gëzim.' <sup>8</sup> Hyji mund t'ju dhurojë çdo të mirë që gjithmonë të keni gjithçka mjaft për vete e t'ju teprojë gjithnjë për të ndihmuar çdo vepër të mirë, <sup>9</sup> siç është në Shkrimin e shenjtë: 'Ai ndan me bujari, u jep skamnorëve; drejtësia e tij qëndron në amshim.' Dhe duke (i) vënë çdo gjë nën këmbë, ai s'la asgjë që të mos i jetë e nënshtuar. Vërtet, tani nuk shohim ende se gjithçka është nën pushtetin e tij...<sup>11</sup>

Citatet e mësipërme dhe shumë të tjera, tregojnë qartë mesazhet për ndihmë njëri tjetrit, mesazhe për paqë, për harmoni etj etj. Megjithatë përgjatë historisë së njerëzimit ne shofim luftëra të shumta mes religjioneve, duke filluar nga Faraonët, Romakët, Kryqëzatat dhe kohëve të fundit luftërat në Irlandën e Veriut, Palestinë, Afganistan, dhe Irak.

Me ardhjen e njerëzimit erdhi edhe religjioni, ai në fillim ishte në formën më primitive e më vonë u zhvillua në shkallë të ndryshme, në nivele të ndryshme dhe funksioni i tij u bë në njëfarë mënyre i gjithanshëm dhe për të gjitha shtresat dhe grupet shoqërore.

---

<sup>10</sup> Citime nga Kur'ani.

<sup>11</sup> Citime nga Bibla – Dhjata e Re.

Në vijim do të shohim për prejadhjen e religjionit, për formën dhe funksionin e saj e deri te të këqijat që u bënë në emër të religjionit apo ku qëllimi kryesor ishte pengimi i njërit dhe përhapja e një religjioni tjetër.

## PREJARDHJA E RELIGJIONIT

Religjioni (latinisht: religiare që don të thotë të lidhesh), si formë më e vjetër e vetëdijes dhe botëkuptimit njerëzor, konsiderohet si një lidhje e komunitetit të caktuar shoqëror të klanit, fisit, individit me një qenie mbinatyrore. Religjioni është sistem i besimeve dhe ritualeve që i drejtohen një qenie supreme – të shenjtë. Religjioni ekziston që nga ekzistimi i njeriut dhe ka të bëjë me mënyrat e organizuara shoqërore të mendimit, ngjarjeve dhe veprimeve që aludojnë në ekzistimin e supernatyrës.

Religjionet e para kanë qenë të formës *anemiste* (besimi në fuqitë hyjnore) dhe *totemiste* (besimi në ndonjë qenie, shtazë, bimë apo gjësend), por më pas formohen trajtat e tjera të religjionit të cilat janë *politeizmi* (besimi në shumë perëndi) dhe *monoteizmi* (besimi në një perëndi). Ka shumë mendime e keqkuptime në definimin e religjionit. Në komunitetet e para të njerëzimit përfytyrimet religjioze ishin të lidhura në mënyrë direkte me pasqyrimet ose shprehjet imagjinare të realitetit natyror e shoqëror, të fenomeneve natyrore, të lidhjeve të rrjedhës së tyre të shkaqeve e të fakteve si dhe marrëdhënieve shoqërore të atëhershme.

Përkufizimin e fesë, B. Wilson e jep edhe duke pohuar se çfarë nuk është feja. Së pari, feja nuk mund të identifikohet me *monoteizmin*. Shumica e feve përfshijnë shumë perëndi e në disa fe të caktuara nuk ka fare zotër. Së dyti, feja nuk mund të identifikohet me *porositë morale*. Ideja që zotët janë të interesuar se si sillemi në këtë botë është e huaj për disa fe. Së treti, nuk është patjetër që feja të lidhet me *shpjegimin se si bota u bë sikurse është*. Së katërti, feja nuk mund të identifikohet me të *mbinatyrshmen*. Konfucianizmi është i lidhur me pranimin e harmonisë natyrore të botës.

Karakteristikat që i kanë të gjitha fetë janë se fetë përfshijnë një *kompleks simbolesh*, që revokojnë ndjenjat e *nderimit* ose *frikës* dhe janë të lidhura me *ritualet* ose ceremoniale. Rituale të lidhura me fenë janë të shumëllojshme. Veprimet e tyre mund të përfshijnë të folurit, të kënduarit, ngrënien e llojeve të caktuara të ushqimit, përmbajtja nga mosveprime të ndryshme etj. Edhe pse ekziston një numër i madh i feve, ato kanë një pikë të përbashkët: *të adhurohet një qenie që ekziston mbi të gjithë pjestarët e tij*.

## SHUMËLLOJSHMËRIA E FEVE

### ANIMIZMI

**Animizmi** është sistem i besimit që nuk pranon ndarjen e trupit dhe të shpirtit, të shpirtit nga materia. Kështu, është i bazuar në besimin se shpirtëra të tillë të personalizuara gjinden në kafshë, bimë dhe objekte tjera materiale, duke kryesuar në një shkallë ekzistencën e tyre. Kjo gjithashtu aludon edhe në atë se unifikimi i materies dhe shpirtit luan një rol në jetën e përditshme.

Fillimisht, shpirtërat ishin të sqaruara si shumë të ngjajshme me personat dhe tek më vonë, në religjionet jo-animiste në një drejtim të një zhvillimi ato humbin karakteristikën e tyre materiale dhe bëhen në një shkallë më të lartë të “gjallëruara”. Antropologjisti Britanez Sir Edward Burnett Tylor në *Kultura Primitive (1871)*<sup>12</sup> argumenton se ky besim është më primitivi dhe forma më esenciale e religjionit. Megjithëse animizmi në vetvete nuk është religjion në sensin e zakonshëm të Perëndimit, ai përmban burimin mbi të cilin religjionet janë ndërtuar.

### Origjina

Shumë autoritete pranojnë se ideja e shpirtit është bërthama krijuese e sistemit animist, se shpirtërat janë vetëm shpirtëra që e bënë veten të pavarur, dhe se shpirtërat e kafshëve, bimëve dhe objekteve janë të ndërtuara në analogjinë e njeriut.

Psikologu Zigmund Frojd mendonte se njeriu primitiv erdhi me sistemin animist duke vështruar fenomenin e fjetjes (duke përfshirë edhe ëndërrat) dhe të vdekjes që aq shumë i përngjajnë atij, dhe duke u orvatur të sqarojnë ato forma. Pikëfillimi i teorizimit të këtillë duhet të jetë problemi i vdekjes. Atë që njeriu primitiv e vështronte si çështje natyrore ishte zgjatja e pakufishme në jetë – pavdeksia. Ideja e vdekjes u pranua më vonë dhe me dyshim.

### Termi

---

<sup>12</sup> [www.wikipedia.org](http://www.wikipedia.org)

Animizmi ishte term i përdorur nga antropologjisti Sir E. B. Tylor si teori e propozuar e religjionit në librin e tij *Kultura Primitive* të vitit 1871. Ai e përdori me domethënien “besim në shpirtëra” (mistik, supernatyror, joempirik ose qenie të imagjinuara).

### **Larmia**

Sot, animizmi ekziston në shumë shtete si në Zambë, Republikën Demokratike të Kongos, Bangladesh, Indi, Gabon, Indonezi, Japoni, Laos, Papua Guinea e Re, Peru, Filipine, Kanada, Rusi, Suedi, Tailandë, dhe SHBA.

## TOTEMIZMI

**Totem** është çdo qenie që vëzhgon ose ndihmon një grup njerëzish, siç janë familja, klani ose fisi.<sup>13</sup>

Totemi përkrah grupe më të mëdha se sa një person. Në lidhje familjare dhe brez, nëse stërgjyshi apikal i klanit është jonjeri ai quhet totem. Normalisht, ky besim shoqërohet me mitin totemik.

Megjithëse termi është i origjinës Ojibwa<sup>14</sup> (Oxhibvej), besimet totemiste nuk janë të limituara për Indianët - Amerikanët Vendas. Totemizëm i ngjashëm është gjetur edhe në pjesë të tjera të botës duke përfshirë Europën Perëndimore, Lindore, Afrikën, Australinë dhe rajonin e Arktikut. Shqiponja e xhveshur mund të konsiderohet totem për njerëzit e SHBA-ve edhe pse nuk mbart mitologji shpirtërore në këta njerëz.

Në kohët moderne, disa njerëz, që nuk janë të përzier në praktikimin e një religjioni fisnor, kanë zgjedhur të adaptojnë një shpirt kafshe – ndihmës personal që ka një domethënie të veçantë për ta të cilin ata e quajnë totem. Besimtarët në lidhje me këta kafshë ndihmës mund të ndryshojnë. Hajmalitë janë gjithashtu totem. Disa Amerikan vendas dhe pasues të tjerë të fiseve fisnore kanë një vështrim të zbehur për të tjerët të cilën adaptojnë kafshë toteme, duke argumentuar se një joanëtarë nuk mund vërtetë të kuptojë totemizmin ndaras nga konteksti kulturor, dhe më e keqja, ajo paraqet një komercializim të religjionit.

---

<sup>13</sup> Merriam Webster Online Dictionary (Fjalori në linjë Merriam Webster).

<sup>14</sup> Pjestarë të Indianëve – Amerikanëve vendas. (Merriam Webster Online Dictionary)

## POLITEIZMI

Politeizmi është besim ose adhurim në shumë zotëra. Rrjedh nga fjala greke *poly+theoi*, - shumë zotëra. Religjioni antik ishte politeist. Besimi në shumë zotëra nuk ndalon besimin në një qenie të gjithëfuqishme, të gjithëdijshme, si zotërues dhe prind (shpesh mbret dhe baba) të zotërave dhe njerëzimit.

Në besimet politeiste, zotërat janë të kuptuar si personazhe komplekse me status më të lartë ose më të ulët, me aftësi, nevoja, dëshira dhe histori individuale. Këto zotëra nuk janë gjithmonë të portretizuara në mitologji si qenie të gjithëfuqishme ose të gjithëdijshme, më shpesh, ato janë të portretizuara si të ngjashëm me njerëzit (antropomorfik) në trajtimin e personalitetit të tyre, por me fuqi, aftësi, dituri dhe perceptim më të madh individual. .

Perceptimet filozofike të zotërave janë të ndryshëm në mënyrën se si ato përshkruhen në mitologji. Në traditat filozofike zotërat shihen si të përjetshëm, të përkryer dhe të plotfuqishëm. Neoplatonizmi mësonte ekzistimin e “*Njëshit*”, Zot i mrekullueshëm. “*Një është Zoti*” Plotini 204-270 p.e.s.

Për politeistët, zotërat kanë epitete të shumta, sejcili me rol të veçantë dhe të rëndësishëm, dhe kanë gjithëdije apo autoritet mbi një fushë të jetës dhe të gjithësisë. Zotërat e Grekëve përdoreshin për të ilustruar këtë: zot mund të jetë një zot i muzikës, si Apollo, perëndesha e një lloji të ushqimit Demetra, ose perëndesha e dashurisë Afroditë. Një perëndi mund të ketë një rol të pjesërishëm në hierarkinë e zotit, si Zeusi, Perëndia baba, ose një zot mund të jetë një zot i emërtuar për një fenomen të caktuar gjeografik, kozmologjik, të një rajoni, vendbanimi, lumi ose familje por gjithashtu idetë abstrakte siç është liria – Dionisi. Në mitologji, perënditë mund të kenë rradhitje të kompleksuar shoqërore. Për shembull ato kanë shokë dhe armiq, gra (Zeusi dhe Hera) dhe dashnor (jolegjitim) (Zeusi me bashkëshortet e tij dhe fëmijët), ato përjetojnë emocione njerëzore siç është xhelozia, teket ose zemërimi i pakontrolluar (lufta ndërmjet Tiamat dhe Marduk) dhe ata mund të praktikojnë pabesi ose të jenë të dënuar. Ata mund të lindin ose të vdesin (veçanërisht në mitologjinë skandinave), por që të rilindin.<sup>15</sup>

Politeizmi i referohet ndershmërisë së ‘shumë hyjnive’, ku sejcili është i njohur si i pamvarur, me personalitet të veçantë, jo si një aspekt ose lloj i diçkaje tjetër. Sistemet e besimeve politeiste kanë një numër të hyjnive ose qenieve të shenjta. Qeniet e shenjta mund të përfshijnë shpirtëra, qenie njerëzore, paraardhës, ‘zotëra të vegjël’.



Në kulturat politeiste, hyjnitë mund të ndien si kompleks personazhesh. Shumë prej tyre kanë aftësi ose mundësi të veçanta por nuk janë të kufizuara në to. Një hyjneshë mund të jetë për shembull ‘hyjneshë e drithërave’ ose ‘hyjni e thurrijeve’, megjithëse ajo mund të ketë interes të veçantë në këtë fushë, njejtë si njeriu që është muziciente, ai është gjithashtu anëtar i një familje dhe shoqërie, dhe është pjesëmarrës në debate politike.

Kultura parakristiane e Europës dhe në të vërtetë shumë kultura nëpër botë, kanë qenë dhe në të shumtën e rasteve kanë mbetur politeiste, dhe politeizmi është duke u gjallëruar në Perëndim, shpesh duke u shoqëruar me kthimin e teksteve të vjetra, ritualeve dhe mënyrës së jetesës që ato e përshkruajnë. Religjionet e kohëve të fundit përfshijnë politeizmin helenist, disa forma të Wicca<sup>16</sup> dhe Asatru<sup>17</sup>. Shpesh këto do të tentojnë të rekonstruktojnë ose të rivendosin një sistem specifik të besimit parakristian, duke studjuar historinë dhe arkeologjinë, shkrimet e vjetra (të cilët do të mirren ose jo si të shenjta) dhe kulturën që përfshinë ajo, të rikrijojnë një spiritualitet të gjallëruar që funksionon në botën e sotme. Shembuj të teksteve të vjetra janë Iliada, Odisea dhe Epi i Gilgameshit, ose Eda<sup>18</sup>, shkrime këto që u referohen hyjnive dhe qenieve të tjera jo njerëzore.

---

<sup>15</sup> [www.wikipedia.org](http://www.wikipedia.org) (enciklopedia në Gj. Angleze).

<sup>16</sup> Religjion i ndikuar nga besimet parakristiane dhe i aplikuar ne Perëndim (Merriam Webster Online Dictionary).

<sup>17</sup> Lëvizje e re fetare qëllimi i së cilës është ringjallja e paganizmit Nordik të periudhës Vikinge

<sup>18</sup> Poema dhe poezi Nordike të shkruara në shekullin e 13 (Merriam Webster Online Dictionary)

## HINDUIZMI

Pjesa më e madhe e Hinduve adhurojnë paraqitje të pafundme të njëqenësisë përfundimtare (Brahman) nëpërmjet një shumice perëndish dhe perëndeshash, mbi 300,000 prej tyre. Këto manifestime të shumta të perëndive dhe perëndeshave mishërohen brenda idhujve, tempujve, guruve, lumenjve, kafshëve, etj.

Hindutë e shohin pozicionin e tyre në këtë jetë si të bazuar në veprimet e tyre në një jetë të mëparshme. Nëse sjellja e tyre e mëparshme ishte e keqe, ata mund të përjetojnë vështirësi të jashtëzakonshme në këtë jetë. Synimi i një Hinduje është të çlirohet nga ligji i karma-s...të mos vazhdojë të rimishërohet më.

Ka tri rrugë të mundshme për t'i dhënë fund këtij cikli të karma-s:

1. T'i përkushtohesh me dashuri njërit prej perëndive dhe perëndeshave hindu;
2. Të rritesh në njohuri përmes meditimit të Brahman-it (njëqenësisë)...të kuptosh se rrethanat në jetë nuk janë reale, se vetja është një iluzion dhe vetëm Brahman-i është real;
3. T'i përkushtohesh një sërë ceremonish dhe rritesh fetare.

Në Hinduizëm, një person ka lirinë të zgjedhë si të punojë drejt përsosjes shpirtërore. Hinduizmi ka edhe një shpjegim të mundshëm për ekzistencën e së keqes dhe vuajtjes në botë. Sipas Hinduizmit, vuajtja që përjeton çdo njeri, qoftë kjo sëmundje, ose uri ose fatkeqësi, është për faj të vetë personit, për shkak të veprimeve të tij të këqia, zakonisht në një jetë të mëparshme. Vetëm shpirti ka rëndësi i cili një ditë do të çlirohet nga cikli i rilindjeve dhe do të pushojë në paqe.

## MONOTEIZMI

Në religjion, monoteizmi (nga greqishtja monos – një, dhe theos – Zot) është besim në ekzistimin e një hyjnie ose Zoti, ose në njëshmërinë e Zotit. Në kontekstin Perëndimor, koncepti i monoteizmit priret të dominohet nga koncepti i Zotit të Religjioneve të Abrahamit dhe konceptin Platonik të Zotit.

Sipërfaqësisht religjionet monoteiste edhe më tej mund të përfshijnë koncepte të pluralitetit të hyjnisë, për shembull Trinia në Kirshterizëm, ose nderimi i shenjtorëve, si dhe besimi në “shpirtërat më të vogël” siç janë engjujt dhe demonët.

Historikisht, monoteizmi shfaqet vonë ne Epokën e Bronztë në një proces gradual duke përfshirë nocionet henoteistike (devocion në një Zot por duke pranuar ekzistimin e zotërave të tjerë) dhe panenteistike (Zoti është krijues dhe/ose jep fuqi prapa Universit dhe është burim i moralit Universal).

## JUDAIZMI

Judaizmi është më e vjetra e këtyre tri feve dhe i përket periudhës rreth 1000 vjet para Krishtit. Hebrenjtë e lashtë ishin endacakë që jetonin në Egjiptin antik dhe përreth tij. *Pofetët* ose udhëheqësit e tyre fetarë pjesërisht i përshkruajnë idetë e tyre nga ekzistenca e besimeve fetare në rajon, por ndryshonin në besimin e tyre ndaj një Zoti të vetëm të gjithëfuqishëm. Shumica e fqinjëve të tyre ishin politeistë. Hebrenjtë besonin se Zoti kërkonte bindje ndaj kodeve morale të rrepta dhe këmbëngulnin në pohimin për një monopol të vetvetes, duke e konsideruar besimin e tyre si të vetmen fe të vërtetë.

Deri në krijimin e Izraelit, pak vite pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore, nuk kishte ndonjë shtet në të cilën Judaizmi të ishte fe zyrtare. Komunitetet izraelite mbijetuan në Europë, Afrikën Veriore dhe Azi, megjithëse ata shpesh janë persekutuar - duke arritur kulmin në vrasjen e miliona çifutëve prej nazistëve në kampet e përqendrimit gjatë luftës.

Qëndrimi më i mirë Judaik për monoteizmin shfaqet në lutjet Shema, Dhjetë Urdhërat dhe Maimonidet – 13 Principet e Besimit. Principi i dytë:

*“Zoti, Shkaku i gjithçkasë, është një. Kjo nuk don të thotë një i një çifti, as një si një specie, as një si në objekt që është bërë nga shumë elemente. Zoti është një unitet si asnjë unitet tjetër. Kjo është e thënë në Torah (Deuteronomy 6:4). “Dëgjo Izrael, ZOTI është hyjnia jonë, ZOTI është një”.*

## KRISHTERIMI

Shumë pikëpmajje judaike u morën dhe u përfshinë si pjesë e Krishterimit. Jezusi ishte një izraelit orthodox dhe Krishterimi nisi si një sekt i judaizmit; nuk është e qartë nëse Jezusi dëshironte të zbulonte një fe të veçantë. Pasuesit e tij e konsideronin atë si *Mesia* – fjalë hebraike kjo që don të thotë “*i shenjtëruari*”, fjala greke për të cilin ishte “*Krisht*”. Paul, një qytetar romak greqishtfolës, ishte nismëtari kryesor i përhapjes së Krishterimit, duke e predikuar në Azinë e Vogël dhe Greqi. Megjithëse fillimisht të krishterët u persekutuan egërsisht, perandori Konstandin e sanksionoi më në fund Krishterimin si fe zyrtare të Perandorisë Romake. Krishterimi u përhap duke u bërë një forcë mbizotëruese në kulturën perëndimore për dy mijëvjeçarët e tjerë.<sup>19</sup>

Në ditët tona Krishterimi ka numrin më të madh të pasuesve dhe është përgjithësisht më i përhapur në botë. Mbi një miliard njerëz e konsiderojnë veten të krishterë, por ka shumë ndarje në kuptimin e teologjisë e të organizimit kishtar, degëzimet kryesore të së cilit janë Katolicizmi Romak, Protestantizmi dhe Orthodoxizmi Lindor.

Krishterimi deklaron besimin në një Zot. Historikisht, shumë kisha krishtere kanë mësuar se natyra e Zotit është një mister: *derisa është unitet, Zoti gjithashtu manifestohet si tre entitete: Zoti si At, Zoti si Djalë dhe Zoti si Shpirt i Shenjtë (që kolektivisht quhet Trinitet), formula klasike e krishterimit “tre bëhen një”*. Natyra e vërtetë e Trinitetit mbahet si një mister i paspjegueshëm, i nxjerrur nga Testamenti i Ri, por është rezultat i debateve teologjike në Këshillin e Nikës më 325, e kodifikuar në vitin 381 dhe duke arritur zhvillimin e tij të plotë përgjatë punës së Etërve Kapadocian (Basili Fisnik, Gregori nga Nisa, Peter, dhe Gregori Naciancus, patrik i Konstantinopolit)

---

<sup>19</sup> Sociologjia – Anthony Giddens, faqe 435

Sidoqoftë, disa kritik konsiderojnë se Krishterimi është formë e triteizmit. Derisa kjo mund të jetë e vërtetë në disa instanca, Krishterimi kuptohet si monoteism tripjesësh. Për çifutët dhe muslimanët, idea e Zotit si trinitet është heretike – konsiderohet i afërt me politeizmin.

*“Unë besoj në një Zot”* është çelësi i qëndrimit të Krishterëve. Disa grupe Krishtere, siç janë Dëshmitarët e Jehovait dhe Uniteti i Rrëshajave, nuk mësojnë doktrinën e Trinitetit. Kisha Katolike Romake praktikon Respektimin e të Shenjtëve, që kritikët e quajnë formë e politeizmit.

## ISLAMI

Islam don të thotë “*Nënshttrim ndaj Zotit*”. Në Islam, monoteizmi është absolutisht i qartë:

1. Thuaj: Ai, All-llahu është Një!
2. All-llahu është Ai që çdo krijesë i drejtohet (i mbështetet) për çdo nevojë.
3. As s'ka lindur kë, as nuk është i lindur.
4. Dhe Atij askush nuk i është i barabartë.<sup>20</sup>

Islami si parim të vetin e pranon njëshmërinë dhe unitetin e Zotit, fjala Arabe për monoteizmin është *Teuhid* që do me thënë “*të qenurit një*” do me thënë i vetëm, vetëm një në numër.

*Shehadeti* (që do me thënë dëshmi, deklaram), ose kredoja Islame, është deklarami i besimit në njëshmërinë e Zotit (Allah në Arabisht) dhe profetësinë e Muhammedit p.q.m.t. Transliterimi i shehadetit është ky: “*eshhedu en la ilahe il-lalla ve eshedu enne muhammeden abduhu ve resuluhu*” që në përkthim don të thotë: *Besoj dhe deklaroj se ekziston vetëm një Zot – All-llahu dhe se Muhammedi është rob dhe i dërguar i Tij* ”. Kjo deklaratë dhe besimi konsiderohet si i pari prej Pesë Shtyllave të Islamit. I dyti është realizimi i pesë lutjeve çdo ditë (*pesë namazet*) që paraprihen me larjen ceremoniale (*abdesin*). Gjatë faljes, të gjithë muslimanët kthehen kah qyteti i shenjtë i Mekës, pavarësisht se në cilin vend dhe sa larg janë ata. Shtylla e tretë është mbajtja e *Ramazanit*, agjërimi prej lindjes së diellit deri në perëndimin e tij, për një muaj rresht. E katërta është dhënia e lëmoshës (*Zekati*) e shpallur në ligjin Islamik. Dhe shtylla e fundit është që çdo musliman, sipas mundësive së paku njëherë në jetën e tij të shkojë në *haxhillëk në Mekë*.

Në bazë të Islamit, “*njëshmëria e Zotit*” është mësimi primar i të gjithë profetëve dhe të dërguarve të Zotit (duke përfshirë këtu edhe Jezusin edhe Moisiun), që u dërguan njerëzimit si udhëheqës. Islami e konsideron trinitetin si politeizëm dhe si shtrembërim të porosisë origjinale të Jezusit për njëshmërinë e Zotit.

---

<sup>20</sup> Kur'an – Sure Ihlas

## **BUDIZMI**

Budizmi ka hyrë në Kinë rreth shekullit të parë të erës sonë, filloi të përhapet gjerësisht pas shekullit të 4-të të erës sonë dhe është bërë gradualisht feja me ndikim më të madh në Kinë. Budizmi kinez ndodhet në bazë të tre familjeve të mëdha të gjuhëve dhe mbi këtë bazë kemi budizmin e familjes së gjuhës Hane, budizmin e familjes së gjuhës tibetiane dhe budizmin e familjes së gjuhës Bali, ose budizmin jugor. Numri i murgëve të këtyre tre grupeve të mëdha sipas familjeve gjuhësore ka arritur në 200 mijë. Tani në Kinë ka 13 mijë tempuj të hapur të budizmit, 33 shkolla budiste dhe afro 50 lloje botimesh budiste.

Budizmi tibetian është një degë e budizmit kinez, që është përhapur kryesisht në Rajonin Autonom të Tibetit, Rajonin Autonom të Mongolisë së Brendshme, në provincat Çinhaj etj. Banorët tibetianë, mongolë, Ygu, Mënba, Luoba dhe Tu besojnë, në përgjithësi, budizmin tibetian dhe numri i besimtarëve të tij arrin në afro 7 milionë. Budizmi jugor është kryesisht i përhapur në qarkun autonom Sisuanbana të kombësisë Daj, në qarkun autonom Dëhong të kombësive Daj dhe Gjinbo, në zonën Sëmao të provincës Ynan të Kinës jug-lindore. Në budizmin jugor beson shumica e banorëve Daj, Bulang, Açan dhe Va. Numri i besimtarëve të tij arrin në mbi 1 milion. Kurse në budizmin Han besojnë kryesisht banorët Hanë, të shpërndarë në krahina të ndryshme të Kinës.

## **KONFUCIANIZMI**

Ka qenë baza e kulturës së grupeve sunduese në Kinën tradicionale. “Konfuci” (forma e latinizuar e emrit Kung Fu-Tzu), jetoi në shekullin e VI p.e.s. Sikurse themeluesi i Taoizmit Lao-Ce (Lao-Tsze), Konfuci ishte mësues dhe jo një profet fetar sipas stilit të udhëheqësve fetarë në Lindjen e Mesme. Konfuci nuk shikohej prej ndjekësve të tij si Zot, por “si më i mençuri i burrave të mençur”. Konfucianizmi synonte të rregullonte jetën njerëzore sipas harmonisë së brendshme të natyrës, duke theksuar nderimin e thellë të stërgjyshërve.

## **TAOIZMI**

Taoizmi është lindur dhe përhapur në Kinë. Ai filloi qysh në shekullin e dytë të erës sonë dhe ka një histori mbi 1800 vjeçare. Taoizmi është trashëguar nga adhurimi i natyrës dhe i paraardhësve në kohën e lashtë, ka pasur shumë fraksione në histori dhe më vonë është bashkuar në dy fraksione, si Quanzhën Tao dhe Zhëngyi Tao, që ushtrojnë ndikim në gjirin e banorëve të kombësisë Hane. Për arsye se Taoizmi nuk ka ceremony dhe rregulla të rrepta të



hyrjes së besimtarëve, pra është vështirë të numrohet numri i besimtarëve të tij. Tani në Kinë ka mbi 1500 tempuj doist dhe mbi 25 mijë murg e murgesha taoiste.

## **KLASIFIKIMI I LLOJEVE TË RELIGJIONIT**

Duke e definuar religjionin, duhet të merret parasysh fakti se kemi disa lloje të religjioneve në botë. Të gjitha janë të ngjajshme sa mundemi që në një kategori t'i quajmë religjione, por ato gjithashtu janë të ndryshëm që duke kërkuar në këto nënkategori do jetë e dobishme të kuptojmë për besimet fetare femonenin e religjionit.

Një gjë që është e rëndësishme të theksojmë është se këto kategori nuk janë të gjitha të veçanta. Kjo do të thotë se nuk ka rast ku një religjion duhet të jetë pjesë e një tjetri dhe nuk mund të jetë pjesë e cilitdo religjion tjetër. Nuk është e pazakonshme për një religjion të jetë pjesë e një ose më shumë grupimeve. Kjo nuk do të thotë që të bëhet ndarja e religjioneve në grupe të ndryshme por të kuptojmë mënyrat se si manifestohet ajo në shoqërinë dhe psikologjinë njerëzore.

### **Çka janë Religjionet Natyrore**

Karakteristikat dalluese, Besimet dhe Zbatimi

Sistemet e njohura si religjione natyrore shpesh janë të konsideruara besimet primitive fetare. "Primitiv" në këtë rast nuk i referohet kompleksitetit të sistemit fetar (sepse fetë natyrore mund të jenë shumë komplekse). Në të vërtetë i referohet idesë se fetë natyrore janë ndoshta lloji më i hershëm i sistemit fetar i zhvilluar nga qenia njerëzore. Sot, religjionet natyrore në Perëndim prirën të jenë shumë "eklektike", kështu që ato mund të huazojnë nga varieteti i të tjerave, e më shumë nga traditat e vjetra.

Religjionet natyrore kryesisht janë të fokusuar në idenë se Zotërat dhe fuqitë e tjera supernatyrore mund të gjinden përmes përvojës direkte të ngjarjeve dhe objekteve natyrore. Besimi i saktë i hyjnive është i zakonshëm por jo i urdhëruar – nuk është e zakonshme për hyjnitë të trajtohen si metaforike.

Cilido që të jetë rasti, aty çdoherë ka pluralitet; monoteizmi nuk gjindet në religjionet natyrore. Është e zakonshme për këto sisteme religjioze të trajtojnë tërësinë e natyrës si të shenjtë ose madje si të perëndishme.

Një nga tiparet e religjioneve natyrore është se ato nuk mbështeten në shkrime të shenjta, profet individual, ose figura të veçanta fetare si simbole të tyre. Çdo besimtar trajtohet si i aftë për të kuptuar shenjtërinë dhe supernatyroren. Sidoqoftë, është ende e zakonshme në disa sisteme fetare të kenë shaman ose udhëheqës të tjerë fetarë që i shërbejnë shoqërisë.

Religjionet natyrore synojnë të jenë relativisht egalitare sa u përket pozitive të udhëheqësve dhe marrëdhënieve ndërmjet anëtarëve. Çdo gjë që është në univers dhe që nuk është e krijuar nga njerëzit është e besuar të jetë e lidhur me një tërheqje të ndërlikuar të energjisë ose jetës – fuqisë – që gjithashtu përfshinë edhe njerëzit. Nuk është e pazakonshme që të gjithë anëtarët të konsiderohen si kler të një lloji (priftëresha dhe priftërinj). Marrëdhëniet hierarkike, nëse ato ekzistojnë, priren të jenë të përkohshme (për një arsye të veçantë, ndoshta) dhe/ose një pasojë e përvojës ose viteve. Edhe meshkujt edhe femrat mund të jenë në pozita udhëheqëse, ku femrat shpesh janë si udhëheqëse në rituale.

Religjionet natyrore gjithashtu nuk ndërtojnë ndonjë ndërtesë të shenjtë të përhershme që u dedikohen qëllimeve fetare. Ato mund që ndërkohë të ndërtojnë ndërtesë të përkohshme për qëllime të veçanta, si shtëpizë mundimi, dhe ato gjithashtu mund të përdorin ndërtesat ekzistuese për aktivitetet fetare. Duke folur në përgjithësi, sidoqoftë, vendi i shenjtë është në ambient natyror më shumë sesa në ambient të ndërtuar me tulla dhe llaç. Ndodhitë fetare shpesh mbahen në hapësirë të çelur, në parqe, në plazhe ose në male. Ndonjëherë bëhen disa ndryshime të vogla nëpër këto vende, si vendosja e ndonjë guri, por asgjë e përhershme.

Shembuj të religjioneve natyrore mund të gjinden në besimet moderne neo-pagane, besimet tradicionale të shumë fiseve vendore nëpër botë, dhe në traditat e besimeve të vjetra politeiste. Një shembull i injorimit të religjionit natyror është deizmi modern, një besim i sistemit teist që ka lidhje me gjetjen e shenjave të një krijuesi, Zotin, në ndërtimin e natyrës. Kjo shpesh përfshin zhvillimin e një sistemi religjioz mjaft personal të bazuar në arsyet dhe studimet universale – kështuqë, shpërndan me karakteristikat e tjera të religjioneve natyrore si decentralizimi dhe një fokusim mbi botën natyrore.

Përshkrimet më pak mbrojtëse të religjioneve natyrore ndonjëherë argumentojnë se një veçori e rëndësishme e këtyre sistemeve nuk është harmonia me natyrën sikur që shpesh thuhet, por zotërimi dhe kontrolli mbi forcat e natyrës. Në “Religjioni Natyror në SHBA” nga Catherine Albanese (1990) argumenton se bile edhe besimi racionalist i Amerikës së hershme ishte i bazuar në impulsin për kontroll të natyrës dhe njerëzve jo elitë.

Madje edhe nëse analiza e Albaneses për religjionin natyror në Amerikë nuk është krejtësisht i saktë, duhet të pranohet se sisteme të tilla religjioze vërtetë përfshijnë “anën e errët” mbas retorikës së këndshme. Duket të ketë një tendencë drejt zotërimit mbi natyrën dhe njerëzve të tjerë që mund, megjithëse nuk duhet, të gjejnë shprehje të vrazhda – për shembull Nacizmi dhe Odinizmi.<sup>21</sup>

---

<sup>21</sup> [www.about.com](http://www.about.com)

## **Çfarë janë religjionet Shfaqëse/Zbuluese**

Karakteristikat dalluese, Besimet dhe Zbatimi

Gjithashtu e përshkruar edhe si Religjion Ligdhënës, Religjionet Shfaqëse janë ato që gjejnë qendrën simbolike në disa vija zbuluese nga zoti ose zotërat. Këto zbulime normalisht mbahen në shkrimet e shenjta që na janë transmetuar neve nga profet të nderuar të zotit ose zotërave.

Sidoqoftë, shkrimet e shenjta nuk janë forma e vemte e shfaqjes që mund t'i jepet njerëzimit nga Zoti. Një formë tjetër e shfaqjes mund të përfshijë edhe mrekullitë që komunikojnë vullnetin ose dëshirën e Zotit. Për shkak të kësaj, është e rëndësishme të kuptojmë se dallimi mes religjionit shfaqës dhe atij natyror nuk është gjithmonë i pastër – nuk do të mund të ishte e çuditshme për besimtarët ta konsiderojnë natyrën se është një shfaqje e Zotit për njerëzimin.

Religjionet shfaqëse kryesisht janë të varura në idenë e një zoti apo zotërave aktiv – duke u dhënë shfaqje njerëzimit i bënë ata aktiv në jetën dhe fatin e tyre. Një aktivitet i këtillë priret të marrë formën e mrekullisë ose duke shfaqur drejtëpërdrejtë nga një zot ose përmes profetit të zotit apo përfaqësuesit.

Religjionet shfaqëse në mënyrë tipike kanë strukturë hierarkike, si në udhëheqje ashtu edhe në marrëdhëniet në mes anëtarëve. Meqë fokusi është në shfaqjen hyjnore, disa anëtarë janë të caktuar si ndërmjetësues ndërmjet njerëzve dhe hyjnore; këta ndërmjetësues shërbejnë ose si kanal për vazhdimi të shfaqjes hyjnore ose si interpretues autoritativ të shfaqjeve të kaluara. Për shkak të natyrës së strukturuar të adhurimit shoqëror, religjionet shfaqëse ndërtojnë ndërtesa të përhershme për të shërbyer si hapsira të shenjta dhe si pika kryesore për shërbime fetare.

Në religjionet shfaqëse, detyra primare e njerëzve priret për të qenë të devotshëm dhe të dëgjueshëm për Zotin. Pas gjithë kësaj, shfaqjet nga Zoti nuk janë të bëra pa arsye të mira: më tepër, ajo bëhet me qëllim që t'u komunikohen njerëzve gjërat që ata duhet t'i besojnë, gjërat që duhet t'i bëjnë, dhe qëllimet e Zotit për botën. Disa herë këto udhëzime mund të jenë të paqarta dhe disa herë tortura të veçanta. Atë që të gjithë e ndajnë është sidoqoftë kërkesë që duhet të jetë e zbatuar.

Çështja e urdhërave morale gjatë kohë ka qenë pikë e mosmarrveshjes mes adhuruesve të religjionit shfaqës dhe atij natyror. Përgjatë historisë, e veçanërisht gjatë shekujve XVIII dhe

XIX adhuruesit e religjionit natyror ashpër kanë kritikuar ata të atij shfaqës për kodet e udhëheqjes së rreptë dhe të palëkundshme, që sipas tyre i çoi ata në ligësi dhe dhunë.

Adhuruesit e religjionit shfaqës u përgjigjen duke argumentuar se vetëm shfaqjet hyjnore mund të sigurojnë për njerëzimin udhëzime autoritative dhe të sigurta të bazuar në atë se çfarë zoti apo zotërat kërkojnë nga ne. Cilido zot i denjë për emrin duhet të jetë i aftë për shfaqjen dhe do të ishte e papranueshme të konkludojmë se shfaqja nuk është e dëshirueshme. Prandaj, është e argumentuar, se do të ishte gabim të mos pranosh shfaqjet si rezultate të shkëlqyeshme e bile edhe më qesharake të nënvleftësosh shfaqjet e qarta përpara neve.

Religjionet shfaqëse kryesore në botë sot përfshijnë Judaizmin, Krishterimin, Islamin dhe Sikizmin. Traditat e këtyre religjioneve mbështeten në përmbledhjet e veçanta të shkrimeve të shenjta që janë si shfaqje autoritative të burimit hyjnor. Hinduizmi në fillim u përshkrua si religjion shfaqës për shkak të vendit të mirënjohur të Veda-s, por duket se kjo është gabim. Hinduizmi, u përshkrua nga adhuruesit e vet si një “religjion i çliruar” (i nxjerrur) dhe arsyeshmërisht cekin se “Veda” thjesht don të thotë “dituri e shquar nga parashikuesit Vedik”.

## **Çka janë Religjionet e Shpëtimit (salvacionit)?**

Karakteristikat dalluese, Besimet dhe Zbatimi

Kategoria e Religjionit të Shpëtimit duket të jetë kryesisht një krijim i Krishterimit për shkak të theksit të saj në mëkat dhe shpëtim. Sidoqoftë, është një kategori që meriton vëmendje të madhe.

Religjionet e shpëtimit janë kryesisht të themeluara nga profet ose udhëheqës fetar që forjmonë një doktrinë që u sqaron njerëzve se si shpëtimi mund të arrihet. Legjitimiteti dhe autoriteti afatgjatë i këtyre profetëve shpesh është i varur në zotërimin e një shkalle të lartë të dhuntisë personale shpirtërore (karizëm), dhe ndonjëherë mundësisht për të bërë mrekulli – si duket shenjë e një përkrahje dhe miratimi hyjnor.

Përcjellësit e rrethit më të ngushtë rreth profetit gjithashtu pranojnë një shkallë të lartë të rrespektit dhe një status të rritur afërsisht me fuqinë e tyre për fuqinë dhe profetin e perëndisë. Kjo shpesh çon në sistem hierarkik në religjionet e shpëtimit. Shpesh hierarkia është shumë e formalizuar me trajnime dhe mesha të veçanta; ndonjëherë hierarkia është e mvarur në përvojën dhe mençurine e demonstruar.

Në religjionet e shpëtimit, ka kryesisht ndjenja të forta të paaftësisë, vuajtje dhe/ose mëkatim prej të cilave njerëzit duan të lirohen. Religjioni u ofron përgjigjen: ndonjëherë mund

të na tregojë se ne duhet të shpëtojmë përmes fuqisë dhe dashurisë së Zotit, e ndonjëherë na tregon se shpëtimi mund të arrihet përmes disa përpjekjeve tona.

Cilido rast qoftë, **disa përpjekje** ose **disa veprime** janë të domosdoshme nga besimtari me qëllim që të arrijë shpëtim – kjo nuk është një dhuratë plotësisht e lirë, përndryshe nuk do të kishte nevojë për profet që t’u komunikojë njerëzimit mesazhin e shpëtimit. Këto përpjekje shpesh janë të lidhura ngusht me rituale të sistematizuara dhe ceremoni që tregojnë zhvillimin afatgjatë të individit ashtu që ata lëvizin drejt shpëtimit të tyre përfundimtar. Kjo ka për qëllim të sistematizojë dhe të racionalizojë strukturën e tërësishme të jetës së personit dhe vështrimin e tyre mbi botën

Ky vështrim kryesisht përfshinë doktrinat që kanë të bëjnë me vëllazërimin universal dhe dashurinë universale. Për dallim nga religjionet fisnore që janë të lidhura vetëm për anëtarët e një grupi, religjionet e shpëtimit janë të përshtatshme për gjithë njerëzimin sepse mesazhi i shpëtimit dhe shpengimi mendohet për gjithë njerëzimin, madje edhe nëse ajo në fillim i ishte dhënë vetëm një grupi të vogël. Religjionet e shpëtimit kanë një theks të lart në kapërcimin e fiseve, racave, dhe kufijve etnik derisa gjithashtu nxitë prozelitizimin (kthyerjen në fe) me qëllim që të sjellin sa më shumë nga njerëzimi “në tufë” nga ata që do të jenë të çliruar nga vuajtja dhe mëkati.

Një pasojë e keqe nga ky fokusim mund të jetë depersonalizimi i vetë dashurisë. Në vend që të jesh i drejtuar drejt një individi si individ, dashuria drejtohet drejt abstraksionit “njerëzor”, nga e cila njerëzit janë vetëm anëtarë të rastësishëm. Kjo ka përparësinë e kapërcimit të dallimeve të rastësishme në mes njerëzve që përndryshe mundet të ndalojë ndjenjat vëllazërore, por ka mangësinë e mundësisë së dobësimit të fuqisë së këtyre ndjenjave.

Krishterimi nuk është vetëm religjion i shfaqjes, por edhe i shpëtimit për shkak të shprehjes së rolit të Jezu Krishtit. Veç kësaj, mund të klasifikojmë edhe Budizmin si lloj të religjionit të shpëtimit për shkak të fokusimit në nevojën e gjetjes së lirit nga rrethi i vdekjes dhe rilindja. Me këtë rast, sidoqoftë, shpëtimi nuk vjen nga asnjë zot as nga ndonjë fuqi supernatyrore; në të vërtetë, shpëtimi arrihet përmes ndriçimit tonë të mendjes për natyrën e vërtetë të jetës dhe realitetit.

## **Çka janë Religjionet Sakramente (shenjta)**

Karakteristikat dalluese, Besimet dhe Zbatimi

Fjala sakrament rrjedh nga latinishtja “sacramentum” që do me thënë “betim, gjë e shenjtë, mister”. Në Romën e vjetër, koncepti i referohej një betimi të besnikërisë nga ushtarët Romak kur ata hynin në ushtri. Përbante një ceremoni të shenjtë e përcaktuar për tu bërë përshtypje rekrutëve të rinj për obligimin e tyre për Romën.

Sot, një sakrament është i shenjtë, ceremoni fetare që supozohet të sjell ca shenja të dukshme të prezencës së një zoti në mesin e besimtarëve dhe që ngulitë në to obligimet e tyre si besimtarë. Si rezultat, religjioni sakrament është një që thekson ose vë në focus idenë se hyjnorja është prezente në objekte fizike në prezencë të besimtarëve. Kontakti dhe komunikimi me hyjnoren është kryesisht përmes atyre objekteve dhe ceremonive.

Objektet mund të jenë ikona fizike si statuja, ushqim si për shembull bukë dhe verë në Eukaristat Krishtere (lidhjet shpirtërore me Zotin), ose bile edhe sende të gjalla si lopët në Hinduizëm. Objekti në vetvete nuk trajtohet si hyjni; por ai ose është manifest i hyjnorese ose bujtinë (e përkohshme) e hyjnorese. Për shembull Çifutët e hershëm e ruanin Arkën e Kontratës si vend banimi i fuqisë së hyjnorese pa e adhuruar atë si zot në vete.

Meqë fokusi është objekte materiale, aktivitetet fetare në religjionet sakramente përqëndrohen rreth ritualeve duke përdorur këto objekte. Objektet e shenjta (reliktet, statujat, kryqet) që ndonjëherë përdoren për të bartur substanca të shenjta (bukë, verë, dhe) janë të trajtuara me një nderim të veçantë (në mënyrën se si bartën, në mënyrën se si preken) derisa ritualet u shërbejnë për transmetimin e fuqisë së shenjtë ose mirësinë besimtarëve present (shpesh përmes një personi që shërben si mediator).

Meqë theksi është i vënduar në ceremony, është e zakonshme të kenë specialist apo autoritete fetare. Këta specialist mund të kenë pozita të përhershme të krijuara nga hierarkia fetare (si prifti) ose mund të kenë një status të përkohshëm që është vetëm sa për zgjatjen e ceremonisë.

Specialistët e përhershëm, sidoqoftë, janë më të përgjithshëm; në të vërtetë është e argumentuar se krijimi i autoriteteve të përhershme fetare është pjesërisht rezultat i zhvillimit të religjioneve sakramente dhe nevoja e tyre për persona të aftë në menaxhimin dhe administrimin e ritualeve sakramente. Këta mediatorë qëndrojnë edhe në botën e shenjtë edhe në atë laike duke shërbyer si mediatorë ndërmjet njerëzimit dhe të shenjtës.

Shumë forma të Krishterimit janë shpesh të trajtuara si shembuj tipik të religjionit sakrament për shkak të përdorimit të objekteve dhe ritualeve që kanë të bëjnë me ato objekte. Sidoqoftë, këtu hyjnë edhe shumë religjione primitive dhe natyrore. Ishte e zakonshme në një kohë për njerëzit të fokusohen në rituale sakramente për të siguruar vazhdimësinë e të reshurave të dobishme dhe korrijeve të mira. “Objektet” e shenjta mund të jenë një lum, një arë, ose disa

vendqëndrime të tjera të shenjta, ku prezenca e të shenjtës do të banonte gjatë një ceremonie. Rituale mund të jenë ato që theksojnë lidhjen ndërmjet ciklit të jetës njerëzore dhe ciklin e stinëve.

Qoftë funksioni i një hierarchie formale ose i varur mbi ndryshimet e stinëve, ritualet kryesisht shërbejnë për t'u ndihmuar të lidhin personin me grupin shoqëror dhe me sistemin fetar. Si pasojë, fokusimi në kungatat dhe ritualet sakramente ndihmojnë të përforcojnë fuqinë e autoriteteve fetare bile edhe kur statusi i tyre është i një natyre të përkohshme.

Një nga rreziqet potenciale në religjionet sakramente është fokusimi i tyre në objektet e shenjta ku prezenca e të shenjtës mund të lejojë një zhvillim të “idhujtarisë” nëse njerëzit besojnë se ato objekte janë të shenjta në vetvete. Një rrezik tjetër është e kundërta e kësaj kur njerëzit besojnë se objektet e shenjta janë “simbole të thjeshta”, fuqi e mangët ose thjesht domethënie fetare.

## **Çka janë Religjionet Profetike?**

Karakteristikat dalluese, Besimet dhe Zbatimi

Religjioni Profetik është fort i lidhur me Religjionin e Shpallur dhe ka momente kur këto dy terme mund të përdoren këmbëveshëm, por nuk janë saktësisht të njëjtë. Në religjionet profetike, në shpalljet e shenjta roli i profetëve është në një status të veçantë. Profetët janë për të udhëhequr dhe për të këshilluar shoqërinë kur të jetë në ngecje – kështu, ata luajnë rolin e **vepruesit** dhe rolin **dinamik** ku teksti statik i shpalljes nuk mund t'i arrijë lehtë.

Ka disa mospajtime në pikën e fundit. Disa shkollare sugjerojnë se roli historik i profetëve është i mjaftueshëm për një religjion ta kualifikojë atë si religjion profetik, bile edhe nëse në të nuk ka më rol veprues për të. Nga kjo, Judaizmi shpesh quhet religjion profetik edhe pse koha e profetëve çifut është shumë e hershme.

Në kuptimin më të ngushtë të religjionit profetik, Judaizmi nuk do të kualifikohet në këtë lloj. Shembull i këtij religjioni është Mormonizmi. Anëtarët e Kishës së Jezu Krishtit të Ditëve të Fundit besojnë se udhëheqësi i kishës së tyre është një profet aktiv i Zotit dhe është i aftë për pranimin e shpalljeve të reja për atë se çfarë don Zoti nga njerëzimi.

Në religjionet profetike, fokusimi qendror është shoqëria dhe veprimet njerëzore – ato që manifestojnë dëshirën dhe prezencën e hyjnore. Kështu, një person që kërkon hyjnoren do të shikojë në natyrën e shoqërisë dhe rrugën e historisë së njerëzimit – për shembull, ngritjen



dhe rënien e perandorive të mëdha. Dëshira e hyjnores shihet në ngjarje të këtilla, në marrje të asaj se gjërat e mira në historinë e njerëzimit reflektojnë lumturinë e hyjnores derisa ngjarjet e këqija zemërimin e hyjnores.

Kjo don të thotë se një vëmendje e afërt drejt hyjnores është e domosdoshme sepse askush nuk don të prodhojë zemërim. Si pasojë, bindja për hyjnoren luan një rol të rëndësishëm në religjionet profetike – e që zakonisht shpjegohet si Besim. Ky theks në sjellje të duhura çon religjionet profetike të vënë më shumë theks në orthopraksë (orthopraxy – sjellje të drejtë) sesa në orthodoxi (besim i drejtë).

Kjo nuk don të thotë se religjionet e këtilla nuk kanë dert se çfarë besojnë njerëzit. Besimet e drejta nuk janë të mjaftueshme për njerëzit të deklarohen se janë të “mirë”. Në të vërtetë, ata duhet që drejtë të mbështeten në pritjet e sjelljeve që janë të transmetuara nga Zoti përmes profetëve.

Nëse i kuptojmë religjionet profetike se janë cilido religjion ku profeti ka luajtur një rol të rëndësishëm, madje nëse tani nuk është rasti për të, ne gjithashtu do të kuptojmë se religjionet profetike kanë një profet të vetëm, unik i cili ishte krijues i atij religjioni. Ky profet besohet të ketë transmetuar shpallje unike dhe autoritative, shpesh duke krijuar një religjion të ri, jashtë nga traditat e religjioneve paraekzistuese.

## **Çka janë Religjionet Mistike?**

Karakteristikat dalluese, Besimet dhe Zbatimi

Religjion Mistik është ai në të cilin përvojat mistike luajnë rolin më të rëndësishëm në kuptimin e natyrës, të mësuarit për hyjnoren dhe të jesh një person i devotshëm dhe fetar. Në ekstrem, përjashton të gjitha çështjet me jetën, shoqërinë dhe besimtarët e tjerë – nuk është pra surprizë që religjionet mistike nuk kanë një jetë të gjatë në traditën e religjioneve.

Sistemi i religjionit mistik është i përafërt me përshkrimin e Maks Veberit për autoritetin karizmatik, një lloj autoriteti që është në besnikërinë e një personi dinamik dhe të fuqishëm. Kur ai person vdes, struktura shoqërore e krijuar nga ai autoritet do të bie përveç atëherë kur një autoritet i ri e merr përsipër atë ose vetë sistemi transformohet për të përfshirë elemente të tjera të autoritetit racional (hierarkisë racionale) ose autoriteti tradicional (shenjtëria e traditës).

E vërtetë të religjionet mistike është se: përvoja mistike e një ose disave nuk rezulton në traditën fetare që mbetet koherente dhe jetëgjatë përveç në tekstet e shkruara ku traditat janë të shtuara në përzierje. Kjo është e vështirë të arrihet sepse religjionet mistike kryesisht u shmangen ritualeve, kungatave, çështjeve materiale dhe traditave. Kontakti me hyjnoren mund

të ndihmohet me rituale të veçanta, por ato nuk janë të varura dhe qëllimi kryesor është të jenë si mbështetëse.

Një pasqyrim i veçantë e prirjes për religjiozitetin mistik nuk është përmes një religjioni të pavarur, por shpesh si një alternativë Brenda disa traditave të religjioneve të tjera. Shumë religjione ofrojnë një rrugëdalje shumë specifike për impulsin mistik; misticizmi është i kanalizuar dhe udhëhequr në mënyrë që është i qëndrueshëm me doktrinat e traditave dominante.

Kjo është e rëndësishme sepse misticizmi është i vështirë të parashikohet dhe kontrollohet. Çdokush mund të ketë ndonjë lloj përvojë dhe të dalë me një lloj mprehtësie, inspirim apo porosi. Kjo mund të rezultojë në idetë që janë në kundërshtim me idetë e religjioneve dominante; edhe më keq, idetë mund të përfitojnë përcjellës dhe jenë një sfidë e autoriteteve fetare.

Duke kontrolluar kontekstin dhe të mësuarit e një “misticizmi” të autorizuar, religjioni dominues mund të ketë një ndikim të madh mbi llojet e njerëzve me përvoja të tilla fetare ku ato interpretohen.

## **Çka janë religjionet Fisnore?**

Karakteristikat dalluese, Besimet dhe Zbatimi

Religjioni Fisnor më mirë do të kuptohet me atë se çka nuk është: nuk është një që ka mesazh fetar për gjithë njerëzimin, nuk ofron ndonjë shpëtim të përgjithshëm, nuk ka kuptimin e pasjes së një mprehtësie unike në dëshirën e ndonjë zoti, dhe nuk pret nga të tjerët të kujdesen për atë se çfarë do të thuhet.

Religjionet fisnore janë tradita fetare të një grupi shoqëror që kanë ekzistuar në një kohë dhe vend të caktuar. Religjionet fisnore shërbejnë si depo për mençurinë e mbledhur, historinë dhe besimet e atij fisi.

Religjionet fisnore mund të pranojnë konvertim në rrethana të veçanta, por ajo shpesh është e shkurajuar dhe gati asnjëherë e inkurajuar. Aty nuk ka rol ndërrimi. Anëtarësimi në këtë religjion arrihet nëse lind në atë fis. Ata të cilët nuk janë aq me fat të linden në atë fis nuk pritët që ndonjëherë të kuptojnë ose vërtetë ta besojnë atë bile edhe nëse ato kalojnë përmes disa rriteve të veçanta konvertimi.

Religjionet fisnore kanë zakonisht specialist të cilët shërbejnë si autoritete fetare për fisin. Këta specialist interpretojnë historinë e fesë dhe traditën e njerëzve se si ata duhet a aplikojnë atë në situatë të reja. Specialisti është kryesisht njeriu i njejtë i cili është përgjegjës për interpretimin e shenjave nga natyra si dëshira të zotërave ose shpirtërave – për shembull të përcaktojnë aprovimin apo mosaprovimin për luftë ose shpërngulje.

Nëse fisi është i vogël, specialisti fetar është i vetëm ose me dy bashkëpunëtor (nxënës). Nëse fisi është i madh, klerarkia fetare mund të zhvillohet me qëllim që të ketë një sistem racional për përcaktimin e asaj se kush ka autoritet dhe trajnim për të interpretuar traditën dhe shenjat nga zotërat.

Njëri prej religjioneve më të mëdha në botë, Hinduizmi, mendohet të jetë religjion fisnor sepse fokusohet në shprehjen e vlerave kulturore dhe historike Indiane. Ata mendojnë se të jesh një Hindu, do me thënë të jesh pjesë e shoqërisë Indiane.

## VENDI DHE FUNKSIONI I RELIGJIONIT NË SHOQËRI

Në formën e vet më të thjeshtë çdo religjion mund të shihet si një sistem besimi. Ky sistem mund të ndikojë në vlera, ligje, zakone, rituale dhe modelet e pergjithshme të sjelljes. Religjioni mund të ndikojë në individin, grupin, shoqërinë ose kombin. Mund të luajë një rol periferik ose integral mbrenda shoqërisë. Struktura e tij mund të jetë komplekse si çdo organizatë e madhe byrokratike ose e thjeshtë si një marrëdhënie dy-kahëshe në mes një personi ose një objekt/subjekti të një pune.

Funksioni i religjionit në një shoqëri është shpesh i sqaruar njerëzve si origjinë primare, natyrë e jetës, funksion, qëllim i jetës dhe arsye për të jetuar. Për ta bërë më të thjeshtë, i përgjigjemi pyetjes “*Pse jam këtu*”. Në të kaluarën religjioni është përdorë si mekanizëm kontrolli, mënyrë e të arriturit të urdhërit, si dhe delegimit të roleve dhe përgjegjësi. Nga pikëpamja sociologjike “*Dhjetë Urdhërat*” të dhënuna Musa-s janë një grup rregullash të sjelljes të cilat mund të sjellin rend dhe harmoni në shoqëri, të cilat do t’i mundësonin shoqërisë funksionim në një mënyrë të organizuar dhe sistematike.

Religjioni mund të diktojë një grup të pranueshëm standardesh dhe ata të cilët duan të mbeten në atë shoqëri duhet t’i mbështeten këtyre standardeve, mbrenda kufijve të pranueshmërisë. Për ata të cilët nuk mund ta bëjnë këtë, prej çfarë do lloj arsyeje, është opcioni i lëshimit të shoqërisë ose fillimit/marrjes pjesë në një religjion tjetër.

Kryesorja e gjithë religjioneve është koncepti i një marrëdhënie. Marrëdhënia mund të përfshijë një apo më tepër njerëz, mund të jetë fizike apo shpirtërore, dinamike apo statike, reale apo imagjinative. Mbrenda kufijve të kësaj marrëdhënie janë të përdorura fjalët sikurse “*përkushtim, ndriçim i mendjes, rrespekt, besim, shenjtërim, i shenjtë, adhurim, ngushëllim, sakrificë mistike dhe karizmatike*”. Kanalet e komunikimit mund të jenë formale dhe të organizuara nëpërmjet priftit/priftëreshës, magjistar/shamanit, ku ka të caktuar kohën dhe vendin ku mund të mbahen aktivitetet fetare. Komunikimi mund të jetë jo formal ku individit ka “*linjë direkte*” në çdo kohë dhe në çdo vend. Në shembullin e fundit të besimit në objektet fetare (figura, statuja, tempuj ose vizatime) rëndësia e tyre mund të mos jetë esenciale.

Besimi dhe vlerat e mbajtura të shoqërisë janë shpesh të inkorporuara në shoqëri. Kolektivisht ato mund të formojnë moralin e shoqërisë. Ligjet dhe rregullat të cilat udhëheqin shoqërinë mund të reflektojnë këtë moral. Kontrolli dhe sistemi i ndëshkimit mund të “*thurret në ndërtimin e religjionit*” dhe në disa shoqëri kanë rol dominues.

Ndëshkimi mund të jetë i menjëhershëm dhe i ashpër duke kërkuar legitimacion nëpër vite ose mund të jetë i shtyrë deri pas vdekjes kur ashpërsia është e lartësuar nga misticizmi dhe

imagjinata. Alternativë e ndëshkimit mund të jetë kontrolli nëpërmes faljes dhe pendimit, mëshira është kualitet i mirë dhe shumica e shoqërive e pranojnë vlerën dhe ndikimin e saj.

Religjioni mund të shihet si një process shoqëror në mes shumë proceseve shoqërore. Është prodhim i mendjes së njeriut, entitet kompleks shoqëror i cili ka kaluar nëpër gjenerata. Si një prodhim i shoqërisë është në mënyrë të pazgjidhur i lidhur me produktet tjera shoqërore sikurse politika, ekonomia, ligji, muzika dhe arti. Ka një lloj energjie në vete, njëherë e lindur mund të zhvillojë dhe ndërrojë në pajtueshmëri me vetvetën, mund të nxjerr rregulla të veta. Në përgjithësi është domethënëse vetëm për ata të cilët i takojnë kulturës nga e cila religjioni ka dalur. Religjioni mund të përcillet nga një kulturë në tjetrën, por zakonisht me vështirësi dhe sukses të pasigurt.

Religjioni mund të jetë i larmishëm sikurse kulturat e ndryshme nga e cila ajo del. Lista e religjioneve më të rëndësishme botërore është me sa vijon:

- *Shinto* nga Japonia
- *Islamizmi*, dominuese në Lindjen e Mesme dhe pjesë të Azisë, nga e cila janë dy degë, *Suni* dhe *Shi'izëm*.
- *Hinduizmi* në Indi dhe Indonezi.
- *Budizmi* në Azinë Jug-Lindore e cila zhvillohet në dy besime, “ Mjeti i Madh” *Mahayana* dhe “ Mjeti i Vogël “ *Hinayana*.
- Religjioni Kinez *Taoizmi* dhe *Konfucianizmi*.
- *Krishterizmi* i shpërndarë nëpër Europë dhe Botën e Re ( Amerikat ) në formë të *Krishterizmit Ortodoks*, *Katolicizmit Romak* dhe *Protestantët*.
- *Judaizmi* në Izrael, shumë religjione fisnore në Afrikë, Azi dhe Amerikën Jugore.

Ka shumë religjione të vogla, disa me një histori të gjërë dhe të tjerat sapo të krijuara.

Shumë religjione tentojnë të fokusohen në “ Figurën e Zotit” . Disa religjione kanë më tepër se një “ Figurë Zoti”( politeist ) si një objekt/subjekt përkuljeje ose përkushtimi. Besimi në simbolet fetare, objektet e shenjta është i përbashkët për të gjitha religjionet sikurse është besimi i sigurtë në rimëshirim ose “jetë” pas vdekjes. Shumëllojshmëria e religjioneve ushtron një qëndrueshmëri me një larmi kulturash dhe kufizim rrugësh të cilat njerëzve u japin kuptim në botën e tyre. Këtyre praktikave fetare u është dhënë legjitimitet dhe besim në dokumente të shkruara të cilat në vetvete mund të ofrojnë një rrugë të ndritshme për ndjekësin e saj. Të krishterët e kanë Biblën e tyre, Hindusët mësojnë Vedas-in, Hebrejtë lexojnë Talmud-in,

Muslimanët gjejnë ndriçim të mendjes në Kur'an dhe Kinezët mund të mësojnë të shkruarat e Konfuçies-it.

Shumë religjione ballafaqohen me paradoksin e prezencës së një krijuesi hyjnor i cili është i dëlirë, i mirë dhe dashamirës në botën ekzistuese të së keqës, vuajtjes, shkatrrimit dhe dhimbjes. Si mundet një qenie që është i dëlirë dhe i mirë të krijojë të keqën? Religjionet kanë tentuar të e tejkalojnë këtë problem duke paraqitur një qenie të keqe, një kundërshtar ose kundër-zot. Ky anti-zot duke poseduar fuqi të madhe, është i prirë nga rënja e njeriut dhe shkatrrimit të shoqërisë. Të Krishterët e Judas e kanë 'Satan-ën', në Hinduizëm është Ahi dhe Shiva, në Budizëm është Mara dhe në disa religjione Afrikane figura djalleshe sikurse marimanga Anansi e njohur për njerëzit Ashanti të Ganës Qendrore. Në vendet e larta të Guinesë së Re ka shumë shpirtëra të djallëzuar të cilat kanë veti sëmundjesh, apo humbje në beteja. Në Afrikë dhe Melanezi veprat e këqija janë të drejtuara nëpërmes aktiviteteve të shtrigave dhe shamanëve.

Rëndësia e "*vdekjes dhe varrimit*" është e evidente në shumicën e religjioneve në botë. Njerëzit dallojnë gjerësisht në trajtimin praktik dhe të kuptuarit e këtij fenomeni universal. Megjithatë vdesim vetëm shumica e shoqërive dhe religjioneve e paraqesin vdekjen si një ngjarje të rëndësishme shoqërore. Janë të themeluara adete familjare, një strukturë e pranuar e sjelljeve të shokëve dhe fqinjëve. Njerëzit Bask e shohin si detyrë të tyre të vizitojnë të vdekurin, edhe nëse mund të jetë farefis apo që kurrë nuk e kanë parë më parë. Kjo 'detyrë' është shumë e zakonshme, vetëm se në shoqëritë urbane dhe ato të përparuara industrialisht të vdekurit ndonjëherë lihen vetëm në spitale apo shtëpi të pleqve.

Në shumë religjione ka një mbështetje shumë të madhe për të afërmit e të vdekurit. Dhimbja e tyre mund të bëhet më e lehtë nga intervenimet shpirtërore të 'priftërinjëve' shamanëve ose figura tjera fetare ose me komunikim direkt me hyjninë madhore. Është zakon për përcjellësit e të vdekurit të identifikohen në mënyrë që shoqëria t'i respektojë dhe kujdeset për kalimin e dhimbjes. Në Europë dhe Amerikë përcjellësit e të vdekurit vishen me të zeza, në Kinë ata vishen me të bardha, në Indi ata i qethin kokat e tyre dhe në Madagaskar ata nuk i krehin flokët e tyre. Koncepti i varrimit të duhur është kryesor në të gjitha shoqëritë edhe pse mund të ndryshojë mjaft nga pozita shoqërore e të vdekurit. Vdekja trajtohet ndryshe tek Hindusët të cilët besojnë se pas vdekjes pason ringjallja. Është praktikë Hinduse të kremoset i vdekuri, kështu duke i lejuar shpirtit të jetë i lirë, e jo i burgosur në varr. Në traditën Krishtere Judiste individët kanë vetëm një shpirtë, kurse tek fiset Indiane dhe Afrikane individët kanë 5 shpirtëra të shumëfishta.

Dajakët e Bornesë besojnë se njeriu i vdekur nuk e humb shpirtin menjëherë. Shpirti ka fuqinë të shkaktojë dëm në të gjallin prandaj trupi trajtohet me një rrespekt të madh derisa mishi të jetë komplet i kalbur duke i lejuar shpirtit të ndahet në paqë. Moshë e të vdekurit mund gjithashtu të ndikojë në praktikën e varrimit: shumë rite varrimi të krishterëve janë të rezervuara për ata që kanë qenë Baptist. Është një shprehje e përgjithshme në shumë religjione të konsiderohet vdekja si një ndëshkim për keqbërjet e njeriut. Të krishterët shpjegojnë se vdekja vjen në botë si rezultat i rrugëve të këqija të njeriut. Shumë njerëz tentojnë të përjetësojnë vetveten përtej vdekjes mbrenda strukturës dhe domethënies së religjionit të tyre. Besimi në jetën pas vdekjes nga mënyra ose e ringjalljes ose të një shpirti të pavdekshëm është ndoshta një nga komponentat më magnetike dhe më mistike të të gjitha religjioneve.

## **RELIGJIONI NGA PIKËPAMJA KONFLIKTUOZE**

Përkundër funksioneve të dobishme të religjionit për shoqërinë, ai mund të implikohet gjithashtu edhe në konfliktet e ndryshme shoqërore. Karl Marksi njihet si sociologu që ka shkruajtur për aspektin konfliktuos të religjionit. Spas tij, religjioni është një vetëdije falso dhe një mjet që njerëzit e fortë e përdorin në betejat mes klasave të shoqërisë. Marksi ka deklaruar se religjioni dominues në shoqëri është i klasës dominante në aspektin ekonomik dhe politik dhe gjithmonë jep justifike për barazinë dhe padrejtësitë e kësaj klase. Ai thotë: Njeriu e formon religjionin jo religjioni njeriun...Vuajtja religjioze është në të njëjtën kohë shprehje e vuajtjes reale edhe protestë ndaj saj. Religjioni është ofshamë e krijesave të shtypura, sentiment i botës pa zemër dhe shpirt i gjendjeve jo shpirtërore. Ai është opium i njerëzimit”.

Raste të pabarazisë në emër të religjionit kemi pasur në Egjipt ku faraonët janë konsideruar si zotëra dhe të gjithë njerëzit iu janë përmbajtur urdhërave të tyre. Ata janë konsideruar si të shenjtë dhe të mbinatyrshëm. Pastaj kemi teorinë indiane apo hinduse që i kërcënon individët që ndryshojnë statusin e tyre se do të konsiderohen si kafshë. Religjioni gjithashtu mund të legjitimojë ndryshimet që favorizojnë më të fortin apo të pasurin. Religjioni shihet edhe si objekt i shumë luftërave dhe kolonizimeve. Rast e kemi Krishterimin i cili si religjion i Perandorisë Romake u përhap më pas nga kjo perandori në shumë vende të tjera me anë të kolonializimit apo pushtimit.

Pikpamja e Marksit për religjionin si “opium i njerëzimit” mund të shifet si shumë e ngushtë sepse religjioni mund të kyçet në konfliktet shoqërore në aspekte tjera gjithashtu duke përfshirë mënyrat që sfidojnë status kuon. Religjioni shpesh përdoret si një armë ideologjike duke justifikuar konfliktet me dallimet fetare që ekzistojnë mes njerëzve. Një popull që është në luftë pa dyshim mendon se Zoti është në anën e tyre gjë që e favorizon religjioni i tyre. Në kohën e sotme kemi rastin e konfliktit mes Izraelitëve dhe Palestinezëve, përkatësisht hebrenjëve dhe muslimanëve, konflikt i cili është religjioz, edhe pse pohohet se luftohet për atdhe.



Luftërat të cilat sot ndodhin në botë e që zakonisht edhe quhen si ‘kryqëzatat e reja të krishterëve’ ndryshe quhet edhe “përplasja e qytetërimeve” për të cilët shumë mendimtarë pohojnë se janë të bazuar thjesht në fe dhe në doktrinat e krishterimit për një dominim në të gjithë botën në mënyrë demokratike. Ky është një funksion tepër i rrezikshëm i religjionit në botën e sotme që përdoret nga shumë njerëz dhe qeveri për arritjen e shumë qëllimeve të tyre personale e kolektive në emër të religjionit të tyre.

Religjioni si formë e vetëdijes shoqërore, përkundër ndikimeve negative në shoqëri, me forcimin e vetëdijes së solidaritetit, me kontrollin e shoqërisë, afrimin e përgjigjeve për shumë pyetje dhe mistere, dhe me ndihmën psikologjike që u jep njerëzve ka arritur të mbijetojë dhe të jetë një nga vlerat kryesore të njerezimit. Ka arritur të bëhet pjesë e kulturës së shumë popujve dhe të ketë ndikim në moralin, mënyrat e sjelljes dhe vetëdijen e popujve. Religjioni, në kuptimin e ngushtë sjell paqe, jep shpresë, iu jep njerëzve identitet dhe qëllim jetësor. Njerëzit religjioz, dijnë se për çfar kanë ardhur në këtë botë, pse jetojnë dhe e dijnë se çfarë kërkon ajo krijesë apo qenie e mbinatyrshme supreme dhe e shenjtë. Njerëzit religjioz kanë familje më të qëndrueshme, janë më të përgjegjshëm për komunitetin dhe për jetën e tyre, dhe mbi të gjitha, janë realist.